

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)

Validimi i Dytë për Shqipërinë

Projekt-vlerësim nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI

15 Prill 2019

Përmbajtja

1. Përmbledhje	2
2. Sfondi	3
3. Shqyrtim i veprimeve korigjuese	5
3.1 Veprimi korigjues 1 (#1.3).....	5
3.2 Veprimi korigjues 2 (#1.4).....	11
3.3 Veprimi korigjues 3 (#2.2).....	16
3.4 Veprimi korigjues 4 (#2.3).....	19
3.5 Veprimi korigjues 5 (#2.4).....	21
3.6 Veprimi korigjues 6 (#2.6).....	23
3.7 Veprimi korigjues 8 (#4.6).....	26
3.8 Veprimi korigjues 10 (#4.9).....	28
3.9 Veprimi korigjues 11 (#5.1).....	32
3.10 Veprimi korigjues 12 (#6.1).....	34
3.11 Veprimi korigjues 13 (#6.2).....	35
3.12 Veprimi korigjues 14 (#7.3).....	36
4. Vlerësimet e kërkesave të çmuara si të kënaqshme në Validimin e 1^{rë}	38
4.1 Validimi i Kërkesës 4.1.....	38
4.2 Validimi i Kërkesës 4.7.....	42
5. Konkluzione	43
Shtojca	Error! Bookmark not defined.
Shtojca A – Validimi i MSG-ve të AlBEITI (pjesëmarrja) për 2018	45
Shtojca B – Pasqyra e pagesave prej kompanive jo-raportuese në 2016	46

1. Përmbledhje

Validimi i dytë për Shqipërinë filloi në 13 Shkurt 2019. Sekretariati Ndërkombëtar i EITI ka vlerësuar progresin e bërë në adresimin e 12 veprimeve korigjuese të përcaktuara nga Bordi i EITI në vijim të Validimit të parë për Shqipërinë në 2017¹. 12 veprimet korigjuese janë të lidhura me:

1. Angazhimi i shoqërisë civile (Kërkesa 1.3)
2. Mbikëqyrja e MSG (Kërkesa 1.4)
3. Dhënia e liçensave (Kërkesa 2.2)
4. Regjistr/i(at) e liçensave (Kërkesa 2.3)
5. Publikimi i kontratave (Kërkesa 2.4)
6. Pjesëmarrja e shtetit (Kërkesa 2.6)
7. Pagesat direkte sub-nacionale (Kërkesa 4.6)
8. Besueshmëria e të dhënave (Kërkesa 4.9)
9. Shpërndarja e të ardhurave (Kërkesa 5.1)
10. Shpenzimet sociale (Kërkesa 6.1)
11. Shpenzimet e kuazi-fiskale (Kërkesa 6.2)

¹ [LINKU I VENDIMIT TË BORDIT](#)

12. Ndjekja në vijueshmëri e rekomandimeve të EITI (Kërkesa 7.3).

Përveç sa më sipër, Sekretariati ka shqyrtuar progresin kundrejt Kërkesës 4.1 (mbi plotshmërinë e publikimit të të dhënave) dhe 4.7 (mbi disagregimin [zbërthimin] e zërave), nisur nga shqetësimet për rrëshqitje mbrapa që prej Validimit të parë.

Secretariati çmon se qysh në fillim të Validimit (13 Shkurt 2019), Shqipëria pat adresuar mjaftueshëm pesë nga 12 veprimet korigjuese duke arritur “progres të kënaqshëm” në kërkesat e tyre korresponduese dhe “progres domethënës” me përmirësime të konsiderueshme në shtatë veprimet e tjera korigjuese.

Informacione shtesë të disagreguara në nivele të përputhshme me standardet e EITI dhe procedurat normative të industrisë u publikuan në Prill 2019, dy muaj pas fillimit të Validimit për Shqipërinë. Në pikëpamjen e Sekretariatit, informacioni i publikuar pas fillimit të Validimit plotëson kriteret e aprovuara të Bordit² për marrje në konsideratë të informacionit të publikuar menjëherë pas fillimit të Validimit. **Nëse Bordi bie dakord që të ushtrojë diskrecionin e tij për të marrë në konsideratë këtë informacion shtesë, Sekretariati çmon se Shqipëria ka arritur “progres të kënaqshëm” në shtatë veprime korigjuese, dhe “progres domethënës” me përmirësime të konsiderueshme në pjesën tjetër të veprimeve korigjuese.**

Përveç kësaj, Sekretariati vlerëson se ka patur një rrëshqitje mbrapa në Kërkesën 4.1 mbi plotshmërinë e zbardhjeve. Sekretariati është i kënaqur që Kërkesa 4.7 do të vijojë të vlerësohet me “progres të kënaqshëm”.

Boshllëqet më të mëdha lidhen me angazhimin e shoqërisë civile (Kërkesa 1.3), akordimi i liçensave (Kërkesa 2.2), pjesëmarrja e shtetit (Kërkesa 2.6), plotshmëria e publikimit të të dhënave (Kërkesa 4.1), pagesat direkte sub-nacionale (Kërkesa 4.6) dhe besueshmëria e të dhënave (Kërkesa 4.9).

Projekt Validimi i është dërguar Grupit Ndër-Institucional të Punës (MSG) të AlbEITI në 26 Prill 2019. Në vijim të komenteve prej MSG të pritshme në 17 Maj 2019, Validimi do të finalizohet për t'u marrë në shqyrtim nga Bordi i EITI.

2. Sfondi

Shqipëria u pranua si kandidate EITI në Maj 2009 dhe u vlerësua në përputhje me rregullat e EITI në Maj 2013. Validimi i parë i Shqipërisë kundrejt standardit EITI filloi më 1 Prill 2017. Më 13 Shkurt 2018, Bordi i EITI gjeti se Shqipëria kishte bërë përparim domethënës në zbatimin e standardit EITI 2016.

Katërmbëdhjetë veprime korigjuese u identifikuan nga Bordi, që kishin të bënin me kërkesën e mëposhtme: angazhimi i shoqërisë civile (# 1.3), mbikëqyrja e MSG (# 1.4), dhënia e liçencës (# 2.2), regjistri i liçens(ës)/ave (# 2.3), publikimi i kontratave (#2.4), pjesëmarrja e shtetit, (#2.6) publikime të plota të taksave dhe të ardhurave (#4.1), pagesat direkte subnacionale (# 4.6), niveli i disagregimit (# 4.7), besueshmëria e të dhënave (# 4.9), shpërndarja e të ardhurave (# 5.1), shpenzimet sociale (# 6.1), shpenzimet kuazi-fiskale (# 6.2) dhe ndjekja e rekomandimeve të EITI (# 7.3). Bordi kërkoi nga Shqipëria që të adresojë këto veprime korigjuese që të vlerësohen në një Validim të dytë që do të fillonte më 13 Shkurt 2019.

² EITI (Shkurt 2019), ‘The Board adopted criteria to consider developments and information disclosed after the commencement of Validation’, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

Shqipëria ka ndërmarrë një sërë aktivitete për të adresuar Veprimin korrigjues:

- Më 18 Korrik 2016, MSG miratoi kontratën e Administratorit të Pavarur për Raportet EITI të 2015 dhe 2016 me Deloitte Audit Albania.
- Në Qershor të vitit 2018, AlbEITI MSG miratoi dhe publikoi Raportin EITI 2016³
- Më 28 Mars 2018, MSG miratoi planin e punës 2018-2019 EITI pas kontributit nga anëtarët e MSG.
- Më 13 Maj 2018, anëtarët e MSG të shoqërisë civile ranë dakord të paraqesin një plan veprimi për të adresuar çështjet që lidhen me angazhimin e shoqërisë civile të theksuara në vendimin e Validimit.
- Më 13 maj 2018, MSG ranë dakord për të hartuar një plan veprimi për adresimin e veprimeve korrigjuese të identifikuara në Validim.
 - Në Qershor të vitit 2018, MSG miratoi dhe publikoi raportin vjetor të progresit 2017 në faqen e internetit AlbEITI.⁴
 - Më 4 Dhjetor 2018, MSG miratoi procesin formal të përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile të MSG.
 - Në Dhjetor të vitit 2018, MSG shqyrtoi draftin e pilot raportit të tregtimit të mallrave të përgatitura nga Deloitte duke mbuluar shitjet e naftës së papërpunuar të Albpetrol gjatë periudhës 2013-2016.
 - Më 11 Janar 2019, MSG ra dakord për të filluar procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të MSG nga shoqëria civile, një proces që u finalizua më 13 shkurt 2019.
 - Më 12 Shkurt 2019, MSG krijoi një grup pune për të hartuar planin e punës të EITI 2019, nëpërmjet konsultimeve me grupet e interesit më të gjera, për të adresuar veprimin korrigjues nga Validimi dhe përdorimin e rekomandimit të EITI për të nxjerrë në pah mospërputhjet në kuadrin ligjor, fiskal dhe rregullator të minierave, naftës dhe gazit.
 - Në shkurt të vitit 2019, MSG miratoi një plan pune të përditësuar 2018-2019 AlbEITI, të cilin e publikoi në faqen e internetit AlbEITI.⁵
 - Në fillim të marsit 2019, grupi i ri i punës i MSG për ndjekjen e rekomandimeve të Raporteve dhe Vlerësimit të EITI ra dakord për një plan pune të dedikuar për punën vijuese.
- Në fillim të Prillit, Sekretariati AlbEITI, me miratimin nga MSG, publikoi të dhëna shtesë për raportin EITI të vitit 2016, duke përfshirë procedurat e nominimeve në MSG të grupit të interesit të industrisë dhe publikimet unilaterale qeveritare në format të disagreguar.

Seksioni në vijim adreson progresin në secilin prej veprimeve korrigjuese. Vlerësimi është i kufizuar në veprimin korrigjues të përcaktuar nga Bordi dhe kërkesat shoqëruese në standardin EITI. Vlerësimi ndjek udhëzimet e përshkruara në Udhëzuesin e Validimit⁶. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Sekretariati Ndërkombëtar ka shqyrtuar gjithashtu nëse ka nevojë të shqyrtohen kërkesa shtesë, dmth ato që vlerësohen me "progres të kënaqshëm" ose "përtej" në Vlerësimin e 2016. Ndonëse këto kërkesa nuk janë vlerësuar tërësisht, pikëpamja e Sekretariatit është se ka pasur një rrëshqitje mbrapa në kërkesën 4.1 lidhur me plotësinë e publikimit të të dhënave. Vlerësimi gjithashtu përfshin një pasqyrë të progresit në

³ EITI Albania (Shkurt 2018), 'Raporti EITI 2016', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁴ EITI Albania (Korrik 2018), 'Raporti Vjetor i Progresit 2017', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁵ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Updated EITI Albania Work-Plan 2018-2019', aksesuar [ketu](#) në Shkurt 2019.

⁶ https://eiti.org/sites/default/files/documents/validation-guide_0.pdf

kërkesën 4.7 lidhur me disagregimin, ku nuk konsiderohet se ka pasur rrëshqitje mbrapa, me kusht që Bordi të shqyrtojë informacionet e reja të zbuluara pas fillimit të Validimit.

3. Shqyrtim i veprimeve korigjuese

Siç pasqyrohet në vendimin e Bordit mbi Validimin e parë për Shqipërinë, Bordi i EITI është dakordësuar për 12 veprime korigjuese.⁷ Validimi i mëposhtëm i Sekretariatit shtjellon nëse veprimet korigjuese janë adresuar mjaftueshëm. Vlerësimet janë bazuar në planin e punës 2018-2019, raportin EITI 2016, raportin vjetor të përparimit 2017 dhe procesverbalet e mbledhjeve të MSG prej Janarit të 2018 deri në Shkurt të 2019, si dhe mjaft dokumenteve të ndryshme të dërguara nga Sekretariati Kombëtar tek Sekretariati Ndërkombëtar, korrespondencë me e-mail dhe konsultime me partnerët (në person ose përmes skype).

3.1 Veprimi korigjues 1 (#1.3)

Në përputhje me Kërkesën 1.3.a, grupi i interesit të shoqërisë civile duhet të demonstrojë se është i angazhuar plotësisht, aktivisht dhe efektivisht në procesin e EITI. Specifikisht, shoqëria civile duhet të sigurojë që të jenë plotësisht të aftë për të marrë pjesë dhe dhënë kontribut në procesin e EITI dhe që të kenë kapacitetet e përshtatshme për të marrë pjesë në EITI. Në përputhje me Kërkesën 8.3.c.i, grupi i interesit të shoqërisë civile duhet të hartojë dhe shpallë një plan veprimi për të adresuar mangësitë në angazhimin e shoqërisë civile të dokumentuar në vlerësimin fillestar dhe Raportin e Validimit brenda tre muajve nga vendimi i Bordit, dmth., brenda 13 Maj-it të 2018. Ky grup interesi mund të zgjedhë të ndërmarrë një shqyrtim të pavarur të angazhimit të shoqërisë civile në EITI në Shqipëri, duke zgjeruar hapësirën për angazhim prej Organizatave të Shoqërisë Civile që mund të jenë të interesuara mbi zbatimin e EITI. Ndërmarrja e një Validimi të nevojave për kapacitete dhe formimi i veprimeve për të adresuar kufizimet në kapacitetet e shoqërisë civile janë thelbësore veçanërisht për të mundësuar financime nga partnerë zhvillimorë dhe palë të tjera të interesuara.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë vërejtë se Shqipëria kishte arritur progres domethënës në plotësimin e kësaj kërkesë. Nuk u gjet evidencë e ndonjë pengese ligjore, rregullore apo praktike ndaj mundësisë së shoqërisë civile që të angazhohej në EITI apo ndaj aftësisë së saj për të vepruar, komunikuar dhe bashkëpunuar lirshëm me mbarë grupin e saj të interesit. Proces-verbalet e mbledhjeve të MSG dhe konsultimet me partnerët nuk evidentuan pengesa ndaj të drejtave apo mundësisë së shoqërisë civile për të qenë efektivisht e angazhuar në EITI. Nga ana tjetër ka pak evidencë që të tregojë se OSHC-të e kanë përdorur këtë hapësirë për të qenë plotësisht, aktivisht dhe efektivisht të angazhuara në zbatimin e EITI, përveç kumtimit të pikëpamjeve kritike gjatë mbledhjeve të MSG. Ndërsa pengesat e lidhura me financimin dhe mungesa e angazhimit efektiv të OSHC-ve privoi shoqërinë civile që të ndikonte plotësisht dhe efektivisht në dizenjimin dhe zbatimin e EITI, ka evidencë të paktë që të tregojë që organizatat e shoqërisë civile patën hedhur hapa për të mobilizuar financim.

Progresi që prej Validimit

Nuk ka evidencë të ndonjë shkeljeje të Protokollit të Shoqërisë Civile që prej Validimit të parë për Shqipërinë bazuar në Standardin EITI. Përkundrazi, protestat politike janë rritur në frekuencë në periudhën që prej Validimit të parë (2018-2019), me demonstrata publike me mbi 20,000 vetë të

⁷ <https://eiti.org/document/albania-validation-2017>

organizuar nga partitë opozitare që kanë bërë thirrje për dorëheqje të Kryeministrit Socialist Edi Rama bazuar mbi pretendime për korrupsion gjatë periudhës Janar-Mars 2019.⁸ Në mes të këtij konteksti politik të paqëndrueshëm, shoqëria civile si grup interesi ka filluar të ndërtojë mekanizmat bazë të koordinimit si grup që kërkohet për të patur këtë angazhim të plotë dhe aktiv për zbatimin e EITI. Megjithëse ky grup interesi nuk shfaqet të jetë dakordësuar dhe të ketë publikuar një plan-veprim me afate kohore për adresimin e mangësive të identifikuar në Vlerësim brenda tre muajve nga vendimi i Bordit (dmth. deri në 13 Maj 2018) në përputhje me Kërkesën 8.3.c.i, Anila Hajnaj nga Qendra Shqiptare për Zhvillim Institucional (ACDI) ka zhvilluar një projekt të financuar nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike (SECO) që prej Dhjetorit 2018, për të ndërtuar koordinimin dhe strukturën e angazhimit për zbatimin e EITI. Ndërsa vetëm tre nga pesë anëtarët statutorë të MSG nga shoqëria civile kanë qenë aktivë në zbatimin e EITI në kohën e kryerjes së Validimit të parë për Shqipërinë (në 2017), ky grup interesi ka rinovuar anëtarësinë e tij në MSG me vonesë. Në fillim të Shkurtit 2019 dy nga tre anëtarët e hershëm të MSG (Anila Hajnaj nga ACIDI dhe Sami Neza nga Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë (CTFI) u emëruan për një mandat të ri në MSG ndërsa anëtari i tretë (Ilir Aliaj nga Qendra për Zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve (CDDI)) u zëvendësua. Si Anila Hajnaj ashtu dhe Sami Neza janë anëtarë të partive politike opozitare. Ndërsa infrastruktura e koordinimit tashmë është stabilizuar, duke patur një faqe interneti të grupit të interesit Albnet-EITI, grupe komunikimi në WhatsApp dhe email për shpërndarje informacioni. Sidoqoftë numri i OSHC-ve anëtare ngelet i vogël me një numër prej rreth 12 organizatash.

Plani i Veprimit të shoqërisë civile: Megjithëse më 28 mars 2018⁹ dhe 15 maj 2018¹⁰, në mbledhjet e saj MSG diskutoi hartimin e një plani veprimi me afate të përcaktuara nga ana e grupit të shoqërisë civile për të adresuar mangësitë e identifikuar në Validim, nuk ka evidencë që plani i veprimit të jetë rënë dakord ose publikuar brenda afatit të fundit, 13 Maj 2018. Përkundrazi, në janar 2018 Anila Hajnaj nga ACIDI zhvilloi një projekt-propozim për të forcuar kapacitetet dhe strukturat koordinuese të koalicionit të shoqërisë civile Albnet-EITI, e themeluar në Janar 2016.¹¹ Në takimin e 15 majit 2018 të MSG Anila Hajnaj shpjegoi që anëtarët e MSG prej OSHC-ve kishin kërkuar donatorë të ndryshëm në mënyrë që të zhvillonin një plan veprimi që synonte fuqizimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, në vend që të krijonte një mekanizëm të qartë të koordinimit të këtij grupi interesi. Ndërsa ajo vuri në dukje se SECO do të mbështeste një vlerësim të grupit të shoqërisë civile dhe EITI, ajo sqaroi se kjo do të konsistonte në vlerësimin e nivelit të njohurive rreth EITI nëpër rrethe të Shqipërisë, sesa në një hartëzim të aktorëve të shoqërisë civile dhe rëndësisë së tyre në zbatimin e EITI. Një përfaqësues i shoqërisë civile i konsultuar shpjegoi se anëtarët e MSG prej OSHC-ve kishin vendosur të përqëndroheshin në ngritjen e fondeve prej donatorëve për të mbështetur më së pari ndërtimin e kapaciteteve, pasi nuk shihnin vlerë në organizimin e zgjedhjeve të reja në MSG apo në krijimin e mekanizmave të koordinimit përpara se të zhvilloheshin më tej kapacitetet e këtij grupi sa i përket lidhjes me EITI. Projekti u miratua nga SECO Zvicerian në Dhjetor 2018, me një grant prej 37,000 eurosh që do të zbatohet gjatë periudhës Shkurt 2019 - Prill 2020. Një përfaqësues i shoqërisë civile i konsultuar, shpjegoi se, ndërsa financimi i projektit do të kanalizohet përmes ACIDI, ai duhej të përdorej nga tërësia e grupit. Përfaqësuesi i shoqërisë civile shpjegoi se ACIDI ishte zgjedhur si organizatë zbatuese duke qenë se grupi nuk dëshironte të regjistronte organizatën Albnet-EITI për të minimizuar detyrimet tatimore të tyre.

Ka pasur mungesë qartësie të konsiderueshme midis aktorëve të konsultuar për dallimin midis një plani veprimi të grupit dhe projektit të financuar nga SECO. Disa OSHC konsiderojnë se projekti i financuar nga

⁸ Shiko Reuters (Shkurt 2019), 'Albanian protesters attack PM's office to demand he quits', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019; Balkan Insight (Mars 2019), 'Albania Opposition Supporters Clash with Police During Protest', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019; The Washington Post (Mars 2019), 'Albanian anti-govt protesters try to storm parliament', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁹ Shiko Faqja e internetit AlbEITI, Procesverbali i Mbledhjes 28 March 2018, aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

¹⁰ Shiko Faqja e internetit AlbEITI, Procesverbali i Mbledhjes 15 May 2018, aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

¹¹ Albnet-EITI (Mars 2019), 'Civil society plan of action 2019-2020', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

SECO ishte ekuivalent me planin e veprimit të grupit të interesit për shkak se adresoi nevojën e hartëzimit të aktorëve përkatës, përfshiu aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për mbarë grupin dhe planifikoi rinovimin e anëtarësisë në MSG të shoqërisë civile. Pas konsultimeve të mesit të Marsit 2019, faqet e internetit¹² të Albnet-EITI dhe AlbEITI publikuan, me vonesë, përmbledhjen e projektit të financuar nga SECO më 19 Mars 2019, mbrapa fillimit të Validimit të dytë. Plani i veprimit i financuar nga SECO përshkruan aktivitetet e përgjithshme të propozuara dhe rezultatet e pritura, por nuk përfshin një ndarje të hollësishme të shpenzimeve apo afateve kohore për kompletimin e secilit aktivitet.

Koordinimi i grupit të interesit: Kodi i Sjelljes së shoqërisë civile, miratuar me mbështetjen e *Publish What You Pay (PWYP) International* në 2015, përmban parashikime për koordinimin e grupit të interesit sa i takon marrëdhënies me EITI. Në veçanti, Neni 8 i Kodit të Sjelljes i kërkon grupit që të konsultohet përpara zhvillimit të mbledhjeve të MSG apo aktiviteteve të tjera të EITI për t'u dakordësuar për pozicionimet e përbashkëta mbi çështjet thelbësore. Ka pak evidencë të një kuadri të strukturuar koordinimi të grupit të shoqërisë civile në praktikë gjatë periudhës së 2018. Në komentet e shkruara si pjesë të konsultimeve me partnerët, një nga anëtarët e MSG prej OShC-ve shpjegoi se anëtarët e grupit të shoqërisë civile në MSG koordinoheshin me tërësinë e grupit të OShC-ve "kurdoherë që ishte e mundshme", pavarësisht se me raste, duke "folur me OShC të tjera si në takime të OShC-ve, grumbullime apo forume të hapur të organizuara gjatë sondazheve, monitorimeve apo punëve zbatuese të projekteve të tjera". Disa prej OShC-ve të konsultuara shpjeguan se mungesa e koordinimit të mirëfilltë të grupit në 2018 erdhi për shkak të vonesës së aprovimit nga SECO të projekt propozimit të ACIDI, duke ritheksuar pikëpamjet e tyre që pengesa kryesore e angazhimit të shoqërisë civile në EITI lidhej me disponibilitetin e financimit. Ndërsa ka evidencë të përfaqësimit nga ana e Anila Hajnaj të opinionit të dy kolegëve të saj në MSG (në atë kohë), nuk ka evidencë të konsultimit nga ana e ACIDI të tërësisë së grupit të interesit për zhvillimin e projekt propozimit.

Megjithatë, me sigurimin e financimit nga SECO, ka evidencë për konsultim të mëtijshëm më të gjerë të grupit që nga Janari 2019. Sipas stafit të sekretariatit dhe OShC-ve të konsultuara, koalicioni i OShC-ve në MSG, i financuar nga SECO, ndërmoi një hulumtim të pavarur të OShC-ve në Shqipëri për të identifikuar kandidatët e mundshëm për anëtarësim në MSG, për ndërmarrje aktivitetesh për ngritjen e kapaciteteve me OShC të zgjedhura dhe, për lehtësimin e zgjedhjes së përfaqësuesve të OShC-ve në MSG në përputhje me Kodin e Sjelljes të grupit. Ky proces duket se është mbështetur nga anëtarët e PWYP International dhe Fondacionit të Shoqërisë së Hapur. Disa përfaqësues të shoqërisë civile theksuan rëndësinë e këtyre aktiviteteve në krijimin e një mekanizmi të koordinimit të grupit të interesit. Stafi i Sekretariatit dhe OShC-të e konsultuara theksuan studimin e ndërmarrë nga ACIDI, të financuar nga një grant prej Leviz Albania¹³, mbi përdorimin e transfertave subnacionale të rentës minerare nga njësitë e qeverisjes lokale. Projekti i monitorimit, i realizuar gjatë periudhës 2018 - 2019, mbuloi pesë komuna (Patos, Roskovec, Ura Vajgurore, Bulqizë dhe Has) dhe u mbështet nga projekti i Leviz Albania. Një artikull i janarit 2019 në faqen e internetit të AlbEITI shpjegon se studimi përfshinte anketimin e "disa qindra qytetarëve nga grupe të ndryshme shoqërore" në mbi 40 takime dhe intervista me një spektër të gjerë palësh të interesuara¹⁴ nga qeveria qendrore dhe lokale, industria dhe shoqëria civile.¹⁵ Një anëtar i MSG-së prej grupit të shoqërisë civile sqaroi se në Janar të vitit 2019 u mbajtën pesë forume të hapura me gjithsej 114 pjesëmarrës dhe kryetarët e njësive administrative të Roskovecit, Patosit dhe Bulqizës për të diskutuar praktikat më të mira në përdorimin e transfertave subnacionale nga qeveritë lokale. Përfaqësuesi i OShC

¹² Shiko Albnet-EITI (Mars 2019), 'Civil society plan of action 2019-2020', aksesuar [këtu](#), and AlbEITI (Mars 2019), 'Civil society plan of action 2019-2020', aksesuar [këtu](#), në Mars 2019.

¹³ Leviz Albania, 'Projekte në zbatim', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

¹⁴ Kryetarë Bashkish, Punonjës të Tatimeve dhe Financave në komunat Patos, Roskovec, Bulqizë, Has, Ura Vajgurore, drejtues dhe punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Tatimeve, si dhe Drejtoritë Rajonale të Tatimeve, Peshkopi, Kukës, Fier dhe Berat, Anëtarët e Bordit të EITI-t, përfaqësues të biznesit dhe shoqërisë civile, qytetarë përfitues të taksave dhe financave në komunat Patos, Roskovec, Bulqize, Has, Ura Vajgurore.

¹⁵ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim, përfaqësuese në Grupin Ndërinstitucional të Punës (MSG) bëhet pjesë e Strategjisë së Bashkëpunimit Zvicerian në Shqipëri', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

vuri në dukje se diskutimet gjithashtu preknin zbatimin e EITI në përgjithësi dhe mendohet se mbi 1 milion njerëz kanë parë mbulimin televiziv të rezultateve të studimit në katër transmetime në Nëntor 2018.

Dy ditë para fillimit të Validimit të dytë të Shqipërisë, më 11-12 Shkurt 2019, ACDI zhvilloi një seminar dyditor me grupin e shoqërisë civile, me temë "Shoqëria Civile, roli i saj në Transparencën e Industrisë Nxjerrëse". Ndërsa iu kushtua ngritjes së kapaciteteve në standardin EITI, seminari u mbyll me zgjedhjet e pjesëmarrësve të OSHC-ve në MSG për një mandat trevjeçar. Përfaqësuesit e shoqërisë civile të konsultuar shpjeguan se numri i OSHC-ve që kanë nënshkruar Kodin e Sjelljes është rritur nga një fillësë me pesë organizata në vitin 2015 në 12 syresh në 2019. Këto 12 organizata morën pjesë në seminarin e shoqërisë civile dhe në zgjedhjet në Shkurt 2019 (*shiko kërkesa 1.4*). Përfaqësues të konsultuar të OShC-ve në MSG shpjeguan se që nga Janari 2019 ata kanë koordinuar çështjet e lidhura me EITI përmes dy grupeve të ndryshme të WhatsApp (një për pesë anëtarët e MSG-së të OShC-ve dhe një për grupin e 12 OShC-ve), një listë e-mail-i, faqes së re të internetit Albnet-EITI dhe telefonatash të zakonshme. Disa partnerë të zhvillimit të konsultuar shprehën kënaqësi në mekanizmat e rinj të koordinimit të grupit, por konsideruan se 12 organizatat anëtare të grupit mbeten ende një grup i ngushtë në dritën e diversitetit dhe numrit të OShC-ve në Shqipëri. Ata konsideruan se OShC të tjera të fokusuar në aspekte mjedisore të industrive nxjerrëse, qeverisjes së mirë dhe të dhënave të hapura do të ishin gjithashtu të përputhshme sa i përket EITI. Një numër OSHC-sh të konsultuara theksuan se nga rreth 500 OShC aktive në Shqipëri, rreth gjysma ishin të vendosura në Tiranë, ndërsa të tjerët kishin kapacitete të ulëta. Ata mendonin se ka një tendencë të ulët të vullnetarizmit në shoqërinë civile shqiptare, gjë që e vështirëson angazhimin e OShC-ve, përveçse përmes projektsh të veçanta, të financuara.

Kapaciteti: Si numri ashtu edhe kapacitetet e OShC-ve të përfshira në zbatimin e EITI duket se janë rritur që nga fillimi i vitit 2018. Disa OShC kanë konfirmuar se numri i OShC-ve që kanë ndjekur Kodin e Sjelljes së grupit është rritur nga pesë në vitin 2015 në 12 në 2019. Pesë anëtarët e rinj të MSG të përzgjedhur në shkurt të vitit 2019, përfshijnë OShC të fokusuar në miniera, naftë dhe gaz, hidroenergjia dhe individë me sfond juridik (tre përfaqësues), gazetari hulumtuese (dy përfaqësues) si dhe advokues për menaxhimin e energjisë dhe financave publike. Shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të MSG-së tregon se kontributi i përfaqësuesve të shoqërisë civile gradualisht është bërë më teknik në natyrë, megjithëse është fokusuar në çështjen e transfertave subnacionale të rentës. Ndërsa kontributi i shoqërisë civile në diskutimet e MSG-ve në periudhën 2014-2017 kishte qenë i përqendruar thuhetse tërësisht në kufizimet e kapaciteteve financiare, në periudhën 2018-2019 pati më shumë raste të kontributeve të fokusuar në sqarimin e rrjedhës së transfertave subnacionale të rentës.

Sidoqoftë, konsultimet me OShC-të si pjesë e Validimit ende zbuluan kufizime të kapaciteteve si nga ana e anëtarëve të OShC-ve në MSG ashtu edhe të grupit të tyre më të gjerë. Disa përfaqësues nga grupe të ndryshme interesi mendonin se megjithëse kapacitetet e shoqërisë civile ishin rritur që nga Validimi i parë, ka ende nevojë për zhvillim të kapaciteteve për anëtarët e MSG, veçanërisht në aspekte teknike të standardit EITI. Ka pasur konsensus në mesin e përfaqësuesve të shoqërisë civile në mendimin që kufizimi i tyre kryesor sa i përket kapaciteteve lidhet me disponueshmërinë e fondeve për projektet EITI, pavarësisht granteve të SECO dhe Leviz Albania. Në komentet me shkrim, si pjesë e konsultimeve me palët e interesuara, një anëtar i MSG nga OSHC-të deklaroi kategorikisht se pengesa e vetme për angazhim të plotë, aktiv dhe efektiv nga shoqëria civile në zbatimin e EITI ishte disponueshmëria e fondeve. Duke vënë në dukje dispozitat e nenit 6 të Kodit të Sjelljes së Shoqërisë Civile, anëtar i MSG-së nga OShC-të vuri në dukje se anëtarëve të MSG-së u kërkohet të kishin njohuri të avancuara të EITI dhe mendonte se ky trajnim kërkon mbështetje financiare të paktën për udhëtimin, akomodimin dhe ushqimin. Në lidhje me diskutimin mbi menaxhimin të liçensave për nxjerrjet, pjesëmarrjes së shtetit dhe menaxhimin të financave publike të nxjerrjeve, OShC-të e konsultuara mendonin se kapaciteti i tyre për të dhënë kontribut në këto çështje nuk ishte rritur në përpjestim të drejtë me advokimin e tyre për transfertat subnacionale.

Ka evidencë të vetëm dy aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të dedikuara për shoqërinë civile në periudhën Shkurt 2018 - Shkurt 2019. Më 3-5 Korrik 2018, tre anëtarë¹⁶ të grupit të OShC-ve morën pjesë në një seminar për ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile në Ukrainë. Aktiviteti i dytë kishte të bënte me seminarin e ACIDI-së me financim të SECO në 11-12 Shkurt 2019, që u fokusua në ngritjen e kapaciteteve për një grup të përzgjedhur prej 12 OShC-sh.¹⁷ Plani i përtëritur punës EITI 2018-2019, i miratuar nga MSG më 7 Shkurt 2019, përfshin disa aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve të OShC-ve në mënyrë specifike si dhe në përgjithësi për MSG, përfshirë përfaqësuesit e OShC-ve brenda saj.¹⁸

Aktiviteti i parë lidhet me projektin e financuar nga SECO për të mbështetur përmirësimet në angazhimin e OShC-ve në zbatimin e EITI. Aktiviteti tjetër kyç konsiston në trajnimin e stafit të sekretariatit kombëtar, anëtarëve të MSG (duke përfshirë OShC-të) dhe stafit qeveritar për "*të gjitha aspektet e çështjeve të Qeverisjes së Burimeve Natyrore si Paketa Fiskale, Kuadri Ligjor, Përmbajtja Lokale, Mjedisi, Taksat, Sistemet GIS dhe Kadastër, Arbitrazhi dhe Kontratat Ndërkombëtare*" në periudhën 2018-2019, mbështetur me 20,000 USD nga një grant i Bankës Botërore për Qeverinë e Shqipërisë për zbatimin e EITI.

Angazhimi i shoqërisë civile: Shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të MSG për periudhën 2018-2019¹⁹ tregon se anëtarët e OShC-ve kanë vazhduar të japin kontribute aktive në diskutimet e MSG-ve, duke u fokusuar në çështje më teknike, si pagesa e transfertave subnacionale për qeveritë lokale. Në komentet me shkrim të ofruara si pjesë e konsultimeve me palët, një anëtar i MSG nga OShC-të konsideronte se shoqëria civile ishte shumë e përfshirë dhe aktive në të gjitha aspektet e zbatimit të EITI, duke u përfshirë në diskutimet e MSG për "të gjitha temat përkatëse" dhe duke ofruar kontribut në zhvillimin e Termave të Referencës, Raportet EITI, planet e punës, zbatimin e kryerjes së publikimit të të dhënave të përfituesve dhe të tregtimit të mallrave. Sidoqoftë, disa përfaqësues konsideruan se shoqëria civile ende nuk ishte proaktive në diskutimet e MSG që kishin të bënin me dakordësimin për fokusin e Raportëve të EITI, të tilla si momenti i diskutimit të MSG-së për Termat e Referencës për Administratorin e Pavarur ose draftin e raportit fillestar.

Ndërsa ka evidencë që shoqëria civile angazhohet për komunikim të pavarur me komunitetet lokale dhe për shpërndarjen e gjetjeve të EITI në lidhje me rentën e nxjerrjes, si pjesë e projektit ACIDI të financuar nga Leviz Albania, nuk ka evidencë të aktiviteteve të shpërndarjes së informacionit nga shoqëria civile në lidhje me çështje të tjera si liçensimi, pjesëmarrja e shtetit apo qeverisjen e [sektorit] nxjerrës në tërësi. Një nga OShC-të e konsultuara vuri në dukje kontributin e grupit për zhvillimin e një strategjie për shpërndarjen e të dhënave EITI në nivel kombëtar, veçanërisht në lidhje me transfertat e rentës. Është vërejtur se shoqëria civile ka qenë aktive në lobimin e zyrtarëve të qeverisë lokale dhe qendrore në lidhje me transparencën e rentës minerare, shpërndarjen e saj dhe investimet në favor të komuniteteve në zonat e nxjerrjes.

Videoja e një prezantimi²⁰ publik të projektit të ACIDI mbi rentën, financuar nga Leviz Albania, konfirmoi se diskutimet mbi EITI ishin vetëm një aspekt i vogël përbërës i diskutimeve gjatë aktiviteteve prezantuese.

Ndërsa ka vetëm evidencë sporadike të lidhshimit të shoqërisë civile në prezantimin dhe përhapjen e informacionit lidhur me EITI, duket se Sekretariati AlbEITI ka vazhduar të jetë nxitësi kryesor i prezantimit dhe përhapjes tek tërësia e shoqërisë civile. Përpos eventit të 27 Shkurtit 2017 të mbajtur nga Sekretariati AlbEITI në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, një tryezë e rrumbullakët mbi

¹⁶ Anejda Rragami, Oltion Alibali dhe Erald Kapri.

¹⁷ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Shoqëria Civile, roli i saj në Transparencën e Industrisë Nxjerrëse', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

¹⁸ Shiko AlbEITI (Shkurt 2019), 'Updated EITI Albania Work-Plan 2018-2019', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

¹⁹ AlbEITI, Procesverbalet e mbledhjeve të MSG në 2018, aksesuar [këtu](#), dhe në 2019, aksesuar [këtu](#), në Mars 2019.

²⁰ Leviz Albania, Prezantim publik i projekteve të shoqërisë civile, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

"Transparencën dhe llogaridhënien në industrinë nxjerrëse në Shqipëri"²¹ që është përshkruar në Validimin e parë për Shqipërinë, Sekretariati AlbEITI duket se ka vazhduar të mbajë takime me shoqërinë civile, përfshirë përfaqësuesit e mediave. Për shembull, në Nëntor 2017, drejtori i AlbEITI, Ardit Kamberi mbajti një takim me gazetarët nga News 24, Ora News, Monitor, Panorama për të diskutuar rezultatet dhe gjetjet nga zbatimi i EITI dhe lidhjen e tyre me prioritetet kombëtare.²²

Qasja në vendimmarrje: Ekziston një evidencë në rritje e avokimit publik të shoqërisë civile në lidhje me zbatimin e EITI, veçanërisht në lidhje me diskutimet publike për sfidat në transfertat subnacionale të rentës tek njësitë e qeverisë lokale në periudhën e Nëntorit 2018 - Janar 2019. Disa anëtarë të MSG-së prej Organizatave të Shoqërisë Civile, përfshirë Anila Hajnaj dhe Sami Neza, janë cituar gjerësisht në shtypin lokal mbi përgatitjet dhe rezultatet e studimit mbi transfertat subnacionale të rentës²³, në vijim të një konference për shtyp në fund të Janarit 2019 mbajtur nga ACDI për prezantimin e raportit.²⁴ Një prej OShC-ve vlerësoi në mbi 1 milion numrin e shikuesve të katër transmetimeve televizive të intervistave për studimin mbi rentën të dhënë nga Anila Hajnaj në Nëntor të vitit 2018. Përfaqësuesit nga të gjitha grupet e interesit e konsideruan studimin mbi rentën nga ACDI si një arritje domethënëse për këtë grup interesi në tërësi. Sidoqoftë, ka pak evidencë për avokimin publik dhe lobim të shoqërisë civile për çështje të tjera teknike dhe mbi gjetjet e raportimit të EITI.

Sidoqoftë, një nga OShC-të e konsultuara sqaroi se grupi kishte ide për projekte të tjera që lidhen me përdorimin e të dhënave të EITI-t, në fushat e gjurmimit të shpenzimeve sociale të kompanive nxjerrëse dhe vlerësimit të devijimeve të rregulloreve ligjore në praktikë. Në komentet me shkrim, si pjesë e konsultimeve me grupet e interesit, një anëtar i MSG nga OShC vuri në dukje se prioritetet për zbatimin e EITI nga OShC të cilat nuk përfaqësohen drejtpërdrejt në MSG, përfshinin forcimin e zërit të tyre në proceset vendimmarrëse në nivel lokal lidhur me të drejtat e komuniteteve, çështjet mjedisore dhe sociale, transparencën e rentës dhe transparencën në mbledhjen e të ardhurave dhe transfertat kundrejt njësisë të qeverisjes vendore dhe avokimin për të rritur normat e rentës subnacionale nga 5% në 25%. Këto çështje u diskutuan në seminarin e ACDI për shoqërinë civile të lidhur me EITI që u mbajt më 11-12 Shkurt 2019.²⁵

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korrigjues për angazhimin e shoqërisë civile është adresuar pjesërisht dhe konsideron se Shqipëria ka bërë progres domethënës me përmirësime të konsiderueshme në kërkesën 1.3. Nuk ka evidencë që prej Validimit të parë të ndonjë pengesë ligjore, rregulatore ose praktike për aftësinë e shoqërisë civile për t'u angazhuar në EITI dhe as për aftësinë e tyre për të vepruar lirshëm, për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me grupimin e shoqërisë civile në tërësi. Nuk ka evidencë që grupi i shoqërisë civile të ketë hartuar dhe shpalosur një plan veprimi për adresimin e mangësive në angazhimin e shoqërisë civile të dokumentuara në Validimin e parë, brenda tre muajve nga vendimi i Bordit, dmth deri më 13 Maj 2018, në përputhje me kërkesën 8.3.c.i. Megjithatë, një nga organizatat e shoqërisë civile që udhëhiqnin zbatimin e EITI zhvilloi një projekt të financuar nga Zvicra për të adresuar mangësitë e kapaciteteve brenda grupit të shoqërisë civile dhe për të krijuar mekanizma të koordinimit të grupit, megjithëse zbatimi i projektit filloi vetëm në dhjetor 2018. Ndërsa ka evidenca se kohët e fundit janë ngritur mekanizma për koordinimin e grupit dhe mbledhjen e opinionëve,

²¹ EITI Albania (Korrik 2018), 'Raporti Vjetor i Progresit 2017', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

²² EITI Albania (Korrik 2018), 'Raporti Vjetor i Progresit 2017', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

²³ Shiko për shembull: Reporter.al (Qershor 2018), 'Mallkimi i burimeve: Bashkitë shohin pak përfitim dhe shumë kosto nga industria nxjerrëse', aksesuar [këtu](#); Gazeta Shqiptare (Shkurt 2019), 'Bashkitë nuk e marrin të plotë rentën, shkak burokracia e mosnjohja e ligjit', aksesuar [këtu](#); Agjencia Telegrafike Shqiptare (Janar 2019), 'Sondazhi, bashkitë nuk përfituan maksimalisht nga renta minerare', aksesuar [këtu](#); TV Bulqize (Janar 2019), 'Bulqize. Bashkëbisedim mbi efektet e rentes minerare', aksesuar [këtu](#); Droni.al (Janar 2019), 'Qeveria të japë gjithë rentën minerare për bashkitë e vogla', aksesuar [këtu](#); Droni.al (Janar 2019), 'Renta minerare, qeveria duhet të përmirësojë procedurat e përfitimit të rentës nga bashkitë', aksesuar [këtu](#); all aksesuar në Shkurt 2019.

²⁴ Mining Royalty for Communities (Janar 2019), Deklarate per Shtyp në një postim në Facebook, aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

²⁵ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Shoqëria Civile, roli i saj në Transparencën e Industrisë Nxjerrëse', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

në kontakte më të rregullta e të vazhdueshme dhe në ripërtëritjen e përfaqësimit të këtij grupi në MSG të AlbEITI, numri i organizatave të përfshira në zonën zgjedhore duket ende shumë i ngushtë. Ekziston një evidencë në rritje e kontributit të shoqërisë civile për diskutimet teknike, përhapjen dhe përhapjen e MSG-së, megjithëse kjo duket të jetë tërësisht e përqendruar në transfertat subnacionale të familjes sesa në çështje të tjera që lidhen me EITI. Ndonëse grupi ka bërë progres në adresimin e mangësive të identifikuara në Validimin e parë, shumë aktorë të konsultuar konsideruan se angazhimi i shoqërisë civile mbeti një punë në progres, në pritje të zgjerimit të përpjekjeve për informim të OShC-ve të tjera që kanë interes për industrinë nxjerrëse dhe menaxhimin e financave publike.

Në përputhje me kërkesën 1.3.e, aktorët e shoqërisë civile, duke përfshirë, por pa u kufizuar, anëtarët e MSG duhet të angazhohen kryesisht në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI dhe të sigurojnë që të kontribuojë në debatin publik. Grupi i shoqërisë civile inkurajohet të zbatojë në praktikë të gjitha dispozitat e Kodit të Sjelljes, duke përfshirë ato që lidhen me koordinimin e rregullt dhe shqyrtimin e pikëpamjeve dhe të sigurojnë që të kryhet një kontaktim i përshtatshëm më të gjitha OShC-të me interes të mundshëm në zbatimin e EITI.

3.2 Veprimi korrigjues 2 (#1.4)

Në përputhje me kërkesën 1.4.a.ii, MSG duhet të sigurojë që procedurat e saj për emërimin dhe ndryshimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit të jenë publike dhe të konfirmojë të drejtën e secilit grup interesi për të emëruar përfaqësuesit e vet. Për të forcuar zbatimin, qeveria inkurajohet të sigurojë që subjektet përkatëse shtetërore, siç është kompania kombëtare e naftës Albpetrol, që ka mangësi në raportimin e pjesëmarrjes së shtetit (shiko kërkesën 2.6), të jenë të përfaqësuara në MSG dhe se rangu i pozicionit të përfaqësuesve pjesëmarrës të jetë i përputhshëm me nevojën që ka MSG për marrjen e vendimeve të informuara dhe në ndjekjen prej tyre në vijim të veprimeve të dakordësuara. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.ii dhe 1.4.b.iii, MSG duhet të ndërmarrë aktivitete efektive në terren me grupet e shoqërisë civile dhe kompanitë, duke përfshirë komunikimin përmes medias, faqeve të internetit dhe korespondencë me letra për të informuar palët e interesuara mbi angazhimin e qeverisë për të zbatuar EITI, dhe rolin qendror të kompanive dhe të shoqërisë civile. Anëtarët e MSG duhet të mbajnë lidhje me grupet e tyre përkatëse të interesit. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.vi, MSG duhet të sigurojë një proces vendimmarrjeje gjithëpërfshirëse gjatë gjithë zbatimit, veçanërisht për sa i përket industrisë dhe shoqërisë civile. Rekomandohet gjithashtu që MSG të rishikojë procedurat e vlerësimit për anëtarët e saj, për të cilat të gjitha grupet do të bien dakord që t'i ndjekin.

Gjetjet nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. MSG ishte formuar dhe përfshinte përfaqësues të vetë-emëruar nga secili grup interesi, pa asnjë sugjerim, ndërhyrje apo shtrëngim, megjithëse mungesa e përfaqësimit në MSG në raport me diversitetin e industrisë nxjerrëse dhe shoqërisë civile shqiptare ishte një shqetësim. MSG kishte miratuar Terma Reference (TeR) të qarta që adresonin pjesën më të madhe të kërkesës 1.4 të standardit EITI. Ndërsa TeR-të nuk kishin dispozita të tilla si emërimi i Autoritetit të Pavarur, angazhimi për Validim dhe ushtrimi i të drejtës për të paraqitur një çështje për diskutim, u pa se më së shumti këto dispozita u zbatuan në praktikë. Ndërsa TeR të MSG-së sugjeronin se shoqëria civile dhe kompanitë ishin të lira të zgjidhnin anëtarët e tyre në mënyrë të pavarur sipas kritereve të tyre, nuk kishte procedura të përcaktuara qartë për përzgjedhjen e anëtarëve të MSG, përveç Kodit të Sjelljes të shoqërisë civile që nuk u pa të zbatohet, dhe Memorandumit të përgjithshëm ndërmjet Alb-EITI dhe FIAA, i cili nuk sqaronte procedurat e përzgjedhjes. Ndërsa anëtarët MSG duket se merrnin pjesë rregullisht në mbledhjet e MSG dhe mbanin

shënimet përkatëse, kishte pak dëshmi të pjesëmarrjes së MSG në publikime informacioni dhe aktivitetet në terren, të cilat u drejtuan nga sekretariati. Ndërsa kapaciteti shfaqej i fortë tek grupi i qeverisë dhe industrisë, kishte pak evidencë që anëtarët e MSG nga shoqëria civile kishin kapacitete të mjaftueshme, veçanërisht financiare, për të kryer detyrat e tyre. Në përgjithësi, u duk se Sekretariati Alb-EITI udhëhoqi zbatimin e EITI, me mbikëqyrje të kufizuar nga MSG.

Progresi që prej Validimit

Kompozimi dhe anëtarësia e MSG: MSG i EITI shqiptar (AlbEITI) vijon të qeveriset nga Urdhëri i Kryeministrit Nr. 71 dt 21 Korrik 2011²⁶ dhe përtëritja e Termave të Referencës (TeR) të MSG²⁷ në vitin 2017. Urdhërin Nr. 71 dhe TeR-të përcaktojnë anëtarësinë prej 16 vetësh të MSG, duke përfshirë gjashtë anëtarë nga qeveria dhe nga pesë anëtarë respektivisht nga industria dhe shoqëria civile së bashku me Zëvendësministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë si kryesues i MSG, strukturë që duket se është respektuar në praktikë bazuar në detajet e anëtarësimit të MSG në faqen e internetit AlbEITI.²⁸ Sidoqoftë, faqja e internetit e AlbEITI dhe procesverbalet e mbledhjeve të MSG tregojnë se në praktikë, shtatë agjenci qeveritare mbajnë pozita si "kontribues të përhershëm në procesin e EITI" duke vepruar si burime ekspertësh për MSG. Përveç kësaj, një anëtar i gjashtë MSG nga industria, që përfaqëson sektorin e hidrocentraleve²⁹, është shënuar si "në pritje të konfirmimit" në faqen e internetit AlbEITI. Duket se ka pasur rinovime të përfaqësimit të industrisë dhe shoqërisë civile në MSG në periudhën 2018-2019.

Përfaqësimi i shoqërisë civile: Kodi i Sjelljes i shoqërisë civile, i miratuar në 2015 i publikuar në faqen e internetit AlbEITI³⁰, kodifikon procesin e emërimit të anëtarëve të shoqërisë civile në MSG përmes zgjedhjeve të hapura. Përveç kësaj, pas fillimit të Validimit në Mars 2019, faqja e internetit të AlbEITI publikoi një pasqyrë të procedurave për emërimin e përfaqësuesve të shoqërisë civile në MSG.³¹

Grupi i shoqërisë civile rinovoi përfaqësimin e tij në MSG në vijim të zgjedhjeve të mbajtura më 12 Shkurt 2019, një ditë para fillimit të Validimit të dytë për Shqipërinë. Në përputhje me Kodin e tyre të Sjelljes (Kapitulli 1), grupi i shoqërisë civile pranoi një thirrje për shprehje interesi nga OShC të interesuara për pjesëmarrje në nominimet e EITI, e cila u botua me anë të një letre nga Zëvendës Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Ilir Bejtja, botuar në faqen e internetit AlbEITI në Janar 2019.³² Më 11-12 Shkurt 2019, organizata ACDI, drejtorja ekzekutive e të cilës, Anila Hajnaj, është një anëtare e vjetër e MSG AlbEITI, organizoi një seminar me temë "Shoqërië Civile, roli i saj në Transparencën e Industrisë Nxjerrëse" me financim nga SECO, i cili përbëhej nga dy ditët dedikuar ngritjes së kapaciteteve për një grup të përzgjedhur prej 12 OShC-sh e që u përmyll me zgjedhjen e pesë anëtarëve të OShC-ve në MSG.³³ Tre³⁴ nga pesë anëtarët e hershëm përfaqësues të OShC-ve u zëvendësuan nga përfaqësues të rinj, ndësa për dy anëtarë të hershëm të MSC u bë ripërtëritja e mandateve³⁵. Tre anëtarët e rinj të MSG përbëhen nga dy

²⁶ Faqja e internetit AlbEITI, seksioni 'Multi-Stakeholder Group', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

²⁷ AlbEITI (Prill 2015), 'Extractive Industries Transparency Initiative Albania (EITI Albania) Multi-Stakeholder Group (EITI Albania MSG) Terms of Reference', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

²⁸ Faqja e internetit AlbEITI, seksioni 'Multi-Stakeholder Group', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

²⁹ Një perfaqësues nga Devoll Hydropower Sh.a. / Statkraft.

³⁰ Shiko Faqja e internetit AlbEITI, Regulation of the multi-stakeholder group section - Annex: Code of Conduct of Civil Society Organizations Involved in the EITI Process, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

³¹ AlbEITI (Mars 2019), 'PROÇESI I PËRZGJEDHJES TË SHOQËRISË CIVILE', aksesuar [ketu](#) nw Mars 2019.

³² Ministria e Energjisë dhe Industrisë (Janar 2019), 'Ftese për shprehje interesi për pjesëmarrje shoqatave apo individëve perfaqësues të shoqërisë civile', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

³³ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Shoqëria Civile, Roli i saj në Transparencën e Industrisë Nxjerrëse', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

³⁴ Ilir Aliaj nga Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, Baki Bajraktari nga Sindikata e Minatoreve Bulqize dhe Madlina Puka nga Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim.

³⁵ Anila Hajnaj nga Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim dhe Sami Neza nga Qendra për Transparencë dhe Informim të Lire.

juristë³⁶ dhe një gazetar investigativ.³⁷ Procesi zgjedhor, i cili u monitorua nga partnerë zhvillimi dhe OShC, si Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, duket se ka qenë i hapur, i drejtë dhe transparent. Faqja e internetit Albnet-EITI ofron një pasqyrë të procesit zgjedhor, duke përfshirë numrin e votave për secilin nga kandidatët e suksesshëm.³⁸ Anëtarësia e re e shoqërisë civile në MSG³⁹ duket të jetë përfaqësuese e diversitetit të OShC-ve në Shqipëri, duke përfshirë organizatat e fokusuara në miniera, naftë dhe gaz, hidro-energjitikë dhe përfshin dy gra nga totali prej pesë përfaqësuesish. Të gjithë aktorët e konsultuar shprehën kënaqësinë e tyre me procedurat e zgjedhjeve - si për kuadrin statutor ashtu edhe për zbatimin në praktikë në shkurt 2019 - për emërimin e anëtarëve të MSG të shoqërisë civile. Sidoqoftë, disa partnerë nga qeveria dhe partnerët e zhvillimit konsideruan se grupi i OShC-ve zyrtarisht pjesë e grupit të shoqërisë civile me vetëm 12 organizata është ende i ngushtë dhe bënë thirrje për shtrirje të mëtejshme të shoqërisë civile tek OShC të fokusuara në çështje të tilla si ndikimet mjedisore, qeverisja e mirë dhe informacione të hapura (shiko kërkesa 1.3).

Përfaqësimi i industrisë: Nuk ka evidence, që nga Validimi i parë, që grupi i interesit i industrisë të ketë kodifikuar procesin e tyre për emërimin e anëtarëve të MSG-së. Ndërsa partnerët e konsultuar konfirmuan se ende përdoret i njëjti proces si ai i përshkruar gjatë Validimit të parë, domethënë që Komisioni i Naftës dhe Minerave i Shoqatës së Investitorëve të Huaj (FIAA) pati rënë dakord me përfaqësuesit gjatë një prej takimeve të tyre të zakonshme, ata konfirmuan se deri më sot këto procedura nuk janë kodifikuar publikisht. Megjithatë, ata konsideruan se mungesa e publikimit të procedurave të emërimit të anëtarëve të grupit të industrisë në MSG ishte një harresë dhe nuk shprehën asnjë kundërshtim në propozimin për të publikuar një përshkrim të procesit në faqen e internetit të FIAA. Pas fillimit të Validimit në Mars të vitit 2019, grupi i interesit i industrisë publikoi procedurat e emërimit të përfaqësuesve të tyre në MSG në faqet e internetit të FIAA dhe AlbEITI.⁴⁰ Përfaqësues të konsultuar me përkatësi nga grupi i industrisë konfirmuan se FIAA kishte udhëhequr rinovimin e përfaqësimit të anëtarëve MSG prej industrisë në gjysmën e parë të vitit 2018. Ata shpjeguan se Komisioni i Naftës dhe Minerave i FIAA kishte udhëhequr procesin për emërimin e pesë përfaqësuesve të rinj të MSG, por që qeveria i kishte kërkuar Albpetrolit (përmes një letre nga Kryetari i MSG-së) që të emëronte në MSG një përfaqësues të gjashtë të industrisë nga një Ndërmarrje Shtetërore (NSH), siç është dokumentuar në procesverbalin e mbledhjes së MSG-së më 15 Maj 2018.⁴¹ Ndërsa shumica e përfaqësuesve të industrisë së konsultuar konsideronin që Albpetrol të jetë pjesë e grupit të interesit të qeverisë, vetë përfaqësuesit e grupimit të qeverisë e konsideronin atë të jetë pjesë e grupit të industrisë. Në diskutime, MSG shpjegoi se përfaqësuesi i Albpetrol ishte emëruar në përputhje me rekomandimet e buta nga Validimi i parë i Shqipërisë, dhe jo si rezultat i nominimeve të grupit të industrisë. Përfaqësuesit e konsultuar të industrisë shpjeguan se pesë anëtarët e MSG-së nga industria ishin përzgjedhur në bazë të pozicionimit si investitorët më të mëdhenj në industrisë nxjerrëse të Shqipërisë, si dhe të gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë plotësisht në zbatimin e EITI. Ndërsa shumica e përfaqësuesve të industrisë konsultuan konsideruar që Albpetrol të jetë pjesë e elektoratit qeveritar, përfaqësuesit e qeverisë e konsideronin atë të jetë pjesë e zonës së industrisë. Në diskutim, MSG shpjegoi se përfaqësuesi i Albpetrol ishte emëruar në përputhje me rekomandimet e buta nga Validimi i parë i Shqipërisë, dhe jo si rezultat i nominimeve të zonës së industrisë. Përfaqësuesit e industrisë konsultuar shpjeguan se pesë anëtarët e MSG-ve të industrisë ishin përzgjedhur si një nga investitorët më të mëdhenj në industrinë nxjerrëse të Shqipërisë, si dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë plotësisht në zbatimin e EITI. Ata vunë në dukje se disa kompani të mëdha nxjerrëse në pronësi lokale si AlbChrome kishin refuzuar të merrnin një rol proaktiv në

³⁶ Lorenc Gordani nga Qendra Shqiptare për te Drejta Nderkombetare dhe Kushtrim Simoni nga Qendra e Studimit të Politikave të Medias.

³⁷ Ola Mitre nga Grate per Mbrojtjen e Burimeve Natyrore.

³⁸ Albnet-EITI (Mars 2019), 'Seminari i Shoqërisë Civile', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

³⁹ Faqja e internetit AlbEITI, seksioni 'Multi-Stakeholder Group', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁴⁰ FIAA (Mars 2019), 'FIAA is part of the Multi Stakeholders Group at EITI Secretariat Albania', aksesuar [këtu](#); and AlbEITI (Mars 2019), 'PROÇESI I PËRZGJEDHJES TË INDUSTRIËS', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁴¹ Shiko Faqja e internetit AlbEITI, Procesverbalin i Mbledhjes 15 Maj 2018, aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

zbatimin e EITI pavarësisht kontaktimit të tyre nga FIAA dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Pavarësisht nga mungesa e kompanive nxjerrëse në pronësi vendore në MSG, gjë e cila përkeqësohet më tej dhe nga mungesa e shoqatave të industrisë për ndërmarrjet e nxjerrjes në pronësi vendore në Shqipëri, aktorët e konsultuar konsideronin që përfaqësimi i industrisë në MSG ishte gjerësisht përfaqësues i strukturës së industrive nxjerrëse të Shqipërisë. Disa palë të interesuara të industrisë shprehën kënaqësi në faktin se kompanitë hidroenergjitike tani ishin të përfaqësuara drejtpërdrejt në MSG.

Përfaqësimi i Qeverisë: Përfaqësimi i qeverisë duket se ka vazhduar të përcaktohet në përputhje me Termat e Referencës të MSG (paragrafi VII / b), përkatësisht përmes emërimit nga krerët e institucioneve të tyre përfaqësuese brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për përfaqësues të rinj nga Sekretariati AlbEITI. Ka pasur vetëm ndryshime të përkohshme në përfaqësim në periudhën 2018-2019. Për shembull më 28 Janar 2019, Ilir Bejtja u emërua për të zëvendësuar Enis Aliko si Zëvendës Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë⁴², duke e zëvendësuar atë si Kryetar i EITI MSG, siç konfirmohet në faqen e internetit AlbEITI në Shkurt 2019.⁴³ Ilir Bejtja më parë ka mbajtur këto poste nga Tetori 2013 deri në Shtator 2017.⁴⁴ Pas fillimit të Validimit në Mars të vitit 2019, faqja e internetit AlbEITI publikoi një pasqyrë të procedurave të nominimeve në MSG nga entitetet qeveritare.⁴⁵

Termet e referencës: Termat e Referencës (TeR) të MSG-së mbeten të pandryshuara që nga përditësimi i vitit 2017 të botuar në faqen e internetit AlbEITI.⁴⁶ Siç përshkruhet në Validimin e parë për Shqipërinë, këto TeR mbulojnë të gjitha aspektet e renditura në kërkesën 1.4.b. TeR-të e MSG-së duket se janë ndjekur gjerësisht në praktikë, bazuar në shqyrtimin e procesverbaleve të mbledhjeve të MSG dhe konsultimeve me palët e interesuara. Që nga Validimi i parë, MSG ka vazhduar përpjekjet e saj për të lobuar që Parlamenti të miratojë një Projektligj mbi Transparencën, që mbulon dispozitat kryesore të EITI, të hartuara nga kontraktori i saj Eurosupport-Fineurop Support S.r.l në 2017.⁴⁷ Plani i përditësuar i punës i EITI 2018-2019 parashikon miratimin e Ligjit për Transparencën dhe rregulloreve zbatuese deri në Dhjetor 2019.⁴⁸

Përfaqësimi:

Ekziston një evidencë në rritje e konsultimeve nga grupet e interesit në lidhje me çështjet e lidhura me EITI nga të tre grupet e interesit edhe pse vetëm në muajt e fundit para fillimit të Validimit të dytë për Shqipërinë. Përfaqësuesit e shoqërisë civile të konsultuar konfirmuan se kishin krijuar dy grupe të mesazheve WhatsApp (një për anëtarët e MSG prej OSHC-ve dhe një për 12 anëtarët e grupit më të gjerë), përmes të cilave ata kërkonin mendime përpara mbledhjeve të MSG (shiko kërkesa 1.3).

Disa përfaqësues të industrisë vunë në dukje se anëtarët e grupit të industrisë në MSG konsultoheshin me kompanitë nxjerrëse (me investim) të huaj/a nëpërmjet Komisionit të Naftës dhe Minerave të FIAA-s. Ata gjithashtu vunë në dukje se kishin informuar ndërmarrjet lokale të nxjerrjes së qymyrit për të përmirësuar nivelin e pjesëmarrjes së kompanive minerare në raportimin EITI dhe për të kërkuar interesim për t'u bashkuar me MSG, megjithëse ata vunë në dukje se kompanitë e mëdha lokale si AlbChrome kishin refuzuar të merrnin një rol më aktiv në zbatimin e EITI. Përfaqësuesit e industrisë dhe shoqërisë civile të konsultuar theksuan debatet mbi formulën e ndarjes së të ardhurave nga renta në baza subnacionale si

⁴² Albanian Daily News (Janar 2019), 'Director of KESH dismissed', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁴³ AlbEITI (Shkurt 2019), 'The appointment of new Chairman of Multi-Stakeholder Group (MSG)', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁴⁴ Faqja e internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, 'Ilir Bejtja, Deputy Minister', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁴⁵ AlbEITI (Mars 2019), 'PROÇESI I PËRZGJEDHJES TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁴⁶ AlbEITI (Prill 2015), 'Extractive Industries Transparency Initiative Albania (EITI Albania) Multi-Stakeholder Group (EITI Albania MSG) Terms of Reference', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁴⁷ EITI Albania (Korrik 2018), '2017 Raporti Vjetor i Progresit', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁴⁸ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Updated EITI Albania Work-Plan 2018-2019', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

çështje për të cilat të dy grupet ishin veçanërisht të angazhuara përmes advokimit publik mbi çështje të lidhura me EITI.

Në bazë të konsultimeve me palët e ndryshme duket se anëtarët e MSG nga strukturat qeveritare konsultohen deri diku me institucionet e tyre përkatëse si pjesë e pjesëmarrjes së tyre në mbledhjet e MSG. Megjithatë, kur u pyetën përse anëtarët e MSG nga industria miratuan garantimin e cilësisë (çertifikimin) e raportimit të kompanive nga EITI, kur shumë pak nga kompanitë raportuese i ndjekin këto procedura në praktikë, anëtarët e MSG nga industria shpjeguan se kishin keqkuptuar kërkesën për çertifikimin e auditorit të jashtëm të raportimit EITI si një kusht të imponuar nga Bordi Global EITI.

Qeverisja e brendshme dhe vendimmarrja: Evidenca e vënë në dispozicion gjatë Validimit dhe konsultimeve me palët e interesuara konfirmuan se MSG vazhonte t'i përmbahej Termave të saj të Referencës në praktikë në periudhën 2018-2019. Shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të MSG në faqen e internetit të AlbEITI tregon se MSG u mbledh gjashtë herë në 2018 dhe dy herë në dy muajt e parë të vitit 2019.⁴⁹ Të gjithë aktorët e konsultuar konfirmuan se çdo anëtar i MSG ishte në gjendje të paraqiste çështje për diskutim dhe se njoftimi i mbledhjeve dhe qarkullimi i dokumenteve përkatëse janë realizuar mjaftueshëm në kohë përpara mbledhjeve të MSG. Anëtarët MSG të konsultuar konfirmuan se të gjitha vendimet e MSG në periudhën 2018-2019 ishin marrë me konsensus, siç konfirmohet nga shqyrimi i procesverbaleve të mbledhjeve të MSG. Palët e interesuara të konsultuara, përfshirë edhe shoqërinë civile, konfirmuan që diskutimet dhe vendimet e MSG-së që nga Validimi i parë i kishin trajtuar të gjithë grupet e interesit si partnerë të barabartë.

Në lidhje me përcaktimet në Termat e Referencës për Kryetarin e MSG-së për të ndërmarrë vlerësime vjetore të anëtarëve të MSG-së, të cilat kanë qenë kontroverse gjatë Validimit të parë, procesverbali i mbledhjeve të MSG-së tregon se MSG ka rënë dakord me procedurat e vlerësimit në mbledhjen e 15 Majit 2018⁵⁰ dhe ka diskutuar vlerësimin për 2018 në mbledhjen e saj të 7 Dhjetorit 2018.⁵¹ Asnjë nga anëtarët MSG të konsultuar nuk shprehu ndonjë shqetësim në lidhje me zbatimin e vlerësimeve në praktikë. Një kopje e vlerësimit të vitit 2018 të anëtarëve të MSG të ofruara nga Sekretariati AlbEITI dëshmoi se vlerësimi përbëhej vetëm nga një tabelë frekuentimi të anëtarëve të MSG (të dhënë në Shtojcën A).

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që Veprimi korrigjues për mbikëqyrjen e Grupit Ndërinstitucional është trajtuar dhe konsideron se Shqipëria ka bërë progres të kënaqshëm në kërkesën 1.4. MSG është formuar dhe përfshin përfaqësues të vetë-emëruar nga secili grup interesi pa asnjë shenjë ndërhyrje apo shtrëngimi, edhe pse procedurat e emërimeve për grupin e industrisë nuk ishin ende cilësuar publikisht në fillim të Validimit (13 Shkurt 2019). Cilësimet për emërimet e përfaqësuesve të industrisë u publikuan në faqet e internetit të AlbEITI dhe shoqatës së industrisë (FIAA) pas fillimit të Validimit, në Mars të vitit 2019. Megjithëse i aplikuar vetëm për një duzinë OShC-sh, mekanizmi për emërimin e anëtarëve të shoqërisë civile në MSG ishte i hapur për publikun në Shkurt të vitit 2019, dhe anëtarët e MSG-së nga shoqëria civile janë të pavarur nga qeveria dhe kompanitë operacionale dhe në terma të politikave. Informacioni mbi procedurat e emërimeve është i disponueshëm publikisht. Termat e Referencës (TeR) për MSG trajtojnë kërkesat e Standardit EITI dhe grupet e interesit nuk kanë theksuar ndonjë devijim të rëndësishëm nga TeR në praktikë. Mbledhjet e MSG janë mbledhur me njoftime paraprake të mjaftueshme dhe anëtarët e MSG në përgjithësi duket se kanë kohë të mjaftueshme për të

⁴⁹ Faqja e internetit AlbEITI, seksioni 'Mbledhjet e MSG', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁵⁰ Faqja e internetit AlbEITI, Procesverbali i Mbledhjes 15 Maj 2018, aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁵¹ Faqja e internetit AlbEITI, Procesverbali i Mbledhjes 7 December 2018, aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

shqyrtuar dokumentet përpara takimeve. Pjesëmarrja e mazhorancës së anëtarëve të MSG është e qendrueshme. MSG nuk praktikon një politikë për dhënie dietash.

Për të forcuar zbatimin, AlbEITI inkurajohet të sigurojë që procedurat e emërimeve të MSG nga çdo grup interesi të cilësohen publikisht dhe që të gjitha ndryshimet në anëtarësinë e MSG të gjurmohen në faqen e internetit AlbEITI. Shqipëria mund të dëshirojë të marrë në konsideratë mundësi të tjera për të përfshirë publikimin sistematik të të dhënave me mbikëqyrjen shumëpalëshe EITI në legjislacionin kombëtar.

3.3 Veprimi korigjues 3 (#2.2)

Në përputhje me kërkesën 2.2.a, MSG duhet të sigurojë publikimin vjetor të të dhënave mbi liçensat e minierave, naftës dhe gazit që janë dhënë dhe transferuar në vitin/vitet nën shqyrtim, theksimin e kërkesave teknike dhe financiare dhe çdo shmangie të rëndësishme nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator që rregullon dhënien dhe transferimet e liçensës.

Gjetjet nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Ndërsa Raporti i EITI 2015 jepte një listë të liçensave minerare të dhëna në vitin 2015 dhe nënkuptonte se asnjë liçensë e re për naftë dhe gaz nuk ishte dhënë në vitin 2015, ai përshkroi vetëm procesin ligjor të alokimit të liçensave, duke përfshirë kriteret teknike dhe financiare, por jo ndonjë devijim në praktikë. Kishte evidencë për dhënie të një license naftë dhe gazi në Korrik 2015. Procesi i transferimit të liçensave përshkruhej për sektorin e naftës dhe gazit, por jo për minierat dhe raporti nuk tregonte qartë nëse lejohej dhënia e liçensave të minierave, naftës dhe gazit në vitin në shqyrtim. Duke pasur parasysh faktin se liçensat e minierave janë dhënë përmes ofertimit, lista e ofertuesve të pasuksesshëm dhe kriteret e ofertës aktuale për secilën raund duhet të ishte zbardhur.

Progres që prej Validimit

MSG i EITI Shqipëri miratoi dhe publikoi Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Akordimet/transfertat: Në *naftë dhe gaz*, raporti EITI i vitit 2016 konfirmon lidhjen e një *Kontrate të re me Ndarje Prodhimi* (KNP) me Albanides Energy për Blloqun 8, në Mars 2016 (fq.30). Raporti gjithashtu përshkruan dhënien e KNP-ve në 2015 dhe 2017 (fq.30) dhe dy liçensa për rafinimin e naftës në 2016 (fq. 32). Përsa i përket transfertave, raporti përmend transferimet e interesave në shtatë liçensa të naftës dhe gazit në vitin 2016 (fq.27-30). Raporti thotë se Shell mori kontrollin e 100% të aksioneve në Blloqet 2 dhe 3 nga Petromanas Albania GmbH, si dhe të gjitha operacionet e kompanisë shqiptare në Shkurt 2016 (fq.28). Raporti gjithashtu përshkruan blerjen e GBC Oil me 100% të aksioneve në katër fusha naftë (Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe Kondensatin e Delvinës) nga TransAtlantic Petroleum në Shkurt 2016 (fq.29). Së fundmi, raporti përshkruan transferimin e aksioneve në fushën e naftës Rasë-Pakisht nga Phoenix Petroleum në Fin Pek Petroleum në Maj 2016 (fq.178).

Në sektorin e *minierave*, ndërsa Raporti i EITI 2016 nuk i referohet numrit ose identitetit të liçensave minerare të dhëna në vitin 2016, regjistri i liçensave minerare të publikuara në faqen e internetit AlbEITI në vitin 2018, liston 66 liçensa të dhëna në vitin 2016⁵². Nuk ka asnjë informacion mbi transferimet e lejeve të minierave në vitin 2016, as në Raportin e EITI 2016, as në listën e liçensave minerare të publikuara në faqen e internetit AlbEITI. Një zyrtar i lartë qeveritar i konsultuar konfirmoi se kishte pasur transferime të liçensave minerare në vitin 2016. Ndërsa zyrtari konsideronte se Regjistri Kombëtar i

⁵² AlbEITI (2018), Regjistri i liçensave minerare, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

Liçensave dhe Lejeve ofronte të gjithë informacionin e nevojshëm për transfertat e liçensave, përfshirë emrat e transferuesit dhe pritësit, datën e transferimit, si dhe vetë dokumentin e transferimit, faqja e internetit [e regjistrit kombëtar]⁵³ duket se nuk e jepte këtë informacion kur u shqyrtua nga Sekretariati Ndërkombëtar.

Procesi i akordimit/transferimit:

Në sektorin e *naftës dhe gazit*, ndërsa Raporti i EITI 2016 nuk jep një përshkrim të procesit të dhënies së liçensave të transferuara, ai jep links (lidhje) me seksionet përkatëse të faqeve të internetit të MEI⁵⁴, AKBN⁵⁵ dhe Albpetrol⁵⁶ (fq. 39), në të cilat përshkruhet procesi i dhënies dhe transferimit të liçensave. Liçensat për naftë dhe gaz mund të jepen nëpërmjet ofertave konkurruese ose përmes negociatave të drejtpërdrejta.

Në sektorin e *minierave*, Raporti i EITI 2016 ofron një përshkrim të hollësishëm të procesit të dhënies dhe transferimit të liçensave (fq.64-66), përmes raundeve të ofertave për zonat minerare konkurruese dhe përmes negociatave të drejtpërdrejta dhe mbi bazën e parimit të radhës (i shërbehet të parit që vjen) për zonat minerare të hapura. Një zyrtar i lartë i qeverisë konfirmoi se të gjitha liçensat për minerale janë dhënë përmes ofertimit (rreth 90% të numrit të liçensave minerare të dhëna çdo vit), ndërsa akordimet mbi bazën e parimit të të shërbyerit të parit që vjen janë përdorur vetëm për liçensa guroresh që mbulojnë materialet e ndërtimit. Liçensat e dhëna për gurore kanë qenë liçensa të përkohshme për tre vjet.

Kriteret teknike dhe financiare: Për *naftën dhe gazin*, raporti jep një pasqyrë sipërfaqësore të kriterëve teknike dhe financiare të vlerësuar në dhënien e marrëveshjeve të naftës (fq.40), por nuk jep kriteret specifike teknike dhe financiare të vlerësuara. Sipas një zyrtari të lartë qeveritar të konsultuar, Ligji shqiptar i Eksplorimit dhe Prodhimit i ndryshuar në 2017 për t'u përafuar me rregulloret e BE, kërkon që informatat mbi kriteret teknike dhe financiare të jenë në dispozicion në faqen e internetit të MIE. Zyrtari konfirmoi se ekzistonin kriteret specifike teknike dhe financiare si për akordimet ashtu dhe për transferimet, pa diferenca në peshën e kriterëve pasi në të dy rastet që një aplikim të konsiderohej duhet të plotësoheshin të gjitha kriteret. Megjithatë, nuk ka evidencë se kriteret specifike teknike dhe financiare të vlerësuara për akordime dhe transferime të liçensave të naftës dhe gazit janë të aksesueshme për publikun. Zyrtari konfirmoi se kriteret teknike dhe financiare ishin përgjithësisht të njëjta për akordime dhe transferime, me një klauzolë shtesë që përcaktonte se qeveria mund të vërë veton për transferimet e liçensave që përfshijnë investitorët e huaj për arsye të sigurisë kombëtare. Disa aktorë qeveritarë të konsultuar konfirmuan se kriteret teknike dhe financiare përfshinin shqyrtimin e pasqyrave financiare të tre viteve të fundit, përvojën e mëparshme në kryerje punësh të ngjashme dhe CV të personelit të ekspertëve. Ata nuk e konsideronin sensitiv zbulimin e kriterëve specifike teknike dhe financiare për akordimet dhe transferimet e liçensave të naftës dhe gazit dhe mendonin se kjo tashmë duhet të ishte bërë.

Për sektorin *minerar*, raporti jep një pasqyrë sipërfaqësore të kriterëve teknike dhe financiare të vlerësuar në aplikimet për akordim liçensash përmes tenderave konkurrues (fq.65) dhe ofron link⁵⁷ në faqen e internetit të MIE ku publikohen thirrjet për tender ku përfshihen termat e referencës dhe kriteret e

⁵³ Regjistri Kombëtar i Liçensave dhe Lejeve, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019

⁵⁴ Faqja e Internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, 'Liçensat e blloqeve të nafes dhe gazit', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁵⁵ Faqja e Internetit të AKBN, 'Rregulloret për procedurat e miratimit të marrëveshjeve', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁵⁶ Faqja e Internetit Albpetrol, 'faqja e blloqeve', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁵⁷ Faqja e Internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Seksioni I lajmerimeve për tenderat për liçensa minerare, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

ofertimit. Megjithatë, raporti nuk përshkruan kriteret teknike dhe financiare të vlerësuara në aplikimet për dhënien e liçensës përmes parimit të të shërbyerit të parit që vjen dhe as kriteret e vlerësuara në transferimet e liçensave minerare. Zyrtarët qeveritarë të konsultuar thanë se kriteret teknike dhe financiare për akordimet dhe transferimet e liçensave minerare duhet të jenë të disponueshme në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit⁵⁸, por shqyrtimi i pavarur i faqes së internetit nuk ka identifikuar një listë të qartë të këtyre kriterëve.

Informacioni mbi përfituesit e liçensave: Për naftën dhe gazin, raporti cilëson emrin e kompanisë që i është dhënë KNP e re në vitin 2016 (fq.30) dhe emrat respektivë të kompanive transferuese dhe pritëse për liçensat e naftës dhe gazit të mbuluara nga KNP për të cilat janë transferuar aksionet pjesëmarrëse në vitin 2016 (fq.27 -29).

Për sektorin *minerar*, ndërsa raporti nuk jep emrat e kompanive që kanë marrë 66 liçensat e dhëna në vitin 2016, lista e liçensave minerare në faqen e internetit AlbEITI ofron këto emra⁵⁹. Për liçensat minerare të transferuara në vitin 2016, në kohën e fillimit të Validimit, nuk ka informacion të publikuar në faqen e internetit të AlbEITI apo në Raportin EITI 2016.

Devijimet jo të parëndësishme: për naftën dhe gazin, raporti i EITI i vitit 2016 thekson mungesën e qartësisë rreth procesit të ndjekur për dhënien e një KNP të realizuar në vitin 2016, duke vënë në dukje se "MIE nuk ka bërë të ditur nëse kjo kontratë është ndarë përmes një procesi tenderimi ose procesi negociues dhe kush ishin aplikantët jo fitues"(faqe 130) dhe se "metodat dhe kriteret e aplikuara për ndarjen e KNP-ve nuk janë zbuluar"(faqe 40). Raporti nuk komenton ekzistencën e devijimeve jo të parëndësishme në transferimet e aksioneve në liçensat e naftës dhe gazit në vitin 2016. Asnjë nga palët e konsultuara nuk ngriti shqetësime lidhur me devijimet jo të parëndësishme në dhënien e transferimit të liçensave të naftës dhe gazit, megjithëse disa përfaqësues të grupeve të qeverisë dhe shoqërisë civile mendonin se kishte raste të kompanive që devijonin nga programet e tyre të punës në praktikë gjatë periudhave të vlefshmërisë së liçensave.

Për sektorin *minerar*, raporti i EITI 2016 nuk komenton ekzistencën e devijimeve jo të parëndësishme në dhënien e liçensave në vitin 2016, por thekson se, sipas MIE, përfshirja e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) në mbikëqyrjen e bazës së drejtë dhe jodiskriminuese për akordimin e liçensave minerare "duhet të jetë e mjaftueshme për të parandaluar ndonjë praktikë të korruptuar ose diskriminuese dhe adresimin e shqetësimeve të pjesëmarrësve në kohën e duhur" (fq.66). Raporti nuk komenton për ndonjë devijim jo të parëndësishëm në transferimet e liçensave të minierave në vitin 2016, nëse ka patur të tilla.

Lista e ofertuesve për liçensat e dhëna nëpërmjet tenderave: Në naftë dhe gaz, Raporti i EITI i vitit 2016 nënkupton që asnjë liçensë nuk është dhënë përmes tenderit në vitin 2016 (fq.40). Përfaqësues të grupit të qeverisë, të konsultuar, konfirmuan se Blloku 8 i është dhënë Albanides Energy nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta dhe jo përmes një raundi të liçensimi. Kjo liçensë u anulua më pas në fund të vitit 2017.

Në sektorin *minerar*, edhe pse është e paqartë nga raporti se sa prej 66 licencave minerare të dhëna në vitin 2016 janë dhënë përmes tenderit konkurrues, një zyrtar i qeverisë i konsultuar, tregoi, se të gjitha licencat minerare janë dhënë përmes raundeve të licencimit dhe se procesi për ti shërbyer të parit në radhë u aplikua vetëm për liçencave për gurore për materiale ndërtimi, të cilat përbënin më pak se 10% të numrit të liçencave të dhëna mesatarisht. Raporti i EITI i vitit 2016 jep një link⁶⁰ për të aksesuar kriteret e ofertës për raundet e ofertimit të liçencave minerare (f.65). Raporti i EITI i vitit 2016 shpjegon se lista e aplikantëve që nuk fituan komunikohet përmes postës elektronike tek të gjithë ofertuesit, porse këto lista nuk janë të publikuara (f.65). Raporti shpjegon se MIE ka deklaruar se zbulimi i aplikantëve që nuk janë

⁵⁸ Regjistri Kombëtar i Lejeve dhe Liçensave, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019

⁵⁹ AlbEITI (2018), Regjistri i liçensave minerare, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶⁰ Faqja e Internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Seksioni mbi njoftimet për tenderat për liçensa, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

fitues nuk është e lejuar sipas Ligjit të Prokurimit Publik dhe se çdo ndryshim në ligj duhet të shqyrtohet me kujdes nga perspektiva e aplikantëve jo fitues (f.66).

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që Veprimi korrigjues për akordimin e licencave është adresuar pjesërisht dhe konsideron se Shqipëria ka bërë përparim domethënës me përmirësime të konsiderueshme në kërkesën 2.2. Raporti i EITI 2016 dhe regjistrat e licencave minerare, të naftës dhe gazit të publikuara në faqen e internetit AlbEITI identifikojnë licencat e minierave, naftës dhe gazit të dhëna në vitin 2016 dhe licencat e naftës dhe gazit në të cilat janë transferuar aksionet pjesëmarrëse në vitin 2016, por nuk listojnë licencat minerare që u transferuan në 2016. Ndërsa përshkrimet e proçeseve të përgjithshme për akordimin dhe transferimin e licencave janë të disponueshme publikisht si për minierat, ashtu edhe për naftën dhe gazin, nuk ka evidenca se kriteret e detajuara teknike dhe financiare për akordimet dhe transferimet e licencave të naftës dhe gazit ose për akordimin dhe transfertën e licencës minerare me parimin e të shërbyerit të parit në radhë (për gurore materialesh ndërtimi) të jenë në dispozicion të publikut. Konsultimet me palët e interesuara treguan se nuk ka ndonjë kufizim sa i përket zbulimit të listës së licencave minerare të transferuara në vitin 2016 dhe kriteret specifike teknike dhe financiare që vlerësohen për akordimet dhe transferimet e licencave si në miniera, ashtu edhe në naftë dhe gaz. Megjithëse Raporti i EITI 2016 nxjerr në pah vlerësimin nga ana e MSG të devijimeve jo të parëndësishme në akordimet e licencave të minierave, naftës dhe gazit, ai [raporti] nuk përshkruan qasjen e MSG për vlerësimin e devijimeve jo të parëndësishme në transferimet e licencave në vitin 2016. Raporti është transparent për kufizimet ligjore që pengojnë zbulimin e ofertave jo fituese për licencat e minierave të dhëna përmes garave të licencimit, megjithëse kjo mund të jetë një sfidë e rëndësishme për plotësimin nga ana e Shqipërisë të kërkesës 2.5 për zbulimin e të dhënave të pronësisë së kompanive që ofertojnë për licensa të industrisë nxjerrëse.

Në përputhje me kërkesën 2.2, Shqipërisë i kërkohet të publikojë një përshkrim gjithëpërfshirës të procesit për transferimin ose akordimin e licencave në miniera, naftë dhe gaz, duke përfshirë kriteret specifike teknike dhe financiare të vlerësuara. Aty ku licencat jepen përmes një proçesi ofertimi, qeverisë i kërkohet të zbulojë listën e aplikantëve (duke përfshirë aplikantët jo fitues).

3.4 Veprimi korrigjues 4 (#2.3)

Në përputhje me kërkesën 2.3.b, Shqipëria duhet të sigurojë që për të gjitha licencat e naftës, gazit dhe minierave të mbajtura nga kompanitë shfrytëzuese të bëhen publike datat e aplikimit, dhënies dhe skadimit, mallrat e mbuluar dhe koordinatat [e licencave]. Qeveria është e inkurajuar që ta vendosë këtë informacion në dispozicion publik për licencat e mbajtura nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga pesha e tyre.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë progres domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Raporti i EITI për vitin 2015 jepte një link të regjistratit të licencave të minierave, naftës dhe gazit, pavarësisht se kishte mungesa në bërjen publike të datave të aplikimit dhe koordinatave për disa licenca të minierave, naftës dhe gazit.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri aprovoi dhe publikoi Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Për liçencat e naftës dhe gazit, raporti EITI i vitit 2016 vëren se MIE nuk publikon një regjistër të përditësuar të liçencave (fq.44). Megjithatë, ai siguron lidhje (links) me faqet e internetit të AKBN⁶¹ dhe Albpetrol⁶² dhe shpjegon se të dy ofrojnë listat e KNP-ve nën administrimin e tyre dhe liçencat që ata mbajnë (fq.44). Megjithatë, raporti thekson që këto lista nuk japin të dhëna për datën e aplikimit ose datën e dhënies së kontratës, dhe thekson që këto lista të KNP-ve të naftës dhe gazit mund të përmbajnë informacion të vjetër (fq.44). Raporti gjithashtu, vë në dukje se regjistrat e publikuar në dhjetor 2017 ofronin vetëm emrat fillestarë të operatorëve të cilëve u është dhënë KNP-ja dhe nuk jepet informacion për ndonjë ndryshim të mëvonshëm në pronësi apo për transferim të të drejtave. Kështu, raporti vë në dukje si shembull se regjistrat nuk kanë dhënë informacion se operacionet në fushat e naftës të Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe Gorisht-Kocul u transferuan tek GBC Oil Ltd. në Shkurt 2016 (fq.44). Ndërsa faqja e internetit AlbEITI ka publikuar një regjistër⁶³ të liçencave të naftës dhe gazit, ai përmban të gjitha informacionet e gjendura në faqet e AKBN dhe Albpetrol si dhe datat e munguara të akordimeve, koordinatat e liçencave dhe mallrat e mbuluar, por nuk jep datat e aplikimit. Po ashtu, shfaqen të njëjtat mungesa sikurse ato në faqet e internetit të AKBN dhe Albpetrol sa i përket plotësisë së regjistrimit të liçensave, pasi KNP-ja e re e dhënë për Albanides Energy Sh.a. mungon. Megjithatë, disa nga përfaqësuesit e qeverisë dhe të sekretariatit që u konsultuan, sqaruan se lista aktuale e liçencave të naftës dhe gazit në faqen e internetit të AlbEITI ishte lista më e fundit pas përditësimeve dy herë në vit dhe vuri në dukje se regjistri i botuar në fillim të vitit 2017 do të kishte përfshirë KNP-në e Albanides Energy para se ajo të anulohet në fund të vitit 2017. Një shqyrtim i pavarur nga Sekretariati Ndërkombëtar i ish-regjistrimit⁶⁴ të liçensave të publikuara në faqen e internetit AlbEITI më 2017, konfirmoi këto pikëpamje, duke nënkuptuar që regjistri i publikuar në faqen e AlbEITI përditësohet rregullisht dhe tërësisht. Raporti i EITI 2016 shpjegon se regjistri i AlbEITI për liçencat e naftës dhe gazit përtërihet dy herë në vit, porse datat e aplikimit për të gjitha liçencat e naftës dhe gazit mungojnë *"për shkak të kohës që ka kaluar që nga praktika e dhënies së kontratës"* (fq.44). Një zyrtar qeveritar i konsultuar sqaroi se bazuar në një verifikim të dokumenteve fizike në arkivat e MIE ishte e mundur të gjenden datat e aplikimit për të gjitha liçencat aktive të naftës dhe gazit dhe tregoi për planet e Ministrisë për të digjitalizuar datat e aplikimit për akordimet e ardhshme të liçencave për naftë dhe gaz.

Për liçencat e minierave, raporti vë në dukje se MIE mban një regjistër publik të liçencave të minierave dhe ofron një link⁶⁵, duke theksuar se janë të disponueshme të gjitha informacionet e renditura në kërkesën 2.3.b përveç datave të aplikimit dhe koordinatave të liçencës, por nënvizon se frekuenca e përditësimeve të regjistrimit të liçencave të MIE është e paqartë (fq.66). Sidoqoftë, raporti gjithashtu vë në dukje se faqja e internetit AlbEITI ka publikuar një regjistër⁶⁶ të liçencave të minierave që përmban të gjitha informacionet e renditura në kërkesën 2.3.b, përveç datave të aplikimit për liçencat e dhëna para vitit 2012 (fq.66-67). Raporti shpjegon se këto data aplikimit mungojnë *"për shkak të kohës që ka kaluar që nga praktika e dhënies së kontratës"* (fq.67). Ai vë në dukje se regjistri AlbEITI përditësohet me informacione nga MIE, AKBN dhe SHGJSH dy herë në vit (fq.67). Verifikimet direkte nga Sekretariati Ndërkombëtar për liçenca specifike të mbajtura nga disa kompani lëndësh minerare sugjerojnë se regjistri është i plotë me të gjitha liçencat minerare aktive në vitin 2016. Një zyrtar qeveritar i konsultuar vuri në

⁶¹ Faqja e Internetit të AKBN, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶² Faqja e Internetit Albpetrol, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶³ Faqja e Internetit e AlbEITI, Regjistri i Liçensave të naftës dhe gazit, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶⁴ Arkiva Interneti, 'Faqja e internetit AlbEITI' fragment nga 2017, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶⁵ Faqja e Internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Regjistri i Liçensave Minerare, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶⁶ AlbEITI (2018), Regjistri i Liçensave Minerare, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

dukje se datat e aplikimit për të gjitha liçencat aktive të minierave ishin në dispozicion në kopje dokumentesh fizike nga arkivat e MIE dhe shprehën gatishmërinë për t'i publikuar ato në të ardhmen.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korigjues mbi regjistrat e liçencave është adresuar dhe gjykon se Shqipëria ka bërë progres të kënaqshëm me përmirësime në kërkesën 2.3. Raporti EITI 2016 dhe regjistrat e e liçencave të minierave, naftës dhe gazit publikuar në faqen e internetit AlbEITI ofrojnë të gjithë informacionin listuar nën kërkesën 2.3.b (përfshirë emrin e mbajtësit të liçencës, datat e dhënies dhe skadimit, mallrat e mbuluar dhe koordinatat), megjithëse jo datat e aplikimit për liçencat e mbajtura nga kompanitë me peshë [kompanitë që raportojnë, të cilësuar gjithashtu dhe kompanitë materiale – shenim i përkthyesit] Raporti është transparent për sfidat në gjetjen e datave të aplikimit. Konsultimet me palët e interesuara treguan se për shumicën e liçencave të mbajtura nga kompanitë materiale do të ishte e mundur të përcaktohej data e aplikimit, bazuar në arkivat e dokumenteve fizike të MIE. Qëndrimi i Sekretariatit Ndërkombëtar është se mungesa e bërjes publike të datave të aplikimit është një çështje periferike që nuk ndikon në progresin e Shqipërisë në përmbushjen e objektivit të përgjithshëm të transparencës në informacionin për liçencat.

Në përputhje me kërkesën 2.3, Shqipërisë i kërkohet të mbajë regjistra apo sistem/e kadastralë publikisht të aksesueshëm, duke përfshirë informacion të plotë mbi liçencat e mbajtura nga të gjitha kompanitë e naftës, gazit dhe minierave. Deri atëherë, Shqipëria duhet të sigurojë që informacionet e ardhshme të listuara në kërkesën 2.3.b, duke përfshirë datat e aplikimit, janë të aksesueshme publikisht për të gjitha liçencat që mbahen nga kompanitë minerare, të naftës dhe gazit.

3.5 Veprimi korigjues 5 (#2.4)

Në përputhje me kërkesën 2.4.b, Shqipëria duhet të dokumentojë në të ardhmen në Raportet e EITI politikën e qeverisë për publikimin e kontratave dhe liçencave që qeverisin eksplorimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Kjo duhet të përfshijë dispozitat përkatëse ligjore, çdo reformë që është planifikuar ose që po zhvillohet, si dhe një përmbledhje të kontratave të publikuara tashmë.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Raporti i EITI 2015 sqaroi politikën e qeverisë për publikimin e kontratave në sektorin e naftës dhe gazit, por jo në miniera. Raporti nuk ka komentuar praktikën aktuale të publikimit të kontratave, pavarësisht se palët kryesore të interesuara janë të vetëdijshme se disa kontrata janë në dispozicion të publik.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Politika e Qeverisë: Në lidhje me naftën dhe gazin, Raporti EITI 2016 vëren se Qeveria e Shqipërisë është "pozitive ndaj publikimit të kontratave" pavarësisht nga mungesa e dispozitave [ligjore përkatëse] në lidhje me publikimin e kontratave në Ligjin për Naftën (fq.43). Megjithatë, ai shpjegon se publikimi i kontratave "nuk është përcaktuar si një kusht i panegociueshëm" (fq.43), duke nënkuptuar se publikimi aktual i kontratave të naftës dhe gazit në praktikë është subjekt i negociatave ndërmjet dy palëve në kontratë (qeveria dhe kompania) (fq.43). Pas konsultimeve, disa zyrtarë qeveritarë konfirmuan se politika e qeverisë ishte në favor të publikimit të kontratave në sektorin e naftës dhe gazit. Një përfaqësues i industrisë vuri në dukje një paqartësi në praktikën e publikimit të kontratave: ndërsa KNP-të nga njëra anë

përmbanin dispozita konfidencialiteti, nga ana tjetër ato kërkonin botimin e plotë në fletoren zyrtare të qeverisë për të marrë fuqi ligjore. Përfaqësuesi konfirmoi se të gjitha KNP-të e lidhura deri më tani ishin publikuar në fletoren zyrtare.

Në lidhje me *minierat*, Raporti EITI 2016 shpjegon se nuk ka dispozita në Ligjin për Minierat në lidhje me publikimin e kontratave të koncesionit të minierave dhe citon pikëpamjen e MIE se kushtet e kontratave minerare nuk mund të publikohen për shkak të "*marrëveshjeve të konfidencialitetit*" (fq.68) që nënkupton dispozitat e konfidencialitetit të kontratave të koncesionit të minierave. Raporti i vitit 2016 nuk sqaron nëse qeveria ka një politikë përgjithësisht pro apo kundër publikimit të kontratave minerare, *mbi* dhe *përtej* ekzistencës së dispozitave të konfidencialitetit. Raporti thekson deklaratën e MIE se nuk ka ndryshime të planifikuara rregullatore në nivel afatshkurtër lidhur me publikimin e kontratave qoftë në naftë, gaz apo në miniera (fq.43,68). Megjithatë, disa përfaqësues të qeverisë dhe të industrisë, të konsultuar, thanë se politika e qeverisë ishte në mënyrë të qartë në favor të publikimit të kontratave minerare dhe vuri në dukje se të tre kontratat e koncesionit të minierave ishin publikuar në gazetën zyrtare.

Praktika aktuale: Në lidhje me *naftën dhe gazin*, Raporti EITI 2016 rendit KNP-të specifike të naftës dhe gazit që janë publikuar, qoftë në portalin⁶⁷ e Resource Contracts (Kontratave të Burimeve), në bashkëlidhjen e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) i aksesueshëm përmes fletores zyrtare⁶⁸, apo në portalin⁶⁹ e Të Dhënave të Hapura të Shqipërisë i mbajtur nga Instituti Shqiptar i Shkencave (fq.43.172-178). Konsultimet me palët e interesuara theksuan se të gjitha kontratat e naftës dhe gazit ishin në dispozicion të publikut, duke filluar me KNP-në⁷⁰ e vitit 2004 me OMV, përveç KNP-së origjinale me Bankers Petroleum për fushën e naftës Patos Marinëz.

Në lidhje me *minierat*, raporti vë në dukje se asnjë kontratë koncesioni minerar nuk është publikuar deri më sot dhe ofron një rekomandim që praktika e publikimit të kontratës me dakordësi të të dy palëve kontraktuese në sektorin e naftës dhe gazit të replikohet edhe në sektorin minerar (fq.68). Ndërsa raporti vëren se teksti i plotë i "shumë" liçencave minerare është i hapur për publikun përmes Qendrës Kombëtare të Biznesit përmes një linku⁷¹ (fq.68), ai nuk specifikon listën e saktë të liçencave që janë publikuar deri më tani. Megjithatë, disa përfaqësues të grupeve të qeverisë dhe të industrisë, të konsultuar, thanë se të gjitha kontratat e minerare deri më tani ishin publikuar në fletoren zyrtare. Një zyrtar i lartë qeveritar konfirmoi se në sektorin e minierave janë finalizuar vetëm tre kontrata, që mbulonin koncesionet e minierave të bitumit, bakrit dhe kromit të nënshkruara në vitin 2001 dhe se të tre kontratat^{72 73 74} ishin të disponueshme në fletoren zyrtare. Kjo u konfirmua në mënyrë të pavarur.

Aksesueshmëria: Raporti jep udhëzime për aksesimin e KNP-ve të naftës dhe gazit dhe në tekstin e plotë të liçencave minerare, siç u përmend më lart.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korigjues mbi publikimin e kontratave është adresuar dhe gjykon se Shqipëria ka bërë progres të kënaqshëm në kërkesën 2.4. Raporti EITI 2016 sqaron politikën e qeverisë për publikimin e kontratave në sektorin e naftës dhe gazit, por jo në sektorin e

⁶⁷ Resource Contracts portal, Albania contracts, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶⁸ Fletorja Zyrtare e Qeverisë së Shqipërisë, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁶⁹ Open Data Albania portal, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁷⁰ OMV PSA from 2004 - <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Vendim%20i%20KM:562:27.08.2004>

⁷¹ Faqja e QKB, Seksioni për liçensat minerare, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁷² Shiko Fletoren Zyrtare (2001), 'Ligj Nr.8791, datë 10.5.2001, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, viti 2001 (Qershor) Ndryshuar me Ligjin Nr. 79, datë 29.07.2016, Botuar në Fletoren Zyrtare nr.146, viti 05.08.2016', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁷³ Shiko Fletore Zyrtare (2000), 'Ligj, Nr.8590, Dt.Aktit:23.03.2000, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 7, viti 2000 (Prill) Ndryshuar me Ligjin Nr. 80, date 29.07.2016, Botuar në Fletoren Zyrtare nr.146, viti 05.08.2016, aksesuar këtu në Mars 2019.

⁷⁴ Shiko Fletoren Zyrtare (2001), 'Ligj nr. 8761, datë 02.04.2001, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, viti 2001 (Prill) Ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2017, Botuar në Fletoren Zyrtare nr.127, 1 qershor viti 2017', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

minierave. Konsultimet me grupet e interesit konfirmuan se qeveria praktikisht kishte një politikë pro-publikuese në sektorin e minierave. Ndërkohë që ka pak evidenca se MSG ka ndërmarrë hapa për të kodifikuar këtë politikë qeveritare për sektorin e minierave, pikëpamja e Sekretariatit është se politika e pro-publikuese e qeverisë për kontratat e minierave në praktikë, e kombinuar me numrin e vogël të kontratave në sektorin e minierave (tre), do të thotë se objektivi më i gjerë i transparencës së kontratave është arritur. Raporti jep udhëzime të përgjithshme për aksesimin e kontratave të publikuara në sektorin e minierave, naftës dhe gazit, por nuk konfirmon se tre kontratat konçesionare minerare të lidhura deri më tani janë publikuar në fletoren zyrtare, edhe pse kjo është verifikuar në mënyrë të pavarur gjatë konsultimeve.

Për të forcuar zbatimin, Shqipëria inkurajohet të sqarojë politikën e qeverisë për publikimin e kontratave në sektorin e minierave dhe të dokumentojë publikisht listën e kontratave që janë të hapura për publikun. Shqipëria mund të dëshirojë të ndërmarrë hapa për të lehtësuar aksesimin e kontratave të publikuara, të cilat janë të aksesueshme nëpërmjet fletores zyrtare, për shembull nëpërmjet publikimit të tyre në faqen e AlbEITI ose në portalin e Kontratave të Burimeve.

3.6 Veprimi korrigjues 6 (#2.6)

Në përputhje me kërkesën 2.6.a, MSG duhet të japë një shpjegim të rregullave dhe praktikave mbizotëruese në lidhje me fitimet e pashpërndara të NSH-ve, riinvestimet dhe financimet e palëve të treta. Qeveria gjithashtu duhet të sigurojë publikimin vjetor të çdo ndryshimi në pronësinë qeveritare në NSH-të ose filialet e tyre dhe të sigurojë një pasqyrim të plotë të çfarëdo kredie apo garancie huaje të dhënë nga shteti ose NSH-të për kompanitë e minierave, naftës dhe gazit në përputhje me kërkesën 2.6. b.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë progres domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë. Raporti i EITI 2015 nuk ka ofruar një listë gjithëpërfshirëse të kompanive që veprojnë në sektorët e minierave, naftës dhe gazit, në të cilat qeveria disponon kapital, megjithëse ka ofruar referenca për rregullat (por jo praktikën) që lidhen me marrëdhëniet financiare ndërmjet NSH-ve dhe qeverisë, megjithëse vetëm në lidhje me fitimet e pashpërndara dhe riinvestimet, jo financimin e palëve të treta. Ekzistenca e garancive të kredive ose kredive nga shteti apo nga çdo NSH që operon në sektorin e minierave, naftës dhe gazit ishte e paqartë në Raportin EITI të vitit 2015, megjithëse kishte informacione të gjera për kreditë dhe garancitë e shtetit për kompanitë hidro-energjitike.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Pesha (materialiteti): Lidhur me *minierat*, Raporti EITI 2016 thekson se NSH-të në sektorin e minierave janë aktualisht në likuidim dhe se Ministria e Ekonomisë dhe Financave është në procesin e shitjes së kapitalit të saj përmes privatizimit (fq. 53). Raporti konfirmon se asnjë nga ndërmarrjet shtetërore minerare nuk ka paguar dividendë për qeverinë gjatë gjashtë viteve të fundit, duke vendosur si evidencë një link⁷⁵ me raportet e dividendëve të Ministrisë së Financave të publikuara në faqen e saj të internetit (fq.53).

Në lidhje me *naftën* dhe *gazin*, Raporti EITI 2016 konfirmon se Albpetrol Sh.a. konsiderohet i vetmi NSH në sektorin e naftës dhe gazit (fq. 36). Ai konfirmon se pjesëmarrja e shtetit në Albpetrol krijon të ardhura materiale nëpërmjet pagesave prej kësaj NSH-je të dividendit për shtetin si aksionar i vetëm, me të njëjtat

⁷⁵ Faqja e Internetit të Ministrisë së Financave, 'Raportet e Dividentëve', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

kushte si kompanitë private (fq.37) dhe nëpërmjet shitjes prej saj të të ardhurave të shtetit në natyrë (fq.40-41). Raporti konfirmon se Albpetrol nuk i pagoi asnjë dividend shtetit në 2016, pavarësisht se e kishte bërë këtë në vitet e mëparshme dhe pasqyron shifrat e pagesave të saj kundrejt buxhetit të shtetit në vitin 2016 (fq.38).

Raporti liston tre NSH të tjera, prej të cilave njëra⁷⁶ ka qenë në likuidim që nga viti 2011 dhe dy⁷⁷ ishin aktive, por nuk nuk ishin të përfshira në prodhim nafte dhe gazi dhe nuk paguan asnjë dividend në periudhën 2011-2016 (fq.37). Raporti konfirmon se AKBN nuk është një NSH, por një agjenci publike që i raporton Ministrit përgjegjës për energjinë (fq.15), një institucion publik jo-buxhetor që mbledh të ardhura nga nxjerrjet (fq.132). Zyrtarë të lartë qeveritarë të konsultuar theksuan reformat e planifikuara për statusin ligjor të AKBN, që priten në 2019, dhe që njëri nga opsionet e konsideruara ka të bëjë me reformimin e statusit të AKBN në një agjenci qeveritare llogaritë e të cilës do të regjistrohen në buxhetin e shtetit.

Marrëdhëniet financiare: Raporti EITI 2016 shpjegon se Albpetrol është i detyruar t'i paguajë qeverisë⁷⁸ të njëjtat taksa dhe tatime si të gjitha kompanitë private, si dhe dividendët si aksionari i vetëm (fq.37). Raporti citon garancitë e Albpetrol dhe MIE se nuk ka marrëveshje të posaçme që qeverisin transfertat midis Albpetrol dhe Qeverisë (fq.37). Kjo nënkupton që Albpetrol i nënshtrohet të njëjtave rregulla si shoqëritë tregtare private, dmth. se Bordi i Drejtorëve të saj mund të vendosë për nivelin e dividendëve, të fitimit të pashpërndarë e të riinvestimit në operacionet e tij dhe se Albpetrol nuk merr subvencione qeveritare, edhe pse kjo nuk është shprehur qartë në Raportin EITI 2016.

As Raporti EITI 2016, as faqja e Albpetrol⁷⁹ nuk konfirmon nëse Albpetrol ka të drejtë statutores për të marrë fonde nga palët e treta, qoftë borxh apo kapital. Raporti jep vetëm një përshkrim sipërfaqësor të planeve të kaluara për privatizimin e Albpetrol, duke vënë në dukje se planet aktuale të privatizimit janë të paqarta (fq.39). Përfaqësuesit e NSH-së deklaruan se Albpetrol kishte të drejtë të merrte financim prej palëve të treta, si borxhe ashtu edhe kapitale, por që kompania nuk i është drejtuar financimit prej palësh së treta në praktikë, për arsye të të ardhurave nga nafta dhe gazi që kishte mbajtur për të financuar operacionet e saj. Përfaqësuesit shpjeguan se aftësia e Albpetrol për të marrë financime nga palë të treta sanksionohet në statutet e kompanisë, por nuk ishin të sigurt për mundësinë e aksesimit publik të këtyre dokumenteve. Përsa i përket praktikës aktuale, raporti jep shifrat kryesore të pasqyrave financiare të audituara të Albpetrol të vitit 2016 (si dhe ato për periudhën 2011-2015), duke përfshirë të ardhurat operative neto, fitimin përpara tatimit dhe dividendët e paguar shtetit (fq. 38), duke vënë në dukje se dividendët e paguar nga Albpetrol kanë qenë të paqëndrueshme dhe nuk janë të lidhura ngushtë me fitimet apo me nivelin e fitimeve të pashpërndara (fq.131). Raporti gjithashtu përshkruan burimin e prodhimit të naftës bruto të mbledhur nga Albpetrol dhe mënyrën me të cilën tregtohet dhe shitet, duke përfshirë edhe vitin 2016 (fq.40-43). Ndërsa Raporti i EITI vetëm vë në dukje se deklaratat financiare të audituara të Albpetrol 2016 janë të aksesueshme përmes Regjistrimit Kombëtar të Biznesit, verifikimi i pavarur nga Sekretariati Ndërkombëtar konfirmoi që pasqyrat financiare të audituara të Albpetrol-it 2016 dhe raporti përkatës i auditimit janë të aksesueshme përmes regjistrimit⁸⁰, megjithëse për këtë nevojitet një kërkim i thelluar.

Pronësia e Qeverisë: Raporti konfirmon se Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron 100% të kapitalit në Albpetrol dhe 15% në rafinerinë e naftës ARMO (fq.17). Duket se Albpetrol nuk disponon kapitale në asnjë kompani tjetër nxjerrëse, gjë e cila u konfirmua në konsultime me zyrtarë qeveritarë. Raporti vëren

⁷⁶ PetrolAlba Sh.a., përfshirë në shitjen dhe magazinimin e naftës.

⁷⁷ TransNafta Sh.a. përfshirë në transportin e produkteve të rafinuar të naftës dhe Uzina Mekanike e Naftës Sh.a. përfshirë në serviset mekanike të pjesëve të industrisë së naftës.

⁷⁸ Tatimi mbi Fitimin, TVSH, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, Renta dhe Gjobat mbi Taksat.

⁷⁹ Faqja e Internetit Albpetrol, Të dhënat e bilancit, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁸⁰ Faqja e QKB (Dhjetor 2017), Deklarata financiare Albpetrol 2016 aksesuar [këtu](#) dhe raporti i auditit 2016 aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

se Albpetrol zotëron të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit dhe eksplorimit në të gjitha fushat ekzistuese të naftës dhe disa blloqe eksplorimi në Shqipëri në zonat nën juridiksionin e saj (fq.37). Në raport jepet lista e blloqeve specifike të eksplorimit nën administrimin e Albpetrol (fq. 23). Raporti përshkruan "nën-kontraktimin" nga ana e Albpetrol-it që prej vitit 2003 të kompanive private për dhënien e të drejtave të eksplorimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit në zonat nën administrimin e tij (fq.11). Ndërsa raporti vëren se Albpetrol është palë kontraktuese në të gjitha KNP-të që përfshijnë dhënie të drejtash shfrytëzimi në fusha nën administrimin e saj (fq.37) dhe se Albpetrol është i liçencuar nga MIE nën të njëjtat kushte që përfshihen në KNP-të nën administrimin e saj (p.41), raporti nuk siguron jep kuotat [aksionet] pjesëmarrëse të Albpetrol në [këto] KNP. Megjithatë, sipas disa zyrtarëve qeveritarë të konsultuar, Albpetrol nuk mban asnjë përqindje aksionesh në KNP-të që ka lidhur me kompanitë private. Raporti rekomandon që MIE të mbajë një regjistër të përditësuar që rendit të gjitha NSH-të dhe pjesëmarrjet e tjera [të shtetit] në kompanitë që veprojnë në sektorin nxjerrës të naftës, duke përfshirë edhe ndryshimet në pronësinë e qeverisë (f.132).

Ndryshimet e pronësisë: Raporti EITI 2016 nuk i referohet ndonjë ndryshimi në pronësinë qeveritare gjatë vitit 2016, dhe palët e interesuara të konsultuara konfirmuan se nuk kishte pasur ndonjë ndryshim në kapitalin shtetëror në kompanitë nxjerrëse, përfshirë Albpetrolin, në vitin 2016. Kjo u konfirmua edhe nga shqyrtimi i pavarur nga ana e Sekretariatit Ndërkombëtar⁸¹ të pasqyrave financiare të audituara të Albpetrol të vitit 2016.

Kreditë dhe garancitë: Raporti EITI 2016 konfirmon që Albpetrol nuk ka marrë dhe as nuk ka dhënë hua për qeverinë deri më sot (fq.38). Ai vë në dukje se Albpetrol mbajti gjithsej 12 miliardë lekë të ardhurat tregtare nga ARMO deri në fund të vitit 2016 si rezultat i naftës të shitur më herët rafinerisë së naftës (fq.38). Megjithatë, raporti nuk i referohet vlerësimit nga ana e MSG-së të çdo kredie apo garancie kredie të ofruara nga qeveria ndaj çdo sipërmarrjeje nxjerrëse e që ishin të pashlyera në vitin 2016. Sipas zyrtarëve qeveritarë të konsultuar, Albpetrol ka dhënë hua për entitetet qeveritare si AKBN në të kaluarën por këto nuk rezultojnë të pashlyera në vitin 2016. Zyrtarët qeveritarë të konsultuar konfirmuan se qeveria nuk kishte ofruar kredi apo garanci huaje për kompanitë e minierave, naftës dhe gazit në vitin 2016, ndryshe nga ofrimi i garancive të huave në sektorin e energjisë hidrike.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korigjues për pjesëmarrjen e shtetit është adresuar pjesërisht dhe gjykon se Shqipëria ka bërë progres domethënës në kërkesën 2.6. Raporti EITI 2016 sqaron se Albpetrol ishte e vetmja NSH me peshë për qëllimet e raportimit të EITI në 2016 dhe përshkruan marrëdhëniet financiare midis Albpetrol dhe shtetit, si në statut dhe në praktikë, përveç rregullave që lidhen me aftësinë e saj për të marrë financime nga palët të treta. Konsultimet me grupet e interesit konfirmuan se statutet e kompanisë Albpetrol cilëson në mënyrë të qartë rregullat në lidhje me financime palësh të treta, edhe pse aksesimi publike e këtyre statuteve ishte i paqartë gjatë Validimit. Raporti jep një pasqyrë të kapitalit shtetëror në kompanitë nxjerrëse, duke përfshirë kushtet lidhur me kapitalin shtetëror dhe, megjithëse nuk konfirmon në mënyrë eksplicite mungesën e ndryshimeve në pjesëmarrjen e shtetit në vitin 2016, konsultimet me palët e interesuara konfirmuan se nuk kishte ndryshime në pjesëmarrjen e shtetit në vitin 2016. Ndërsa raporti vetëm sa konfirmon mungesën e kredive dhe garancive të papaguara nga Albpetrol në kompanitë nxjerrëse në vitin 2016, pa iu referuar ndonjë kredie qeveritare apo garancie për kompanitë nxjerrëse, konsultimet me palët e interesuara konfirmuan se qeveria nuk kishte ndonjë kredi apo garanci të papaguar kundrejt kompanive nxjerrëse në vitin 2016.

⁸¹ Faqja e Internetit e QKB (Dhjetor 2017), Deklarata financiare Albpetrol 2016 aksesuar [këtu](#) dhe raporti i auditit 2016 aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

Në përputhje me kërkesën 2.6, Shqipëria duhet të sqarojë publikisht rregullat dhe praktikën që lidhen me aftësinë e Albpetrol për të marrë financim nga palë të treta, çdo ndryshim në pjesëmarrjen e shtetit në vitin në shqyrtim dhe çdo kredi dhe garanci të papaguar të dhënë nga Albpetrol ose nga shteti tek kompanitë në sektorin e minierave, naftës dhe gazit. Shqipëria mund të dëshirojë të marrë në konsideratë mundësinë e përmirësimit në aksesimin publik të pasqyrave financiare të audituara të Albpetrol-it si një mjet për të sqaruar praktikën e marrëdhënieve financiare midis Albpetrol dhe shtetit.

3.7 Veprimi korrigjues 8 (#4.6)

Në përputhje me kërkesën 4.6, MSG duhet të bëjë përcaktimin e duhur të pagesave të drejtpërdrejta subnacionale nga kompanitë nxjerrëse tek NJQV, duke krijuar një bazë të plotë për diskutimet e MSG për peshën (materialitetin) e pagesave direkte për NJQV-të. MSG mund të dëshirojë të marrë në konsideratë një qasje shqyrtimi kampionues, e cila do të lejonte që këto pagesa të hetohen pa krijuar një barrë të paarsyeshme raportimi.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë progres domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Është gjykuar e mundshme që puna e mëtejshme në këtë çështje do të demonstronte se kjo kërkesë nuk ishte e zbatueshme në Shqipëri, pasi mendohej se kishte gjasa që pagesat subnacionale për NJQV-të të mos ishin me peshë domethënëse. Megjithatë, MSG-ja ra plotësisht dakord që pagesat subnacionale për NJQV të përfshihen në fokus të procesit të raportimit, duke theksuar rëndësinë e këtyre pagesave për komunitetet lokale. Në mungesë të të dhënave të plota qeveritare, qasja e miratuar bazuar në përzgjedhjen e NJQV-ve për rakordim të bazuar në të dhënat e kompanive u duk e arsyeshme. Megjithatë, duket se ka mangësi të mëdha në raportimin nga kompanitë dhe në pjesëmarrjen e NJQV-ve

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Pesha (materialiteti): Raporti EITI 2016 shpjegon se Termat e Referencës për Administratorin e Pavarur (AP), të miratuara nga MSG, përjashtojnë nga fushëveprimi i raportimit taksat vendore sepse ato konsideroheshin të natyrës së përgjithshme, dmth. jo specifike për nxjerrjet (f.107). Megjithatë, thuhet se kompanive të minierave, naftës dhe gazit u është kërkuar të raportojnë "çdo pagesë tjetër" tek njësitë e qeveritë vendore më shumë se 5 mijë USD (fq. 107). Ndërsa raporti nuk jep një vlerësim të peshës të taksave vendore të arkëtuara nga kompanitë nxjerrëse nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në të cilat veprojnë kompanitë nxjerrëse, ai bën një përlllogaritje të vlerës së pagesave të taksave vendore nga kompanitë kryesore për shtatë njësi të qeverive vendore të përzgjedhura për raportim (Bashkitë Fier, Patos, Bulqizë, Roskovec, Prrenjas, Kukës dhe Krujë) si 2% të totalit të të ardhurave totale të rakorduara në vitin 2016 (f.102). Megjithatë, përzgjedhja e shtatë qeverive vendore me peshë bazohet në "NJQV-të me shumicën [e kapaciteteve] nxjerrëse" (fq.102) në vend që të bazohet në pragun e peshës sasiore, pra një vlerësim të të ardhurave tatimore vendore të të gjitha NJQV-ve nga të gjitha kompanitë nxjerrëse. Raporti sqaron më tej në rekomandimet e tij se shtatë qeveritë lokale u përzgjedhën në bazë të niveleve të prodhimit rajonal të raportuara nga AKBN për vitin 2016 dhe kështu nuk përfshinin të gjitha NJQV-të që grumbullonin taksa lokale nga kompanitë nxjerrëse (fq.125).

Konsultimet me palët e qeverisë dhe industrisë treguan se bashkitë kanë kompetenca të mbledhjes së taksave dhe aftësinë për të caktuar ose përcaktuar llojet dhe normat e taksave vendore. Pas konsultimeve, AP gjykoi se të dhënat rajonale të prodhimit ofronin një përfaqësim të kënaqshëm për përcaktimin e peshës së pagesave për qeveritë vendore, pasi pagesat e kompanive të minierave, naftës

dhe gazit në qeveritë lokale u analizuan në raport me aktivitetin dhe prodhimin e tyre në çdo zonë të qeverisjes vendore. Asnjë nga aktorët e konsultuar nuk ka kundërshtuar këtë qasje për zgjedhjen e qeverive vendore për raportimin e EITI, duke pasur parasysh mungesën e informacionit të centralizuar mbi pagesat direkte për qeveritë vendore në nivel kombëtar. Palët e interesuara kanë konfirmuar se kompanitë me peshë nuk i kanë veçuar taksat vendore nga zëri i të ardhurave në raportimin e tyre EITI. Ndërsa disa zyrtarë qeveritarë të konsultuar konsideronin se Drejtoria e Pushtetit Lokal e Ministrisë së Financave kishte ndoshta të dhëna për pagesat direkte për qeveritë vendore, konsultimet e mëtejshme me Ministrinë e Financave konfirmuan se ministria kishte të dhëna vetëm për të ardhurat e mbledhura nga qeveritë vendore, por jo të ardhurat e ndara sipas zërave të të ardhurave apo llojit të kompanisë.

Raportimi: Rezultatet e rakordimit të pagesave të drejtpërdrejta subnacionale të kompanive ndaj shtatë njësive të qeverisjes vendore janë ofruar (fq.162), megjithëse nuk janë të ndara sipas zërave të të ardhurave, por vetëm me cilësimet për NJQV-në dhe kompaninë. Në rekomandimet e tij, raporti thekson nevojën për raportimin e pagesave të drejtpërdrejta subnacionale për t'u ndarë sipas zërave të të ardhurave (fq.125).

Sa i përket raportimit të qeverive vendore, raporti thekson se tre nga shtatë qeveritë prej tyre nuk i dorëzuan formularët e raportimit (fq.125). Raporti gjithashtu nxjerr në pah sfidat për sigurimin e raportimit në kohë nga qeveritë e tjera vendore të përzgjedhura për raportim (fq.125-126). Bazuar në rezultatet e rakordimeve të dorëzuara (fq.162), duket se të gjitha kompanitë me peshë i kanë raportuar pagesat direkte subnacionale të bëra tek shtatë qeveritë lokale. Megjithatë, në raport thuhet se kompanitë raportuese kanë sjellë çertifikimet e kërkuara për raportimet për vetëm një total prej 61% të pagesave të drejtpërdrejta subnacionale raportuara (fq.102) (Shiko kërkesa 4.9). Megjithatë, raporti jep vlerësimin e AP për plotësinë e rakordimit të këtyre pagesave direkte subnacionale duke deklaruar se *"duke pasur parasysh peshën relativisht të ulët të këtij zëri pagesash dhe nivelin e sigurimit të dhënë, çdo mungesë ose pasaktësi e zbuluar nuk do të ndikojnë dukshëm në tërësinë e Raportit të EITI"* (fq.102).

Mospërputhjet: Në raport jepen mospërputhjet përfundimtare të pazgjidhura në rakordimet e pagesave të drejtpërdrejta për shtatë qeveritë vendore (f.162), megjithëse nuk jepen shpjegime për natyrën e mospërputhjeve. Totali i mospërputhjeve përfundimtare të pa rakorduara përbënin 22.1% të pagesave të drejtpërdrejta subnacionale të raportuara nga kompanitë.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korrigjues mbi pagesat e drejtpërdrejta subnacionale është adresuar pjesërisht dhe gjykon se Shqipëria ka bërë progres domethënës me përmirësime në kërkesën 4.6. Raporti EITI 2016 ofron një përmbledhje të vlerësimit të MSG për peshën e pagesave të drejtpërdrejta subnacionale dhe zgjedhjen prej MSG-së të shtatë njësive të qeverisë vendore me më shumë peshë në bazë të të dhënave rajonale të prodhimit. Ndërsa mungesa e një përkufizimi të peshës (materialitetit) bazuar në vlerësimin e pagesave direkte subnacionale në 2016 është një shqetësim. Qasja duket e zbatueshme duke pasur parasysh mungesën e informacionit të centralizuar mbi pagesat e drejtpërdrejta subnacionale, korrelacionin midis niveleve të prodhimit të kompanive dhe pagesave të tyre ndaj qeverive vendore, dhe mungesën e vërejtjeve prej grupeve të interesit mbi plotësinë e rakordimeve që mundësohen nga kjo qasje. Ndërsa kompanitë me peshë duket se kanë raportuar pagesat e tyre të drejtpërdrejta për qeveritë vendore, mungesa e ndarjes (disagregimit) së këtij raportimi brenda zërit të të ardhurave është një shqetësim. Ka gjithashtu boshllëqe të konsiderueshme në raportimin e qeverive vendore për të ardhurat e drejtpërdrejta subnacionale, me vetëm katër prej shtatë qeverive vendore të përzgjedhura që kanë dorëzuar formularët e raportimit të EITI. Pikëpamja e Sekretariatit është se, ndërsa aspektet e rëndësishme të kërkesës janë adresuar, objektivi më i gjerë i transparencës në pagesat e drejtpërdrejta subnacionale ende nuk është arritur.

Në përputhje me kërkesën 4.6, Shqipëria duhet të sigurojë që të gjitha pagesat me peshë (materialitet) të ndërmarrjeve ndaj subjekteve qeveritare vendore, të janë të bëra publike dhe të rakorduara. Shqipëria inkurajohet që të publikojë një shpjegim më të detajuar të llojeve të taksave vendore të mbledhura nga qeveritë vendore si dhe të rrisë veprimtaritë komunikuese me qeveritë vendore përpara raportimit të ardhshëm të EITI dhe rakordimit të pagesave direkte subnacionale me peshë.

3.8 Veprimi korrigjues 10 (#4.9)

Në përputhje me kërkesën 4.9.a, EITI kërkon një vlerësim nëse pagesat dhe të ardhurat i nënshtrohen një auditimi të besueshëm dhe të pavarur, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit. Në përputhje me kërkesën 4.9.b.iii dhe Termat standarde të Referencës për Administratorin e Pavarur të miratuar nga Bordi i EITI, MSG dhe Administratori i Pavarur duhet të

- Ekzaminon procedurat e auditimit dhe çertifikimit [të auditimit] në kompanitë dhe entitetet qeveritare që marrin pjesë në procesin e raportimit të EITI dhe në bazë të këtij ekzaminimi të bien dakord se çfarë informacioni kompanitë pjesëmarrëse dhe subjektet qeveritare duhet t'i japin Administratorit të Pavarur për të siguruar kredibilitetin e të dhënave në përputhje me kërkesën 4.9. Administratori i Pavarur duhet të ushtrojë gjykimin e tij dhe të zbatojë standardet e duhura profesionale ndërkombëtare në zhvillimin e një procedure që ofron një bazë të mjaftueshme për një raport të plotë dhe të besueshëm të EITI. Administratori i Pavarur duhet të përdorë gjykimin e tij/saj profesional për të përcaktuar masën në të cilën mund të mbështetet në kontrollet dhe kuadret ekzistuese të auditimit të kompanive dhe [institucioneve/njësive të] qeverisë. Raporti fillestar i Administratorit të Pavarur duhet të dokumentojë opsionet e shqyrtuara dhe arsyetimin për garancitë [çertifikimet audituese] që duhet të ofrohen.
- Të sigurojnë që Administratori i Pavarur të sigurojë një vlerësim të tërësisë dhe besueshmërisë së të dhënave (financiare) të paraqitura, duke përfshirë edhe një përmbledhje informative të punës së kryer nga Administratori i Pavarur dhe kufizimet e vlerësimit të dhënë.
- Të sigurojnë që Administratori i Pavarur të vlerësojë nëse të gjitha kompanitë dhe entitetet qeveritare që janë pjesë e procesit të raportimit EITI e kanë ofruar informacionin e kërkuar. Çdo boshllëk ose dobësi në raportimin tek Administratorit të Pavarur duhet të pasqyrohet në Raportin EITI, duke përfshirë cilësimin me emër të çdo njësie që nuk u përmbahet procedurave të miratuara dhe një vlerësim nëse kjo [mungesë] ka të ngjarë të ketë pasur ndikim të qenësishëm në plotësinë dhe besueshmërinë e Raportit.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë progres domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. MSG duket se ka miratuar përzgjedhjen e AP për Raportin EITI 2015, duke përfshirë Termat e Referencës (TeR) në përputhje me modelin e miratuar nga Bordi, si dhe formularët e raportimit. Ndërsa duket se AP kishte shqyrtuar procedurat e auditimit ligjor të subjekteve të përzgjedhura përpara se të binte dakord për procedurat e garantimit [çertifikimit] të cilësisë për të siguruar besueshmërinë e të dhënave të rakorduara në Raportin EITI të vitit 2015, nuk kishte evidencë që AP të ketë shqyrtuar praktikën faktike të auditimit të entiteteve raportuese. Nuk ishte e qartë pse anëtarët e MSG-së nga industria miratuan procedura të garantimit të cilësisë që asnjë kompani nuk i ndiqte në praktikë. Raporti i EITI 2015 nuk ka vlerësuar rëndësinë e raportimit nga subjektet që nuk aplikuan procedurat e dakorduara të garantimit të cilësisë. Mungesa e dhënies së ndonjë garancie nga AP për plotshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave të rakorduara pati përbërë një shqetësim dhe përfaqësoi një shmangie nga Termat e Referencës të AP për Raportin EITI 2015. AP kishte përgatitur tabelat përmbledhëse të të dhënave në Raportin EITI të Shqipërisë.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Emërimi i Administratorit të Pavarur (AP): Financuar nga grantet e Bankës Botërore përmes Mbështetjes Programatike Globale të industrive Nxjerrëse (Extractives Global Programmatic Support - EGBS), vendosja e AP u krye në bazë të udhëzimeve të prokurimit të Bankës Botërore përmes ofertave konkurruese, ku Sekretariati AlbEITI vepron si entitet i prokurimit për të gjitha kontratat. TeR-të e AP, vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e ofertës fituese u dorëzuan të gjitha në Bankën Botërore për aprovim pa kundërshtim. Deloitte Audit Albania ishte ofruesi fitues për Raportet EITI të vitit 2015 dhe 2016, të cilat janë prokuruar si një kontratë e vetme e nënshkruar më 18 korrik 2016. Raundet e prokurimit për Raportet EITI 2015 dhe 2016 u bazuan në kualifikimin e konsulentit (QCBS). Nuk ka evidenca të përfshirjes së MSG në vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertuesve për Raportin EITI 2016 dhe duket se komisioni i vlerësimit të ofertave për Raportet EITI 2015 dhe 2016 përbëhej ekskluzivisht nga stafi i sekretariatit AlbEITI. Megjithatë, shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të MSG tregon se MSG miratoi përzgjedhjen e AP.

Termet e Referencës për AP: MSG miratoi TeR për AP të Raportit EITI 2015 përmes qarkores në 1 Mars 2016.⁸² TR i aprovuar duket se është në përputhje me standardin e aprovuar të Bordit për TeR-të e AP-ve.

Miratimi i formularëve të raportimit: Në Raportin EITI 2016, AP konfirmon se ka përgatitur draftet e formularëve të raportimit që janë miratuar nga MSG në Korrik 2017 (fq.111-112). Megjithatë, raporti përfundimtar vë në dukje se formulari aktual nuk arriti të adresojë disa kritere të Standardit EITI, përkatësisht lidhur me ndarjen (disagregimin) e të gjithë zërave të të ardhurave (fq.103). Duket se MSG kishte miratuar formularët e raportimit si pjesë e shqyrtimit të raportit të fillësës të AP për vitin 2016, në Mars 2017, përpara mbledhjes së të dhënave.

Rishikimi i praktikave të auditimit: Raporti jep një përmbledhje të shkurtër të procedurave ligjore të auditimit dhe garantimit të cilësisë për kompanitë nxjerrëse (fq. 94) dhe pasqyron një listë të qartë të kompanive nxjerrëse specifike, deklaratat financiare të audituara të të cilave janë të aksesueshme në portalin e QKB⁸³ (fq.96.180 -185). Në mënyrë të ngjashme, raporti jep një pasqyrë të procedurave ligjore të auditimit dhe garantimit të cilësisë për subjektet qeveritare dhe Albpetrol (fq.98) dhe konfirmon që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përfunduar auditimin e llogarive [të enteve] publike, të vitit 2016, duke dhënë një link në raport (fq.98). Gjithashtu raporti konfirmon se Albpetrol ishte i vetmi institucion publik që kishte përgatitur pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016 (fq.98), ndërsa AKBN dhe njësitë e qeverive vendore nuk e kishin bërë këtë. Përmbledhjet e procedurave ligjore të auditimit i referohen standardeve ndërkombëtare të auditimit (fq.94,98). Disa zyrtarë qeveritarë të konsultuar konfirmuan se AKBN ende nuk kishte pasqyrat financiare të audituara.

Metodologjia e garantimit (certifikimit) të cilësisë: Raporti përshkruan metodologjinë e garantimit të cilësisë të rënë dakord për raportimin e kompanive EITI, e cila përbëhej nga certifikimi nga audituesit e jashtëm dhe formularët e raportimit të nënshkruara nga titullari i kompanisë (fq.97,113). Duket se subjekteve qeveritare u është kërkuar gjithashtu të dorëzojnë një "raport të garancisë" nga "audituesit e tyre ligjorë ose audituesi i zgjedhur" për formularët e tyre të raportimit, edhe pse raporti i referohet vetëm "subjekteve raportuese" të përgjithshme dhe jo në mënyrë specifike subjekteve qeveritare me peshë (f.97). Pas konsultimeve, AP sqaroi se subjekteve qeveritare u kërkohej vetëm që të dorëzonin zyrtarisht raportimin e tyre EITI tek AP dhe se nuk ishte e nevojshme certifikimi i pavarur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Zyrtarët e lartë qeveritarë që u konsultuan shpjeguan se raportimet EITI të qeverisë për vitin 2016 ishin dorëzuar tek AP në mënyrë elektronike, pa u kërkuar asnjë nënshkrim shtesë. Të gjitha palët e konsultuara, përfshirë AP dhe industrinë, shpjeguan se MSG dhe AP kishin menduar se kërkesa për

⁸² <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2016/>

⁸³ Portali QKB, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

çertifikim nga audituesit e jashtëm supozohej të ishte një kusht i vendosur nga Standardi EITI, dhe jo subjekt diskutimi i MSG me AP. Anëtarët MSG të konsultuar thanë se tashmë ata kishin planifikuar të kishin një diskutim më të detajuar për një qasje tjetër kundrejt garantimit të cilësisë që ishte realiste dhe për të gjitha kompanitë përkatëse të përputheshin me të. Si një alternativë e mundshme, AP vuri në dukje se do të ishte e kënaqur që formulari i raportimit të firmosej nga titullari (menaxheri) i secilit subjekt, por nënvizoi se më pak se 50 subjekte raportuese kishin ofruar raportime të firmosura nga titullarët për formularët e raportimit të vitit 2016.

Raporti jep një përmbledhje e punës së kryer nga AP (fq. 110-113). Ai i referohet punës së AB-së që po ndërmerret në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Shërbime të Ndërlidhura (ISRS) 4400 dhe se procedurat e rakordimit nuk janë hartuar për të krijuar përbërë një auditim apo shqyrtim ekuivalent me ISA ose ISRS (fq.3).

Konfidencialiteti: Ndërsa raporti nuk i referohet mekanizmave të zbatuara për të siguruar konfidencialitetin të informacionit financiar përpara rakordimit, referenca për punën e AP që po ndërmerret në përputhje me standardin ISRS 4400 (fq.3) nënkupton që në praktikë janë aplikuar mekanizma të duhur të konfidencialitetit.

Mbulimi i rakordimeve:

Raporti nuk siguron mbulimin final të rakordimeve (dmth. të ardhurat e rakorduara në raport me totalin e të ardhurave nga industria nxjerrëse). Të gjitha rakordimet e paraqitura në raport kanë të bëjnë vetëm me mbulimin e zërave që janë në fokus të raportimit (dmth. pjesa e pagesave nga kompanitë rakordohen në dritën e kufizimeve të raportimit), me një total rakordimi të 92% të të ardhurave në fokus të raportimit (fq.101). Ndërsa raporti është transparent në lidhje me sfidat për disagregimin e komponentit të nxjerrjeve nga zëri i përbashkët i taksave të paguara nga subjektet raportuese, ai nuk jep një mbulim të rakordimit total të pagesave tatimore dhe jo tatimore, të cilat do të ishin relativisht të ulëta pasi do të përfshinte pagesa të subjekteve nxjerrëse të lidhura me aktivitete jo-nxjerrëse. Sidoqoftë, mbulimi i rakordimit final mund të vlerësohet si 64.86% [të totalit] në bazë të të dhënave në Tabelat 1, 31 dhe 43 të Raportit EITI 2016 (fq.13,141,145-147).

Mungesat në garancitë (çertifikimet) e cilësisë: Një përmbledhje e detajuar e të dhënave të dorëzuara dhe të çertifikimeve përkatëse sipas subjekteve përfshihet në Shtojcën 6 (fq.180-185), dhe që tregon se vetëm 17 kompani sollën garancitë e kërkuara të cilësisë në raportimet e tyre EITI (fq.97). Raporti mundëson peshën e pagesave të secilës kompani që nuk ka qenë në përputhje me dorëzimin e garancive, duke përdorur numrat NIPT/TIN të paraqitura në Shtojcën 6 (fq.180-185) dhe rezultatet totale të rakordimeve të paraqitura në raport (fq.141.145-147).

Një ndarje e ngjashme ofrohet edhe për entet qeveritare (f.98) e që tregon se asnjëra prej entiteteve qeveritare të vlerësuara nuk ka dorëzuar garancinë e kërkuar të cilësisë për raportimin e tyre EITI. Ndërsa kjo nënkupton që asnjë nga të ardhurat e raportuara nga qeveria nuk i nënshtrohet garancisë së cilësisë të kërkuar për raportimin e EITI-t, specifikisht dorëzimi i pasqyrave të tyre financiare të audituara, raporti shpjegon se AP shqyrtoi raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për të gjitha entitetet qeveritare përkatëse (institucionet publike dhe NSH-të) dhe nuk identifikoi asnjë gjetje që mund të ndikojë në saktësinë dhe plotësinë e shifrave të Raportit EITI (f.98).

Vlerësimi i besueshmërisë së të dhënave: Raporti përmban vlerësimin e AP për plotshmërinë e të dhënave financiare të 2016, të rakorduara (fq. 100-101), megjithëse vlerësimi i besueshmërisë së të dhënave të rakorduara është mjaft i paqartë (fq.100-101).

Për sa i përket plotësisë, raporti jep vlerësimin e AP-së se pesha e vogël e mangësive nga subjektet jo-raportuese do të thotë se "çdo mungesë apo moskorrektësi e pambuluar nga rakordimi nuk do të ndikonte rëndësishëm në tërësinë e raportit të EITI" (fq.101). Në plan më të gjerë, raporti vëren se gjasat

për mungesa të pagesave fiskale nga nga fokusi i rakordimit konsiderohen "shumë të ulëta" duke pasur parasysh kontrollin (rregullimin) e lartë të këtyre pagesave dhe faktin se kompanitë janë "të prirura për të raportuar të gjitha pagesat e bëra dhe kanë këto shifra i kanë të aprovuara për raportimet e autoriteteve fiskale"(faqe 100). Megjithatë raporti pranon se procesi i rakordimit nuk ishte i dizenuar për të identifikuar ndonjë pagesë që mund të ishte hequr nga të dy anët: kompanitë dhe subjektet qeveritare (f.113). Disa zyrtarë qeveritarë konfirmuan se nuk ishte e mundur të disagregoheshin taksat e përbashkëta (siç është Tatimi mbi fitimin) për të dalluar tatimin e paguar për aktivitetet nxjerrëse dhe ato të paguara në aktivitetet jo nxjerrëse, gjë që shpjegonte nivelin e ulët të rakordimeve të llogaritur bazuar në pasqyrën e plotë e të njëanshme të qeverisë për të ardhurat siç paraqitet në Tabelën 1 të raportit, ku përfshihen taksat e përbashkëta për aktivitetet jo nxjerrëse.

Për sa i përket besueshmërisë, raporti përmban vlerësimin e AP-së për auditimet themelore të subjekteve raportuese në vend të një vlerësimi të pajtueshmërisë me procedurat e dakorduara të garantimit të cilësisë, specifikisht për raportimin e EITI. Në të vërtetë, raporti vëren se "procedurat e kryera të rakordimit nuk kanë për qëllim zbulimin e evazionit fiskal. Megjithatë, ky rrezik frenohet nga fakti se 78.7% (grafiku 38) e të dhënave janë raportuar nga subjektet që kanë kaluar përmes auditimit ligjor" (fq.101). Megjithatë, raporti gjithashtu vë në dukje se, duke pasur parasysh mungesën e disagregimit të mjaftueshëm të të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Administrata Doganore Shqiptare në pasqyrat e tyre financiare, AP nuk kishte mundur të krahasonte të dhënat e marra prej formularëve të raportimit të EITI-t me pasqyrat vjetore të publikuara të këtyre insitucioneve (fq.113). Raporti gjithashtu komenton, në rekomandimet e tij, "cilësinë e dobët të të dhënave në dispozicion" (fq.123), duke hedhur dyshime mbi besueshmërinë e të dhënave financiare të rakorduara në dritën e mangësive të konsiderueshme në garantimin e cilësisë për raportimin e EITI të dorëzuar nga subjektet raportuese (shiko *Mungesat në garancitë (certifikimet) e cilësisë* më sipër). Gjatë konsultimeve, AP shpjegoi se nuk mund të ofrojë një vlerësim të qartë të besueshmërisë së të dhënave financiare të rakorduara për shkak të mungesave të konsiderueshme më garancitë e cilësisë nga kompanitë raportuese.

Burimet e informacionit: Të gjitha informacionet jofinanciare në Raportin EITI 2016 duket se vijnë nga burime të qendrushme, përveç disa kufizimesh sa i përket udhëzimeve për aksesimin e materialeve burimore (p.sh. mungesa e lidhjeve [hyperlinks] të qendrushme të dokumenteve në dispozicion online). Pasqyrat financiare të audituara të Albepetrol nuk janë në dispozicion në faqen e tyre të internetit siç thuhet në raport, por kërkojnë kërkime të thella në Regjistrin Kombëtar të Biznesit.⁸⁴

Tabelat përmbledhëse: Të dhënat e përmbledhura për të gjitha Raportet EITI të Shqipërisë, duke përfshirë 2016, janë përgatitur dhe janë të aksesueshme përmes nën-faqes për Shqipërinë në faqen e internetit të EITI⁸⁵ dhe në faqen e internetit të AlbEITI⁸⁶.

Rekomandime: Kapitulli 11 i Raportit EITI 2016 ofron një pasqyrë të ndjekjes së rekomandimeve të raporteve të mëparshme EITI, duke përfshirë komentet mbi progresin në zbatimin e tyre (fq. 123-138). Rekomandimet bazuar në Raportin EITI 2016 jepen gjithashtu në Kapitullin 11 dhe shënohen si "të reja" (fq.126,131-133).

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korigjues mbi besueshmërinë e të dhënave është arritur pjesërisht dhe gjykon se Shqipëria ka bërë progres domethënës me përmirësime në kërkesën 4.9. Në përputhje me kërkesën 4.9, rakordimi i pagesave dhe të ardhurave është realizuar nga një AP, i

⁸⁴ Faqja e QKB (Dhjetor 2017), Deklarat Financiare Albpetrol 2016 aksesuar [këtu](#) dhe raporti i auditit 2016 aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁸⁵ Seksioni për mbledhjet e të ardhurave, faqja për Shqipërinë, faqja e internetit e EITI, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁸⁶ Faqja e internetit AlbEITI, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

emëruar nga MSG, duke zbatuar standardet profesionale ndërkombëtare. AP dhe MSG ranë dakord për TeR për përgatitjen e Raportit EITI 2016 në përputhje me TeR standarde dhe procedurat e dakordësuara të lëshuara nga Bordi EITI, dhe zbatuan këtë TeR dhe procedurat përkatëse në praktikë. Raporti përfundimtar jep një deklaratë nga AP për plotshmërinë e të dhënave (financiare) të paraqitura, duke përfshirë një përmbledhje informative të punës së kryer nga AP dhe për kufizimet e vlerësimit të ofruar, por nuk jep vlerësimin e AP për besueshmërinë e të dhënave të rakorduara. Nga raporti është e mundur të llogaritet mbulimi përfundimtar i rakordimeve dhe ka informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar materialitetin (peshën) e pagesave nga kompanitë raportuese që nuk kanë dhënë garanci të pranuar të cilësisë (çertifikime) për raportimin e tyre të EITI, të cilat janë të rëndësishme. Me vetëm 17 nga 121 kompanitë raportuese që plotësuan kërkesën e dhënies së garancive të cilësisë për raportimin e tyre të EITI, konsultimet e grupeve të interesit konfirmuan se nuk ishte e mundur që AP të jepte një vlerësim të besueshmërisë së të dhënave financiare të rakorduara në përputhje me remat e referencës së tij. Miratimi i nga ana grupit të industrisë në MSG të procedurave të garantimit të cilësisë që në praktikë zbatohen vetëm nga pak subjekte, pasqyron sfidat më të gjera në mbikqyrjen nga e MSG-së të aspekteve teknike të zbatimit të EITI në 2016-2017 (Shiko kërkesa 1.4). Megjithatë, Raporti EITI 2016 gjeneron informacion adekuat, ofron një pasqyrë të ndjekjes së rekomandimeve që rrjedhin nga Raportet EITI dhe Validimi dhe ofron një grup të ri rekomandimesh. Tabelat përmbledhëse të të dhënave EITI janë përgatitur për të gjitha vitet fiskale të mbuluara nga raportimi i EITI.

Në përputhje me kërkesën 4.9.a, EITI kërkon një vlerësim nëse pagesat dhe të ardhurat janë subjekt i auditimit të besueshëm dhe të pavarur, duke zbatuar standardet ndërkombëtare të auditimit. Në përputhje me kërkesën 4.9.b.iii dhe Termat standarde të Referencës për AP të rënë dakord nga Bordi EITI, MSG dhe AP duhet të zhvillojnë dhe të bien dakord për procedurat e garantimit të cilësisë për raportimin EITI të Shqipërisë, bazuar në një shqyrtim të praktikave të auditimit dhe garantimit të cilësisë të vitit nën shqyrtim. Shqipëria duhet të sigurojë që AP të japë një vlerësim nëse të gjitha kompanitë dhe entitetet qeveritare të përfshira në fokus të raportimit EITI, të kenë ofruar informacionin e kërkuar. Çdo boshllëk ose dobësi në raportimin e AP duhet të shpalojë në Raportin e EITI, duke përfshirë cilësimin me emër të çdo subjekti që nuk u përmbahet procedurave të miratuara dhe një vlerësim nëse kjo shmangie ka gjasa të ketë pasur ndikim me peshë në tërësinë dhe besueshmërinë e raportit. Shqipëria duhet të sigurojë që AP të japë një vlerësim të plotësisë dhe besueshmërisë së të dhënave (financiare) të paraqitura, duke përfshirë një përmbledhje informative të punës së kryer nga Administratori i Pavarur dhe kufizimet e vlerësimit të ofruar. Në përputhje me kërkesën 8.3.c.i, MSG duhet të përgatisë dhe publikojë një plan veprimi për adresimin e mangësive në besueshmërinë e raportimit të dokumentuar në vlerësimin fillestar.

3.9 Veprimi korrigjues 11 (#5.1)

Në përputhje me kërkesën 5.1.a, MSG duhet të sigurojë që të shpjegohet alokimi i të ardhurave [të industrisë] nxjerrëse të paregjistruara në buxhetin kombëtar, duke dhënë link-et përkatëse të raporteve financiare përkatëse aty ku është e zbatueshme. MSG mund të dëshirojë të eksplorojë shkallën në të cilën mund të përdorë klasifikimet e GFS, specifike për industrinë nxjerrëse, tek tabelat me të dhëna të përmbledhura të EITI si një mjet për disagregimin e komponentëve të taksave të përbashkëta, në sistemet ekzistuese të Ministrisë së Financave.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë progres domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë. Ndërsa Raporti i EITI për vitin 2015 i përcaktonte të ardhurat [nga industria] nxjerrëse të mbledhura nga AKBN dhe Albpetrol si jashtë buxhetit (që nuk janë regjistruar në buxhetin kombëtar), ai ofronte vetëm

një shpjegim të alokimit të fondeve të mbledhura nga Albpetrol dhe jo të atyre të mbledhura nga AKBN. Ndërsa raporti nuk i referohej sistemeve të klasifikimit të të ardhurave kombëtare ose ndërkombëtare, Validimi i parë kuptoi se sistemet kombëtare të klasifikimit të të ardhurave bazoheshin në klasifikimet e GFS-2001.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Tabela 1 në Raportin EITI 2016 nxjerr në pah se një total prej 19.415 miliardë lekësh nga 21.382 miliardë lekë nga të ardhurat [prej industrisë] nxjerrëse transferohen në buxhetin e kombëtar (fq. 13). Diku tjetër, raporti konfirmon se 89.5% e të ardhurave të naftës dhe gazit regjistrohen në buxhetin kombëtar (fq.48). Nga 10,5% të të ardhurave të naftës dhe të gazit që nuk janë regjistruar në buxhetin kombëtar, raporti konfirmon se Albpetrol mbledh 10,1% të të ardhurave të naftës dhe gazit dhe AKBN mbledh 0,4% (fq.48). Ndërsa raporti nuk ofron një lidhje të qartë me pasqyrat financiare të audituara të Albpetrol 2016, ai i referohet atyre në disa vende dhe siguron lidhje [links] me faqen e internetit të Albpetrol (fq. 118). Ndërsa faqja e internetit të Albpetrol-it vetëm sa deklaron se pasqyrat financiare të audituara të vitit 2016 janë të process e sipër (dhe jo të aksesueshme nga faqja e internetit), ato janë praktikisht të aksesueshme përmes faqes së internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit⁸⁷, siç konfirmohet në Shtojcën 6 të raportit (fq. 185). Sa i përket 0,4% të të ardhurave të naftës dhe gazit të mbledhura dhe të mbajtura nga AKBN, raporti konfirmon që AKBN nuk bën pagesa dhe nuk merr asnjë transfertë nga qeveria, përveç aktiviteteve specifike të planifikuara në buxhetin kombëtar (f. 15). Raporti vë në dukje se pasqyrat vjetore financiare të AKBN nuk janë të aksesueshme për publikun dhe as nuk vihen në dispozicion të AP në përgatitje për Raportin EITI 2016 (f.15). Megjithatë, raporti konfirmon se AKBN mban të ardhurat e veta për të financuar aktivitetet e saj (f.15), duke nënkuptuar që fitimet e pashpërndara të AKBN-së përdoren për shpenzime operationale dhe jo për investime kapitale. Kjo u konfirmua nga disa zyrtarë të lartë qeveritarë që u konsultuan, të cilët thanë se AKBN ende nuk kishte pasqyra financiare të audituara. Zyrtarët e konsultuar theksuan reformat e planifikuara për statusin ligjor të AKBN-së, që pritet në vitin 2019, me një nga opsionet e konsideruara që ka të bëjë me reformimin e statusit të AKBN-së në një agjenci qeveritare, pasqyrat financiare të së cilës do të regjistrohen në buxhetin kombëtar.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korrigjues mbi shpërndarjen e të ardhurave është adresuar dhe gjykon se Shqipëria ka bërë progres të kënaqshëm në kërkesën 5.1. Raporti EITI 2016 identifikon burimet e të ardhurave prej industrisë nxjerrëse që nuk regjistrohen në buxhetin kombëtar dhe jep një shpjegim dhe lidhje me pasqyrat financiare të audituara të Albpetrol, që ka mbledhur dhe mbajtur rreth 10% të të ardhurave qeveritare të naftës dhe gazit në vitin 2016. Ndërsa raporti identifikon AKBN si agjenci qeveritare që grumbullon dhe mban 0,4% të të ardhurave qeveritare të naftës dhe gazit në vitin 2016, pa siguruar ndonjë link për të aksesuar pasqyrat financiare të agjencisë, ai ofron një shpjegim të shkurtër të menaxhimit të të ardhurave të mbajtura të AKBN, të përdorura për shpenzimet periodike agjencisë. Palët e interesuara të konsultuara konfirmuan mungesën e disponueshmërisë së pasqyrave financiare të AKBN dhe theksuan reformat e vijuese të statusit ligjor të agjencisë. Duke pasur parasysh vlerën e ulët të fitimeve të pashpërndara të AKBN-së, shpjegimin e shkurtër në Raportit të EITI për menaxhimin e këtyre të ardhurave dhe, pikëpamjet e grupeve të interesit për reformat në vazhdim për të mundësuar përfshirjen e pasqyrave financiare të AKBN në bilancin e qeverisë, pikëpamja e

⁸⁷ Faqja e QKB, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

Sekretariatit Ndërkombëtar është se të gjitha aspektet e kërkesës janë përmbushur dhe se objektivi më i gjerë i qartësimi të të ardhurave jashtë buxhetit është arritur.

Për të forcuar zbatimin, Shqipëria inkurajohet të sigurojë publikimin e raporteve financiare për të gjitha të ardhurat nga industria nxjerrëse që nuk pasqyrohen në buxhet, përfshirë ato të mbledhura dhe të mbajtura nga AKBN. Shqipëria mund të dëshirojë të përdorë raportimin e EITI për të siguruar një diagnostifikim vjetor të reformave qeveritare të të ardhurave jashtë buxhetit për të forcuar llogaridhënien publike në reformën e agjencive siç është AKBN.

3.10 Veprimi korrigjues 12 (#6.1)

Në pajtim me kërkesën 6.1.a, MSG duhet të bjerë dakord për një dallim të qartë midis shpenzimeve sociale të detyrueshme dhe vullnetare përpara grumbullimit të të dhënave dhe të sigurojë që shpenzimet sociale të detyrueshme të publikohen në mënyrë të plotë në raportet e ardhshme të EITI. Kur përfituesit e shpenzimeve sociale të detyrueshme janë një palë e tretë, pra jo agjenci qeveritare, MSG duhet të sigurojë që emri dhe funksioni i përfituesit të publikohen. MSG mund të dëshirojë të marrë në konsideratë shkallën në të cilën do të ishte e nevojshme publikimi i kontratave aktuale minerare, të naftës dhe gazit (ose përmbledhja e termave kryesore) për të siguruar një vlerësim të plotë të ekzistencës së shpenzimeve sociale të detyrueshme. MSG gjithashtu mund të konsiderojë mundësinë e rakordimit të shpenzimeve sociale të detyrueshme.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë progres të pamjaftueshëm drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. MSG nuk u duk të kishte vlerësuar nëse shpenzimet sociale të detyrueshme ekzistonin sipas kushteve kontraktuale përpara grumbullimit të të dhënave dhe ka pasur konfuzion të gjerë nëse këto shpenzime sociale të detyrueshme ekzistojnë. Raporti i EITI për vitin 2015 ka ofruar një raport të njëanshëm të shpenzimeve sociale nga një kompani e naftës dhe gazit (megjithëse kjo mund të jetë përfshirë gabimisht), por nuk sqaronte nëse ato ishin të detyrueshme dhe nuk përfshiu shqetësimet e AP-së mbi plotësinë e raportimit të shpenzimeve sociale të detyrueshme në Raportin EITI 2015. MSG duket se nuk ka bërë asnjë përpjekje për të dalluar shpenzimet sociale të detyrueshme nga ato vullnetare, shpenzimet në të holla dhe ato në natyrë dhe as të sqarojë identitetin e çdo përfituesi jo-qeveritar të shpenzimeve sociale të detyrueshme.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Raporti EITI 2016 vëren se qeveria, kompanitë e naftës dhe "kompanitë më të mëdha minerare" e kanë informuar AP se aktualisht KNP-të aktive, koncesionet minerare dhe licencat nuk kërkojnë që kompanitë të bëjnë pagesa të detyrueshme sociale (fq.49,69). Raporti vëren se AP i konfirmoi këto deklarata me një shqyrtim të kontratave të vëna në dispozicion të publikut (fq.49,69). Kjo është konfirmuar në raportin vjetor të progresit 2017⁸⁸. Raporti shton se koha dhe vlera e pagesave sociale të kompanive vendosen nga kompanitë e naftës dhe të minierave sipas gjykimit të tyre (fq.49,69), megjithëse vë në dukje se kompanitë e naftës duhet të zbulojnë shpenzimet sociale të buxhetuara tek AKBN ose Albpetrol (në varësi të juridiksionit) për miratim si pjesë e buxheteve të tyre vjetore (fq.49). Në sektorin e minierave ka pasur konsensus në mesin e të gjithë aktorëve të konsultuar që nuk ka shpenzime sociale të detyrueshme me ligj ose me kontratë. Në naftë dhe gaz, ndërsa një përfaqësues i qeverisë shprehu përshtypjen e përgjithshme se ndryshimet e vitit 2014 në KNP-në me Bankers Petroleum në fushën e naftës Patos-

⁸⁸ EITI Albania (Korrik 2018), 'Raporti Vjetor i Progresit 2017', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

Marinzës përfshinin dispozita për shpenzimet sociale të detyrueshme, asnjë nga palët e tjera të konsultuara (duke përfshirë edhe qeverinë) nuk mendonin se ekzistonin dispozita të tilla në ndonjë KNP tjetër gazi apo naftë. Disa përfaqësues të qeverisë dhe të industrisë si dhe AP vunë re se kompanitë mund të kërkonin deri në 2 milionë dollarë në shpenzimet sociale vullnetare si shpenzime të zbritshme, por ishin të bindur se nuk kishte dispozita ligjore që kërkonin që kompanitë të bënin pagesa të tilla.

Megjithatë, duket se kompanive raportuese u ishte kërkuar të shpalosin çdo shpenzim social të detyrueshëm ose vullnetar si pjesë e formularëve të tyre të raportimit, pasi raporti vë në dukje se asnjëra nga kompanitë e naftës, gazit apo minierave nuk raportoi ndonjë shpenzim social të detyrueshëm (fq.11t - 119). Raporti konfirmon që asnjë kompani e naftës dhe gazit nuk ka raportuar ndonjë shpenzim social vullnetar (f.117). Në miniera, raporti zbulon raportimin nga ana e një kompanie të shpenzimeve sociale vullnetare, prej gjithsej 282,620 lekë për Bashkitë e Tiranës dhe Kukësit (f.119), megjithëse nuk janë të disagreguara sipas secilës njësi të qeverisë vendore.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korigjues mbi shpenzimet sociale është adresuar dhe gjykon se kërkesa 6.1 nuk është e aplikueshme për shqipërinë në vitin nën shqyrtim (2016). Raporti EITI 2016 thekson kategorikisht se nuk ka shpenzime sociale të detyrueshme në miniera ose në naftë dhe gaz, bazuar në shqyrtimin e kontratave të disponueshme dhe konsultimeve me palët e qeverisë dhe të industrisë. Konsultimet e palëve të interesuara nga ana e Sekretariatit në përgjithësi e konfirmuan këtë. Ndërsa kompanive raportuese iu ishte kërkuar të raportojnë detajet e shpenzimeve të tyre vullnetare sociale në Raportin EITI 2016, asnjë nga minierat, kompanitë e naftës dhe gazit nuk raportoi këto pagesa.

Për të forcuar zbatimin, Shqipëria inkurajohet të sigurojë që kompanitë e minierave, naftës dhe gazit të zbulojnë publikisht detajet e shpenzimeve të tyre sociale vullnetare, me të gjitha informacionet e renditura sipas kërkesës 6.1. Shqipëria mund të dëshirojë të përdorë raportimin e EITI si një diagnostifikim vjetor të shpenzimeve shoqërore vullnetare të kompanive, me një fokus të veçantë në zbritshmërinë e kostove të shpenzimeve sociale të kompanive të naftës dhe gazit.

3.11 Veprimi korigjues 13 (#6.2)

Në përputhje me kërkesën 6.2, MSG duhet të marrë në konsideratë ekzistencën dhe peshën e çdo shpenzimi kuazi-fiskal të ndërmarrë nga NSH-të nxjerrëse dhe filialet e tyre, duke siguruar që të gjitha shpenzimet kuazi-fiskale të subjekteve raportues të shpalosen në Raportet e ardhshme EITI

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria nuk kishte bërë asnjë progres drejt përbushjes së kësaj kërkesë. Nuk kishte evidencë se MSG kishte konsideruar ndonjëherë çështjen e shpenzimeve kuazi-fiskale në lidhje me Albpetrol ose ndonjë NSH tjetër e industrisë nxjerrëse.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Raporti EITI 2016 i referohet deklaratave nga MIE dhe Albpetrol se ligji dhe rregulloret që qeverisin veprimtarinë e Albpetrol nuk përfshijnë parashikime për shpenzimet kuazi-fiskale (fq. 39). Megjithatë, raporti gjithashtu vë në dukje se *"Albpetrol punëson pjesën më të madhe të punëtorëve të naftës, [dhe] pavarësisht nga aktiviteti i saj në rënie, kjo mund të tregojë angazhimin e Albpetrol për të punësuar fuqi*

punëtore më të madhe pavarësisht kostos së efikasitetit të operacioneve të saj, e nxitur nga objektivat shoqërore" (f.39). Në sektorin e minierave, raporti gjithashtu i referohet konfirmimit të MIE se nuk ka marrëveshje për shpenzimet kuazi-fiskale (fq.54).

Pas fillimit të Validimit të dytë për Shqipërinë, MSG shqyrtoi ekzistencën dhe peshën e shpenzimeve kuazi-fiskale të NSH-ve të industrisë nxjerrëse në mbledhjen e saj të 27 shkurtit 2019. Në vendimin numër 3, të marrë në mbledhjen e MSG-së, MSG shprehu dakordësinë me "Deklaratën e AP në raportin EITI lidhur me shpenzimet kuazi-fiskale dhe se ligji dhe rregulloret që rregullojnë veprimtarinë e Albpetrol sh.a. nuk parashikojnë shpenzime të tilla."⁸⁹ Gjatë konsultimeve, AP konfirmoi se kishte shqyrtuar pasqyrat financiare të audituara të Albpetrol 2016 dhe nuk kishte gjetur dëshmi për ndonjë shpenzim që mund të konsiderohej kuazi-fiskal. Disa zyrtarë qeveritarë vunë në dukje shpenzimet sociale të Albpetrol, që përfshinin sponsorizime për aktivitete sportive, por konsideronin se këto nuk ishin një formë e shpenzimeve kuazi-fiskale, por shpenzime sociale vullnetare të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të Albpetrol.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korigjues mbi shpenzimet kuazi-fiskale është adresuar dhe gjykon se kërkesa 6.2 nuk është e aplikueshme për Shqipërinë për periudhën nën shqyrtim. Raporti EITI 2016 përfshin një përmbledhje të qëndrimeve të MSG për shpenzimet kuazi-fiskale dhe konkluzionet e tij se Albpetrol nuk ka ndërmarrë ndonjë shpenzim kuazi-fiskal në vitin në shqyrtim (2016). Ndërsa raporti e bazon këtë përfundim në shqyrtimin e ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme të MSG, konsultimet e palëve me AP konfirmuan se pasqyrat financiare të audituara të Albpetrolit në vitin 2016 gjithashtu ishin shqyrtuar gjatë vlerësimit të MSG.

Për të forcuar zbatimin, Shqipëria mund të dëshirojë të kryejë një vlerësim më të hollësishëm të shqyrtimit nga ana e MSG-së të pasqyrave financiare të audituara të Albpetrol-it, të cilat janë të aksesueshme për publikun, si një mjet për të demonstruar mungesën e shpenzimeve kuazi-fiskale gjatë vitit nën shqyrtim.

3.12 Veprimi korigjues 14 (#7.3)

Në përputhje me kërkesën 7.3, MSG duhet të ndërmarrë hapa për të vepruar sipas mësimëve të nxjerra, për të identifikuar, hetuar dhe adresuar shkaqet e ndonjë mospërputhjeje dhe për të marrë parasysh rekomandimet që rezultojnë nga raportimi i EITI. MSG, në konsultim me palët e interesuara të qeverisë në veçanti, mund të dëshirojë të konsiderojë institucionalizimin e mekanizmave të saj për të ndjekur rekomandimet nga Raportet EITI dhe Validimi si një mjet për të siguruar vëmendje më të madhe ndaj zbatimit.

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte bërë përparim domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë. Kishte evidenca të kufizuara veprimesh ndjekëse nga MSG ndaj mësimëve të nxjerra, për të identifikuar, hetuar dhe adresuar shkaqet e mospërputhjeve dhe për të shqyrtuar rekomandimet për përmirësime nga ana e AP në raportet e mëparshme të EITI. Procesverbalet e mbledhjeve të MSG nuk zbuluan diskutime thelbësore mbi rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga Raportet EITI. Raportet e njëpasnjëshme të EITI që mbulonin një periudhë prej pesë vitesh kishin përfshirë të njëjtat rekomandime. Raporti vjetor i progresit ofroi disa vlerësime për ndjekjen e rekomandimeve të kaluara të EITI, megjithëse vetëm në një masë të kufizuar. Sekretariati AlbEITI kishte qenë nxitës i ndjekjes së rekomandimeve, në mënyrë

⁸⁹ Shiko Vendimi Nr 3, Vendimet e mbledhjeve të MSG për mbledhjen e datës 27 Shkurt 2019, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

bilaterale me agjencitë përkatëse përmes grupeve të përkohshme të punës, edhe pse mungesa e angazhimit të shumë grupeve të interesit kishte kufizuar shkallën në të cilën ndikimi i sekretariatit kishte ndikuar.

Progresi që prej Validimit

MSG diskutoi projekt rekomandimet për t'u përfshirë në Raportin EITI 2016 në mbledhjet e 28 marsit dhe 15 majit 2018⁹⁰. Në procesverbalet e mbledhjeve të MSG-së ekzistojnë gjithashtu dëshmi të diskutimeve nga ana e MSG-së për shkaqet e mospërputhjeve në rakordimet e pagesave dhe të ardhurave, si përara publikimit të Raportit EITI 2016 ashtu edhe gjatë kohës së shpërndarjes dhe komunikimit të tij. MSG gjithashtu diskutoi gjerësisht rekomandimet dhe veprimet korigjuese nga Validimi i parë për Shqipërinë në takimin e 28 marsit 2018⁹¹. Raporti vjetor i progresit i vitit 2017 e dokumenton punën vijuese të MSG-së mbi rekomandimet e raporteve të kaluara të EITI deri në Raportin EITI të vitit 2015, duke vënë në dukje se puna vijuese e MSG-së mbi rekomandimet e Raportit EITI 2016 dhe Validimin do të dokumentohen në Raporti i progresit vjetor 2018⁹². Raporti EITI 2016 ofron një pasqyrë të ndjekjes së rekomandimeve të Raporteve të kaluara të EITI (deri në 2015), duke vënë në dukje se kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar raportimin dhe analizën e aktiviteteve nxjerrëse dhe rrjedhave të të ardhurave⁹³. Ka pasur disa mbulime mediatike të rekomandimeve të dhëna raportet EITI, duke përfshirë një artikull të shkurtit 2018 nga Drejtori i Informacionit i RTV SCAN, Enio Civici publikuar në faqen e internetit AlbEITI⁹⁴.

Në mbledhjen e datës 11 Janari 2019, MSG diskutoi krijimin e një grupi pune për të siguruar ndjekjen e strukturuar të rekomandimeve nga Validimi dhe Raportet e kaluara të EITI, grup I cili u formua zyrtarisht në mbledhjen e datës 12 Shkurt 2019. Grupi i ri i punës i MSG pritet që specifikisht *"të nxjerrë në pah mospërputhjet në kuadrin ligjor, fiskal dhe rregullator në fushën e minierave, naftës dhe gazit dhe mbështetjen institucionale për finalizimin e Projektligjit për Transparencë në Sektorin e Industrive Nxjerrëse"*⁹⁵. "Sipas një njoftimi për shtyp në faqen e internetit të AlbEITI, secili nga grupet e interesit në MSG zgjodhi një përfaqësues për të qenë pjesë e këtij grupi pune⁹⁶. Siç është pasqyruar në planin e punës të përditësuar të EITI 2018-2019, grupi i punës i MSG-së për ndjekjen e rekomandimeve të EITI duhet të kishte rënë dakord për një plan veprimi për ndjekjen e rekomandimeve nga Validimi dhe Raportet e kaluara të EITI deri më 1 mars 2019, ndërsa ndjekja e strukturuar e rekomandimeve të shkuara është planifikuar për periudhën Shkurt-Dhjetor 2019⁹⁷. Plani i dedikuar i punës AlbEITI për ndjekjen e rekomandimeve prej Raporteve EITI dhe Validimit u ra dakord në fillim të Marsit 2019 dhe u shpërnda nga Sekretariati AlbEITI [tek palët] si pjesë e dokumentacionit për Validimin e dytë. Plani i dedikuar i punës përfshin aktivitete specifike për të ndjekur rekomandimet specifike, me afate të qarta kohore dhe përgjegjësi individuale. Plani i përditësuar i punës EITI 2018-2019 gjithashtu përfshin plane për kontraktimin e shërbimeve të konsulencës për të mbështetur ndjekjen nga ana e qeverisë e rekomandimeve të shkuara EITI në periudhën prill-shtator 2019, mbështetur nga një grant 10,000 USD i Bankës Botërore⁹⁸. Plani i përditësuar i punës EITI 2018-2019 parashikon miratimin e Ligjit për Transparencën dhe rregulloret zbatuese deri në dhjetor 2019.⁹⁹

⁹⁰ AlbEITI (Mars 2018), Procesverbal nga mbledhja e MSG 28 Mars 2018, aksesuar [këtu](#); dhe AlbEITI (Maj 2018), Procesverbal nga mbledhja e MSG 15 Maj 2018, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁹¹ AlbEITI (Mars 2018), Procesverbal nga mbledhja e MSG, 28 Mars 2018, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁹² AlbEITI (Qershor 2018), 2017 Raporti Vjetor i Progresit, aksesuar [këtu](#) në Mars 2019, p.32.

⁹³ AlbEITI (Dhjetor 2018), '2016 Albania EITI Report', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019, p.88.

⁹⁴ AlbEITI (Shkurt 2018), 'EITI në Shqipëri, rekomandimet kryesore për industrinë nxjerrëse – nga Enio Civici', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁹⁵ AlbEITI (Janar 2019), 'Vendimet e MSG ne 2019', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

⁹⁶ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Takim i MSG në funksion të prioritetëve dhe sfidave EITI', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁹⁷ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Plani i përditësuar i punës i EITI Shqiperi 2018-2019', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁹⁸ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Plani i përditësuar i punës i EITI Shqiperi 2018-2019', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

⁹⁹ AlbEITI (Shkurt 2019), 'Plani i përditësuar i punës i EITI Shqiperi 2018-2019', aksesuar [këtu](#) në Shkurt 2019.

Vlerësimi i Sekretariatit

Sekretariati Ndërkombëtar është i kënaqur që veprimi korrigjues për punën vijuese mbi rekomandimet është adresuar dhe gjykon se Shqipëria ka bërë progres të kënaqshëm në kërkesën 7.3. MSG AlbEITI, krijoi, me vonesë (në shkurt 2019), një grup pune me një plan të përcaktuar kohor për të vepruar sipas mësimave të nxjerra, për të identifikuar, hetuar dhe adresuar shkaqet e çdo mospërputhjeje dhe dobësie të procesit EITI dhe të merrte në konsideratë rekomandimet e AP për përmirësime.

Për të forcuar zbatimin, AlbEITI dhe qeveria mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë formalizimin e mekanizmave qeveritarë për ndjekjen e rekomandimeve prej raporteve e shkuara EITI dhe Validimit si një mjet për të siguruar qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e vazhdueshëm të kanaleve të punës vijuese.

4. Vlerësim i kërkesave të gjykuara më herët si të kënaqshme nga Validimi i parë

Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Sekretariati Ndërkombëtar ka shqyrtuar gjithashtu nëse ka nevojë të shqyrtohen kërkesa shtesë, dmth ato që vlerësohen si "me progres të kënaqshëm" në Validimin e 2016. Në veçanti, Sekretariati shqyrtoi mundësinë e rrëshqitjeve mbrapa tek raporti EITI 2016 në kërkesat e lidhura me plotshmërinë (Kërkesa 4.1) dhe disagregimin (Kërkesa 4.7). Pikëpamja e Sekretariatit është se ka evidenca që sugjerojnë se progresi ka rënë nën standardin e kërkuar në Kërkesën 4.1 dhe kërkon marrjen parasysh nga Bordi EITI, për një ulje të nivelit të vlerësimit në "progres domethënës". Sekretariati rekomandon që Bordi të ushtrojë diskrecionin e vet në marrjen parasysh të disagregimit të të dhënave, të publikuara pas fillimit të Validimit, dhe konkludon se Shqipëria vazhdon të ketë bërë "përparim të kënaqshëm" në kërkesën 4.7.

4.1 Vlerësim i Kërkesës 4.1

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë konstatoi se raporti i EITI 2015 përfshiu përkufizimin e MSG për kufijtë e materialitetit (peshës) për pagesat dhe kompanitë që duhej të përfshiheshin në rakordim bazuar në vëllimet e prodhimit, duke përfshirë arsyetimin pse pragjet u vendosën në këtë mënyrë dhe në këtë nivel. Megjithatë, vendosja e një pragu cilësor sesa sasior për zgjedhjen e burimeve të qënësishëm të të ardhurave (si pjesë e të ardhurave të qeverisë për shembull) konsiderohej një shqetësim. Megjithatë, ndërsa dy nga flukset e të ardhurave të renditura në kërkesën 4.1.b ishin përjashtuar nga rakordimi bazuar vetëm në referencën e përgjithshme të mungesës së materialitetit (peshës) së tyre, nuk kishte prova për të sugjeruar se vlera e tyre ishte e rëndësishme. Kompanitë jo-raportuese u cilësuan (me emra) dhe vlera e pagesave të tyre ndaj qeverisë u paraqit e krahasuar me ardhurat (hyrjet) e raportuara nga qeveria. Pjesa e kompanive jo-raportuese u pa se ishte e parëndësishme. Raporti i EITI 2015 nuk shprehu në mënyrë eksplicite nëse të gjitha entitetet qeveritare me peshë raportuan të gjitha të ardhurat, ndonëse konsultimet me palët e interesuara konfirmuan se të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore kishin raportuar plotësisht dhe se mungesat nga njësitë e qeverive vendore nuk konsideroheshin me peshë. Ndërsa komenti i AP për plotshmërinë e Raportit EITI ishte i kufizuar vetëm tek një deklaratë për mungesën e garancive të cilësisë, ishte e mundur të llogaritej pesha e mungesave. Duke pasur parasysh se këto dukeshin të parëndësishme, në dritën e pragut të ulët të materialitetit (peshës) të miratuar për zgjedhjen e kompanive me peshë dhe në dritën e vendimit të Bordit EITI në raste të tjera të krahasueshme si Mongolia, Validimi i parë gjeti se Shqipëria kishte bërë progres të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë.

Progresi që prej Validimit

MSG i EITI në Shqipëri ka aprovuar dhe publikuar Raportin EITI 2016 në Korrik 2018.

Praqu i materialitetit (peshës) për zërat e të ardhurave: Për rakordimet për naftën dhe gazin, Raporti EITI 2016 përshkruan pragun e peshës zero për përzgjedhjen e zërave të të ardhurave të naftës dhe gazit (si pagesat kontraktuale ashtu edhe pagesat fiskale) (fq.106). Ai thekson se "tarifat e liçencës" dhe "tarifat e hyrjes" janë përjashtuar nga rakordimi pasi raporti deklaroi se ato nuk shkuan në deri në nivelin e "pagesave thelbësore" në vitet e mëparshme (fq.107), por nuk justifikon përjashtimin e tyre në bazë të vlerave të tyre (materialitetin) në vitin 2016. Megjithatë, qasja e përjashtimit të këtyre dy zërave të të ardhurave është në përputhje me atë të Raporteve të mëparshme EITI të vlerësuara në Validimin e Parë për Shqipërinë, që arriti në përfundimin se përjashtimi i tyre nuk sillte një ulje të notës së vlerësimit duke qenë se "nuk kishte evidenca për të sugjeruar se vlera e tyre ishte e rëndësishme"¹⁰⁰. Gjatë konsultimeve mbi Raportin EITI 2016, AP konfirmoi se të dyja zërat e liçencave ishin nën pragun e materialitetit (peshës) prej 50,000 USD për zërat e të ardhurave në nivelin e qeverisë qendrore në vitin 2016. Për minierat, raporti përshkruan pragun e materialitetit zero për përzgjedhjen e zërave të të ardhurave për rakordim (fq.107). Ai shpjegon se të ardhurat (si për minierat ashtu edhe për naftën dhe gazin) që nuk lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet nxjerrjes (së sipërme) u përjashtuan, përfshirë taksat e importit dhe taksat vendore të aplikuara për të gjitha kompanitë (fq.107). Sidoqoftë, gjatë konsultimeve, AP sqaroi se vetëm Bankers Petroleum importoi naftë bruto dhe se pagesat për taksa vendore në një numër NjQV-sh ishin rakorduar. Të gjithë zërat e të ardhurave (hyrjet) të renditura sipas Kërkesës 4.1.b (ku është e aplikueshme) janë përfshirë në fokus të rakordimeve, përveç tarifave të liçencës dhe tarifave të hyrjes.

Përveç kësaj, raporti shpjegon se MSG ra dakord të përfshijë "çdo pagesë tjetër" prej më shumë se 50 000 USD për pagesat e bëra shtetit dhe 5 000 USD për pagesat e bëra për qeveritë vendore në të gjithë sektorët (fq.107).

Përshkrimi zërave të të ardhurave me materialitet (peshë): Raporti përfshin zërat e të ardhurave me peshë (peshë) sin ë sektorin e minierave (fq.70-72) ashtu dhe në atë të naftës dhe gazit (fq.46-49).

Praqu i materialitetit (peshës) për subjektet: Për naftën dhe gazin, raporti konfirmon se të gjitha kompanitë janë përzgjedhur për të raportuar, me një prag *de facto* të materialitetit prej zero, me përjashtim të Albanides Energy, që justifikohet nga fakti se kompanisë iu dha shfrytëzimi i vetëm një blloku naftë dhe gazit në Mars 2016 (f. 107), megjithëse pa konfirmuar nëse kompania ka bërë ndonjë pagesë qeverisë në vitin 2016. Disa zyrtarë qeveritarë të konsultuar shpjeguan se KNP me Albanides ishte shfuqizuar menjëherë pas dhënies (në 2017) për shkak të mos pagesës së detyrimeve ndaj qeverisë.

Për minierat, MSG përzgjedhi për raportim të gjitha kompanitë minerare që shfrytëzojnë një liçencë eksplorimi, me një prag *de-facto* të materialitetit prej zero në përpjekje për të zbuluar pagesat me peshë që rrjedhin nga aktivitetet e eksplorimit (fq 107). Përveç kësaj, MSG përzgjedhi kompanitë minerare që kishin një liçencë prodhimi bazuar në të ardhurat e tyre vjetore, të diferencuara sipas nënsektorit minerar¹⁰¹ (fq.107-108). Megjithatë, raporti ngre shqetësime lidhur me besueshmërinë e të dhënave të prodhimit të mineraleve të AKBN, të cilat bazohen në vetë-raportimin e kompanive (fq. 108). Ndërsa përzgjedhja e kompanive *materiale* bazuar në të ardhurat vjetore në vend të peshës të pagesave të tyre ndaj qeverisë është një shqetësim, gjatë konsultimeve, AP vuri në dukje se pagesat e kompanive minerare

¹⁰⁰ Shiko EITI (Gusht 2017), 'Validimi për Shqipërinë: Raport mbi mbledhjen fillestare të të dhënave dhe konsultimet me palet', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019, fq.80.

¹⁰¹ MSG përzgjedhi kompanitë minerare që shfrytëzojnë liçensë prodhimi sipas kriterëve të mëposhtme: (fq.107-108): për nën-sektorin e kromit, të gjitha kompanitë me të ardhura vjetore > USD 600,000; për nën-sektorin e bakrit, të gjitha kompanitë që operojnë në këtë sektor; për nën-sektorin e nikelit, të gjitha kompanitë me të ardhura vjetore > USD 300,000; për sektorin e bitumit ose rërës bituminoze të gjitha kompanitë me të ardhura vjetore > USD 320,000; për nën-sektorin e gurorëve të gjitha kompanitë me të ardhura vjetore > USD 250,000; për nën-sektorin e argjilës të gjitha kompanitë me të ardhura > USD 260,000; për nën-sektorin e gips alabastër të gjitha kompanitë me të ardhura vjetore > USD 650,000; për nën-sektorin e gurorëve për shtrim/gurë të gjitha kompanitë me të ardhura vjetore > USD 180,000.

drejt qeverisq ishin drejtpërdrejt ose tërthorazi të lidhura me të ardhurat e tyre vjetore dhe prandaj nuk ka gjasa që kompanitë që konsiderohen jo-materiale të bënin pagesa të qënësishme për qeverinë. Megjithatë, AP përsëriti shqetësimet mbi saktësinë e të dhënave zyrtare të prodhimit nga AKBN, duke nënkuptuar gjasat e mundshme që kompanitë të nënvlerësojnë prodhimin e tyre dhe kështu minimizojnë pagesat e tyre ndaj qeverisë.

Kompanitë me peshë (materialitet): Raporti paraqet emrat e kompanive me peshë në sektorët e naftës dhe gazit (fq.144) dhe minierave (fq.163-165).

Raportimi i kompanive me peshë (materialitet): Raporti konfirmon se të gjitha kompanitë e naftës dhe gazit dorëzuan formularët e raportimit (fq.116) dhe vëren se vetëm 81 nga 120 kompanitë minerare kanë raportuar (fq.105.118), duke paraqitur emrat e kompanive të minierave jo-raportuese (fq.163 -165). Vlera e çdo pagese totale ndaj qeverisë të kompanive minerare jo-raportuese në qeveri është paraqitur (fq.145-147). Vlera totale e pagesave nga kompanitë jo-raportuese ishte 19% e totalit të të ardhurave minerare të publikuara në mënyrë të njëanshme nga qeveria. Kjo mund të llogaritet si 4,62% e totalit të të ardhurave nxjerrëse të publikuara nga qeveria, nga ku secila kompani llogaritet me kontribut më pak se 0,5% të të ardhurave totale të nxjerrjes, përveç një kompanie, Gener 2, një nga kompanitë më të mëdha të ndërtimit në Shqipëri, që llogaritet ti përkasin 1.47% të të ardhurave nga nxjerrjet.

Përveç kësaj, raporti vë në dukje se tre kompani raportuese¹⁰² refuzuan që pagesat e tyre në qeveri të publikoheshin të ndara (disagreguara) sipas kompanive (f.119), dhe cdo zë pagesash nga të tre kompanitë araqiet si total, jo i ndarë sipas kompanive (f.149,151,153,156,157,158,160,161) (shiko kërkesa 4.7). Vlera e kombinuar e pagesave të tyre ndaj qeverisë mund të llogaritet si 8,06% e të ardhurave nga minierat dhe 2,4% e të ardhurave nga nxjerrjet – siç publikohet nga qeveria. Bazuar në raportimin e tyre individual (të pa-publikuar për shkak të shqetësimeve të tyre për konfidencialitetin), kompania më e madhe përbënte 1.6% të totalit të të ardhurave nxjerrëse, ndërkohë që dy të tjerët përbënin më pak se 0.7% të totalit të të ardhurave nxjerrëse.

Entet Qeveritare materiale (me peshë): Raporti liston tre ente të qeverisë qendrore, një institucion publik dhe një Ndërmarrje Shtetërore (NSH), si dhe shtatë njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) të përfshira në fokusin e raportimit bazuar në mbledhjen nga ana e tyre të të ardhurave materiale (fq.98). Zgjedhja e shtatë NjQV-ve është e mbuluar diku tjetër në këtë vlerësim (Shiko kërkesa 4.6). Ndërsa raporti nuk përfshin Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MEDTTE) në fushën e raportimit, ministria është përgjegjëse vetëm për mbledhjen e dividendëve nga Albpetrol dhe raporti konfirmon që Albpetrol nuk pagoi ndonjë dividend për qeverinë në 2016 (fq.38).

Raportimi i Qeverisë: Përkundër vonesave të rëndësishme në raportimin e përshtuar (f.112), raporti konfirmon që të gjitha entet e qeverisjes qendrore, duke përfshirë Albpetrolin, i kanë dorëzuar rregullisht formularët e raportimit përveç MIE (fq.98). Megjithatë, raporti konfirmon se MIE nuk ishte përgjegjëse për mbledhjen e të ardhurave nga kompanitë e minierave, naftës dhe gazit (fq.107).

Mospërputhjet: Raporti jep një shpjegim për zgjidhjen e mospërputhjeve fillestare (fq.115-119) dhe vlerën e mospërputhjeve përfundimtare të pazgjidhura, të cilat arritën në 440 242 000 lekë ose rreth 3,15% të të ardhurave të përgjithshme të publikuara nga qeveria. Raporti përfshin vlerësimin e AP që mospërputhjet nuk ngrejne shqetësime mbi plotshmërinë e rakordimit (Shiko Kërkesa 4.9).

¹⁰² Alb Lea International, Salillari, Xhireton.

Publikimet e plota të qeverisë: Raporti paraqet publikimet e plota të njëanshme të të ardhurave të qeverisë për tetë burimet kryesore¹⁰³ të të ardhurave materiale, por paraqet një kategori të emërtuar si "të tjera" që duket se bashkon disa zëra të ardhurash duke përfshirë gjobat tatimore, tatimin mbi dividendin, akcizën, taksën e karbonit, taksën e qarkullimit dhe garanci të ekzekutuara (fq. 13). Vlera e këtyre pagesave "të tjera" ndaj qeverisë qendrore përbën 30.5 % të të ardhurave nga minierat, nafta dhe gazi të cilat zbulohen në mënyrë të njëanshme nga qeveria¹⁰⁴ (fq.13). Raporti vëren vetëm se publikimi i plotë i të gjitha burimeve të të ardhurave "nuk mundësohet/suportohet nga sistemet e informacionit të Qeverisë" (fq.13). Sidoqoftë, pas konsultimeve, AP ishte në gjendje të japë një disagregim të zërit të të ardhurave të emërtuar "të tjera", e cila përbëhet nga detyrimet doganore (importet), Tatimet e akcizave (importet), TVSH (importet), Tatimi mbi karbonin (importet) dhe Taksa e Qarkullit (importet). Informacioni i disagreguar është publikuar në faqen e internetit AlbEITI më 15 Prill 2019.¹⁰⁵

Përveç kësaj, të dy zërat e të ardhurave të sigurimeve shoqërore & shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale janë paraqitur të përmbledhur, jo të ndara në zëra të veçanta të ardhurash (fq. 13). AP gjithashtu siguroi zërrimin për "sigurimin social dhe shëndetësor dhe tatimin mbi të ardhurat personale". Ky informacion u publikua në faqen e internetit AlbEITI më 15 Prill 2019¹⁰⁶.

Një përfaqësues qeveritar i konsultuar konfirmoi se shifra për Tatimin mbi Fitimin e dhënë në Tabelën 1 të Raportit EITI 2016 (fq.13) ishte shpallja e plotë e njëanshme e të ardhurave nga të gjithë 66 mbajtësit e licencave të nxjerrjes.

Vlerësimi i Sekretariatit

Vlerësimi i Sekretariatit Ndërkombëtar është që Shqipëria ka bërë progres domethënës në kërkesën 4.1.

Raporti EITI 2016 përfshin përkufizimin e MSG për pragjet e materialitetit (peshës) për pagesat dhe kompanitë që duhet të përfshihen në rakordim bazuar në qarkullimin vjetor të kompanive, duke përfshirë një justifikim për këtë qasje ndaj fushëveprimit. Përcaktimi i një pragu cilësor kundrejt një sasiori për përzgjedhjen e burimeve me peshë të të ardhurave (si pjesë e të ardhurave të qeverisë për shembull) është një shqetësim. Megjithatë, qasja mund të konkludohet në mënyrë të arsyeshme për të siguruar një mbulim gjithëpërfshirës të të gjitha burimeve të rëndësishme të të ardhurave duke pasur parasysh lidhjen me qarkullimin dhe prodhimin e kompanive. Ndërsa dy nga zërat e të ardhurave të renditura në kërkesën 4.1.b janë përjashtuar nga rakordimi bazuar vetëm në referencën e përgjithshme të mungesës së materialitetit (peshës), palët e interesuara kanë konfirmuar se vlera e tyre në vitin 2016 ishte nën pragun e materialitetit për të ardhurat (hyrjet). Kompanitë jo-raportuese janë cilësuar me emra dhe vlera e pagesave të tyre ndaj qeverisë jepet në raportin me të ardhurat e raportuara nga qeveria. Një total prej 39 nga 121 kompanitë nxjerrëse (minierat) nuk raportuan – një rritje nga viti 2015 ku kishte vetëm gjashtë kompani që nuk raportuan, që përbën 19% të të ardhurave totale të minierave dhe 4,62% të totalit të të ardhurave nxjerrëse të nxjerra në mënyrë të njëanshme nga qeveria. Megjithëse 38 nga këto 39 kompani që nuk raportojnë llogaritjet të sjellin më pak se 0,5% të të ardhurave totale të nxjerrëse secila, njëra kompani, Gener 2, që është një ndër kompanitë më të mëdha të ndërtimit në Shqipëri, i përket 1,47% e të ardhurave nga nxjerrësit në vitin 2016. Raporti jep vlerësimin e plotshmërisë së të dhënave financiare të rakorduara, megjithëse jo të besueshmërisë së tyre (Shiko Kërkesa 4.9). Ka pak evidencë për punën vijuese me kompanitë jo-raportuese nga ana e qeverisë apo industrisë. Ndërsa publikimi i njëanshëm

¹⁰³ Vellimet e prodhimit të naftës, Bonuset, Renta, Tatim Fitimi, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe taksa mbi të ardhurat personale, TVSH, dividendet.

¹⁰⁴ ALL 6,093m nga një total prej ALL 19,967m.

¹⁰⁵ AlbEITI (Prill 2019), 'EITI Report 2016 supplement', aksesuar [këtu](#) në Prill 2019.

¹⁰⁶ AlbEITI (Prill 2019), 'EITI Report 2016 supplement', aksesuar [këtu](#) në Prill 2019.

qeveritar i të ardhurave *materiale*, përfshirë edhe ato të kompanive *jo-materiale*, nuk ka siguruar ndarjen në vazhdimësi sipas zërave të të ardhurave në Raportin EITI 2016, faqja e internetit AlbEITI botoi publikimin e plotë të njëanshëm të pasqyrave të ardhurave të qeverisë të disagreguara sipas zërave përkatës më 15 prill 2019.¹⁰⁷

Në dritën e rritjes së konsiderueshme të numrit të kompanive jo-raportuese dhe peshës së pagesave të tyre, Vlerësimi i Sekretariatit Ndërkombëtar është se objektivi më i gjerë i rakordimit të plotë nuk është arritur plotësisht dhe se Shqipëria ka arritur progres domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë.

Në përputhje me kërkesën 4.1, Shqipëria duhet të sigurojë që pragu i peshës (materialitetit) për përzgjedhjen e kompanive në raportimin e ardhshëm të EITI, të mundësojë që të gjitha pagesat që mund të ndikojnë në plotshmërinë e raportimit të EITI të përfshihen në spektrin e rakordimeve dhe të sigurojnë që të gjitha kompanitë *materiale* të marrin pjesë në raportimin EITI. Shqipëria mund të dëshirojë të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të pragut të materialitetit për përzgjedhjen e kompanive minerare për të arritur një ekuilibër midis plotshmërisë së publikimeve dhe cilësisë së raportimit. MSG mund të dëshirojë të marrë në konsideratë një qasje kampionuese (me marrje kampionesh studimi), e cila do të lejonte që këto pagesa të hetohen pa krijuar një barrë të paarsyeshme raportimi.

4.2 Vlerësim i Kërkesës 4.7

Gjetje nga Validimi i parë

Validimi i parë zbuloi se Shqipëria kishte arritur një progres të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë. Raporti i EITI për vitin 2015 paraqiti informacion të rakorduar të disagreguar në bazë kompanish, zëra të ardhurash dhe subjektsh qeveritare.

Progresi që prej Validimit

MSG i AlbEITI miratoi dhe publikoi Raportin EITI 2016 në korrik 2018. Të dhënat e rakorduara financiare paraqiten të disagreguara në bazë subjekti qeveritar, kompanish (për të gjitha kompanitë përveç tre ndërmarrjeve minerare) dhe zëra të ardhurash (fq.141-144,148-160), përveç të ardhurave prej sigurimeve sociale dhe shëndetësor dhe tatimit mbi të ardhurat personale të paraqitura në total, jo të diasagreguara sipas zërave secifikë të këtyre të ardhurave (p.143,154-157).

Raporti shpjegon se tre kompani raportuese¹⁰⁸ refuzuan që pagesat e tyre në ndaj qeverisë të publikoheshin të zberthyer në bazë kompanish (fq.119), e që zdo zë pagesash nga tre kompanitë të paraqitej në total, jo të ndara për çdo kompani (f.149.151.153.156.157.158.160.161). Gjatë konsultimeve, AP shpjegoi se të tre kompanitë nuk kishin dashur që pagesat e tyre të paraqiteshin në bazë kompanish pasi që ata konsideronin se kjo do të zbulonte informata të ndjeshme komerciale. Vlera e pagesave nga këto tre kompani minerare arriti në 8.7% të të ardhurave të rakorduara të minierave (fq.147), të cilat mund të llogariten si 2.2% të totalit të të ardhurave të rakorduara. Pas fillimit të Validimit, AB ka komunikuar pagesat e tre kompanive të ndara sipas zërave të të ardhurave. Ky informacion u publikua në faqen e internetit AlbEITI në 15 prill 2019.¹⁰⁹

Në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale të prezantuara në total, jo në zëra specifikë të ardhurash (fq.143,154-157), AP shpjegoi se kishte marrë të

¹⁰⁷ AlbEITI (Prill 2019), 'Shtojce e EITI Report 2016, aksesuar [këtu](#) në Prill 2019.

¹⁰⁸ Alb Lea International, Salillari, Xhireton.

¹⁰⁹ AlbEITI (Prill 2019), 'Shtojce e EITI Report 2016', aksesuar [këtu](#) në Prill 2019.

dhëna të disagreguara nga qeveria, por jo nga kompanitë, të cilat kishin dorëzuar të gjitha të dhënat mbi pagesat e tyre në total për të tre zërat e veçantë të pagesave, edhe pse i paguan këto taksa veçmas në sistemin e Thesarit. Gjatë konsultimeve, AP siguroi publikimet e njëanshme të disagreguara të qeverisë, sipas kompanive dhe zërave të të ardhurave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Ky informacion u publikua në faqen e internetit AlbEITI më 15 prill 2019.¹¹⁰

Si rezultat i dokumenteve të reja të publikuara në faqen e internetit AlbEITI në fillim të Prillit 2019, mund të argumentohet se të gjitha të dhënat financiare të rakordura janë paraqitur të ndara në bazë të kompanisë dhe zërave të të ardhurave.

Vlerësimi i Sekretariatit

Në varësi të shqyrtimit nga ana e Bordit të informacionit të ri të publikuar pas fillimit të Validimit, Vlerësimi i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka arritur progres të kënaqshëm në kërkesën 4.7. Raporti EITI 2016 paraqet pjesën më të madhe të të dhënave të rakordura financiare të ndara sipas kompanisë dhe zërave të të ardhurave, ndërkohë që faqja e internetit e AlbEITI publikoi të dhëna të reja pas fillimit të Validimit në prill 2019 për nivelet e disagregimit të kërkuar.

Për të forcuar zbatimin, Shqipëria inkurajohet që të sigurojë që të gjitha të dhënat tatimore dhe jo-tatimore të publikohen të disagreguara në nivele të përputhshme me kërkesën 4.7, dmth. Na bazë kompanie, zëri të të ardhurave dhe subjekti qeveritar. Shqipëria duhet të arrijë progres në zbatimin e raportimit të EITI, në nivel projekti, përpara afatit përfundimtar për të gjitha raportet e EITI që mbulojnë periudhat fiskale që përfundojnë në ose pas 31 dhjetorit 2018, rënë dakord nga Bordi EITI në takimin e tij të 36-të në Bogotá.

5. Konkluzion

Pasi ka shqyrtuar hapat e marra nga Shqipëria për të adresuar 12 Veprimet Korrigjuese të kërkuara nga Bordi EITI që prej fillimit të Validimit të dytë (13 Shkurt 2019), mund të konkludohet në mënyrë të arsyeshme që **pesë nga 12 Veprimet Korrigjuese janë adresuar plotësisht dhe se Shqipëria ka bërë progres domethënës në zbatimin e standardit EITI, me përmirësime të konsiderueshme përgjatë disa prej kërkesave specifike.**

Sekretariati rekomandon që Bordi të ushtrojë diskrecionin e vet në marrjen parasysh të informacionit të ri të publikuar gjatë periudhës së konsultimeve me palët e interesuara, të cilat mund të konsiderohen si mosvërejtje të paqëllimta. Informacioni i ri përbëhet nga të dhëna të disagreguara të publikuara pas fillimit të Validimit, të nevojshme për të shmangur rrëshqitjen mbrapa në vlerësimin për kërkesën 4.7 dhe të demonstrojnë progres të kënaqshëm në dy Veprime Korrigjuese të tjera. Informacioni i ri i publikuar pas fillimit të Validimit është verifikuar në mënyrë të pavarur dhe i plotëson kriteret¹¹¹ e miratuara nga Bordi për shqyrtimin e informacionit të ri post-validimit.

Nëse Bordi do të marrë në konsideratë informacionin e ri të publikuar në periudhën 13 Shkurt - 10 Prill 2019, Vlerësimi i Sekretariatit është se Shqipëria ka adresuar plotësisht shtatë nga 12 Veprimet Korrigjuese, duke arritur "progres të kënaqshëm" në kërkesat korresponduese, dhe ka bërë "progres domethënës" me përmirësime të konsiderueshme në adresimin e pesë veprimeve korrigjuese të tjera. Përveç kësaj, Vlerësimi i Sekretariatit është se ka patur një rrëshqitje në përmbushjen e Kërkesës 4.1,

¹¹⁰ AlbEITI (Prill 2019), 'Shtojce e EITI Report 2016, aksesuar [këtu](#) në Prill 2019.

¹¹¹ EITI (Shkurt 2019), 'The Board adopted criteria to consider developments and information disclosed after the commencement of Validation', aksesuar [këtu](#) në Mars 2019.

mbi plotshmërinë e publikimeve. Kjo do të rezultojë në një vlerësim të përgjithshëm si "progres domethënës" me përmirësime të konsiderueshme përgjatë disa kërkesash specifike, me gjashtë veprime korigjuese. Mangësitë më të theksuara lidhen me angazhimin e shoqërisë civile (Kërkesa 1.3), akordimet e liçencave (Kërkesa 2.2), pjesëmarrja e shtetit (Kërkesa 2.6), plotshmëria e publikimeve (Kërkesa 4.1), pagesat direkte subnacionale (Kërkesa 4.6) dhe besueshmëria e të dhënave (Kërkesa 4.9).

Shtojca

Shtojca A – Vlerësimi i AlbEITI MSG (pjesëmarrja) për 2018

PJESËMARRJA E MSG-SË SHQIPTARE GJATË VITIT 2018											
ANTARET E MSG-SË		Data	Mars - 28	Maj - 15	Qershor - 21	Dhjetor - 07					
PËRFAQËSUESIT E QEVERISË SHQIPTARE											
Anëtarët	Institucioni	Mesatarja									
Z. MEHMET HASALAMI	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1.5	3	1	1	1	1	1	1	1	
Znj. MAJLINDA HAFIZI	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1.8	1	2	3	3	1	1	1	1	
Z. TETIS LUBONJA	Ministria e Drejtësisë	2	2	2	1	1	3	3	3	3	
Z. NIKOLL KAZA	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	1.8	2	1	2	2	2	2	2	2	
Z. AZBI ARAPI	Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore	2	1	3	3	3	3	3	1	1	
Pa pjesëmarrës	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	1	1	1	1	1	1	1	1	
Mesatarja e Pjesëmarrjes së grupit		1.7	1.7	1.7	1.3	1.3	1.3	1.3	1.5	1.5	
ANËTARE TË SHOQATAVE TË SHOQERISË CIVILE											
Z. SAMI NEZAJ	Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë	2	3	3	1	1	1	1	1	1	
Znj. ANILA HAJNAJ	Qendra Shqiptare për Zhvillim Institucional	3	3	3	3	3	3	3	3	3	
Z. BAKI BAJRAKTARI	Sindikata e Minatorëve Bulqizë	1.5	1	3	1	1	1	1	1	1	
Ne pritje të konfirmimit të anëtarve	Qendra për Zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve	1.5	3	1	1	1	1	1	1	1	
Mesatarja e Pjesëmarrjes së grupit		2	2.5	2.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	
ANËTARE TË GRUPEVE TË INTERESIT											
Znj. ORKIDA DRAGOTI	Devoli Hydropower Sh. A/STATKRAFT	1.5	3	1	1	1	1	1	1	1	
Z. PANDELI BOMBAJ	SELENICA BITUMI	1.5	3	1	1	1	1	1	1	1	
Z. PERPARIM ALIKAJ	FIAA	2.5	3	3	1	1	3	3	3	3	
Z. DRTAN DERVISHAJ	ANTEA CEMENT	3	3	3	3	3	3	3	3	3	
Z. TURKER SENGONUL	SHELL UPSTREAM ALBANIA	1	1	1	1	1	1	1	1	1	
Mesatarja e Pjesëmarrjes së grupit		1.9	2.6	1.8	1.4	1.4	1.4	1.4	1.8	1.8	
KONTRIBUES TË PËRHERSHËM TË PROÇESEVE EITI											
Znj. ANISA CANAJ / Z. DRTAN SPAHIU	ALBPETROL	2.3	3	3	1	1	2	2	2	2	
Znj. ARJANA DYRMISHI / Z. OLTION KUKE	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	1	1	1	1	1	1	1	1	
Z. ATHANAS KARAJA	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2.3	2	2	2	2	2	2	3	3	
Znj. ERJOLA SADUSHI / Z. AGIM NASHI	Enti Rregullator i Energjisë	2.5	3	1	3	3	3	3	3	3	
Mesatarja e Pjesëmarrjes së grupit		2.1	2.3	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8	2.3	2.3	
LEGJENDA DHE SHËNIME											
LEGJENDA:							3	Prezent			
							2	Dërguar përfaqësues			
							1	Jo prezent			

Shtojca B – Pasqyra e pagesave prej subjekteve jo-raportuese në 2016

Company	Payments USD	%mining	%extractives
TOTAL	5 176 260,67	16,58 %	4,62 %
Gener 2	1 933 929,43	6,20 %	1,72 %
Alb-Mi sh.p.l	482 817,79	1,55 %	0,43 %
Alb Mine&Ch	315 442,24	1,01 %	0,28 %
Lim - Em	304 253,26	0,97 %	0,27 %
FABRIKA E P	219 469,95	0,70 %	0,20 %
Silbora	206 951,83	0,66 %	0,18 %
Pakti	204 382,15	0,65 %	0,18 %
Qeramika A	142 307,07	0,46 %	0,13 %
Mustafai	137 119,38	0,44 %	0,12 %
BL - Arsi sh.p	135 717,74	0,43 %	0,12 %
Florida	115 273,08	0,37 %	0,10 %
Benaks-94	104 809,09	0,34 %	0,09 %
Tur-Alb-Kron	91 743,19	0,29 %	0,08 %
Vellezerit Llu	85 024,97	0,27 %	0,08 %
Cahani	82 068,63	0,26 %	0,07 %
Lita Brothers	74 488,48	0,24 %	0,07 %
Kurti	65 869,18	0,21 %	0,06 %
Arkev	61 035,93	0,20 %	0,05 %
Albtani -08 K	56 774,61	0,18 %	0,05 %
Ra-Krom Tira	55 832,13	0,18 %	0,05 %
Tanusha	51 377,48	0,16 %	0,05 %
Afrimi-K	45 158,69	0,14 %	0,04 %
Alion	39 608,51	0,13 %	0,04 %
Xhuljano 08	33 639,44	0,11 %	0,03 %
Brajan 2013	30 828,10	0,10 %	0,03 %
Leshnica	28 773,96	0,09 %	0,03 %
Glejdis	19 204,12	0,06 %	0,02 %
Koxherri	15 103,91	0,05 %	0,01 %
Gerda - 07 sh	12 647,01	0,04 %	0,01 %
Blerimi Kostu	11 358,14	0,04 %	0,01 %
Foralb Alaba	5 598,52	0,02 %	0,00 %
Pirali	3 689,38	0,01 %	0,00 %
Gjomakaj Gr	2 658,29	0,01 %	0,00 %
Alpha Alaba:	1 216,37	0,00 %	0,00 %
Roimar	88,61	0,00 %	0,00 %
Bytyci	-	0,00 %	0,00 %
IllyriaMinera	-	0,00 %	0,00 %
Kromex	-	0,00 %	0,00 %
TopiEki	-	0,00 %	0,00 %

Burimi: Shtojcat 1 & 2 të Raportit EITI 2016 të Shqipërisë dhe përmbledhja e të dhënave ALBEITI